



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.05.2022, ora 12:15

Drejton mbledhjen:

Flutura Aça – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 20 dhe 26 prill 2022.

- Seancë dëgjimore me Ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zonjën Bora Muzhaqi.

Marrin pjesë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Merita Bakiu dhe Kastriot Piroli.

Mungon:

Blerina Gjylameti.

Të ftuar:

Bora Muzhaqi – Ministre e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,

Arlinda Topciu – drejtore e Kabinetit të Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,

Oltion Pengu – këshilltar i Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

HAPET MBLEDHJA

Flutura Aça – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbale të mbledhjeve të komisionit të datave 20 dhe 26 prill 2022. Më pas kemi seancë dëgjimore me ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zonjën Bora Muzhaqi.

Të ftuar janë: zonja Bora Muzhaqi, ministre e Shtetit për Rininë dhe fëmijët, zonja Arlinda Topçiu, drejtoreshë e Kabinetit, si dhe zoti Oltion Pengu, këshilltar.

Mirë se erdhët!

Kalojmë në pikën e parë.

Besoje se i keni parë procesverbalet. Nëse nuk ka vërejtje, kalojmë në miratimin e tyre. Jeni dakord?

Miratohen.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: seancë dëgjimore me ministren, zonjën Bora Muzhaqi, për veprimtarinë e Ministres së Shtetit që nga krijimi, projektet e hartuara dhe të realizuara për fëmijët dhe të rinjtë, masat konkrete për frenimin e emigrimit të të rinjve, projektet e ardhshme, për të cilat mund të duhet mbështetja e komisionit.

Zonja Ministre, fjala për ju!

Bora Muzhaqi – E nderuar zonja kryetare e komisionit,

I nderuar zëvendëskryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë,

Së pari, më lejoni t'ju falënderoj për mundësinë e kësaj dëgjese!

Është kënaqësi të jem këtu për t'ju prezantuar sado pak veprimtarinë që kemi kryer gjatë këtyre muajve. Mendoj se është vërtet shumë e nevojshme që ju të viheni në dijeni për punën që kemi kryer dhe, mbi të gjitha, duke shpresuar që nëpërmjet jush të arrijmë të përcjellim të gjitha projektet që kemi kryer për të rinjtë dhe fëmijët e zonave që ju keni fatin të përfaqësoni.

Shpresoj të keni pasur kohë të shikoni raportin e detajuar që është ndarë me ju, por, duke ju mirëkuptuar, sepse jo të gjithë mund të kenë pasur kohën e mjaftueshme për ta rishikuar, gjej rastin sot t'ju përmbledh shkurtimisht një sërë prej aktiviteteve dhe sfidave që kemi pasur, por edhe arritjet që janë kryer gjatë kësaj periudhe.

Siç besoj, shumë nga ju jeni në dijeni se nuk kemi pasur një dokument strategjik, i cili përcakton prioritetet dhe politikat publike në mbështetje dhe për zhvillimin e të rinjve, prandaj angazhimi im i parë personal që pas marrjes së detyrës ishte fillimi i punës për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Rininë. Fillimisht ngritëm një grup ndërinstytucional pune, duke qenë se rinia është ndërsektoriale. Do të thotë që, praktikisht, çdo institucion qeveritar ka nga një përfaqësues në këtë grup pune, kështu që kemi bërë rakordimin e të gjithë punës për grupin ndërinstytucional të punës.

Kjo strategji ka përdorur një metodologji, që është ndryshe nga të zakonshmet, dhe ka filluar së pari me konsultimin me të rinjtë, kryesisht nga shtatori i vitit 2021 deri në janar 2022, kanë marrë pjesë mbi 1200 të rinj të shkollave të mesme dhe të universiteteve, përfaqësues nga 45 organizata rinore dhe ato për të rinjtë, por edhe 61 përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Fuqizimi i zërit të të rinjve fillon, së pari, duke i dëgjuar dhe çdo koment i mbledhur nga konsultimet tona ka formuar bazën mbi të cilën është përgatitur strategjia. Gjatë periudhës shkurt- prill 2022 ne kemi përgatitur draftin e parë të strategjisë. Strategjia është rikonsultuar me 200 të rinj të përzgjedhur nga e gjithë Shqipëria në mars të vitit 2022. Drafti paraprak i Strategjisë Kombëtare të Rinisë përfshin 3 qëllime, 9 objektiva specifike, 43 masa dhe 143 aktivitete, i cili do të ndahet me të gjitha palët e interesit për të marrë komentet e tyre në vijim. Masat e propozuara në strategji janë shumë, por do të doja të përqendrohesha te disa prej tyre që lidhen edhe me temën, për të cilën më keni ftuar sot.

Së pari, do të jetë forcimi i mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rinjve e të rejave në vendimmarrje; fuqizimi i roleve zbatuese, koordinuese edhe monitoruese të Agjencisë Kombëtare të Rinisë; promovimi dhe përdorimi i sigurt i teknologjive të reja dhe mbështetja, përvetësimi i aftësive dhe kompetencave digjitale të shekullit XXI për të rinjtë nëpërmjet zhvillimit të projekteve e nismave novative, që mbështesin të rinjtë në pikat kritike të zhvillimit; mbështetja dhe zhvillimi i programeve të seksioneve sportive amatore, arteve, artizanit dhe aktiviteteve të tjera jashtë kurikulare që synojnë zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme me fokus të veçantë të rejat; nxitja e punëve të denja, të përshtatshme për të rinjtë dhe të rejat; krijimi i politikave të punësimit që respektojnë dhe kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës, të pranueshme dhe të orientuara nga të rinjtë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Sporteve do të rishikohen dhe kurrikulat dhe programet e orientimit, të këshillimit të karrierës dhe të punësimit, me qëllim

krijimin e përvojave të punësimit për të rinjtë në shkolla dhe mjediset informuese rinore, duke vënë gjithmonë theksin te fuqizimi i aftësive dhe interesave të një të riu dhe një të reje. Një ndër pikat tona kyçe do të jetë edhe mbështetja e ndërtimit, riparimit dhe rinovimit të hapësirave publike të projektuara për të rinjtë në qarqet që të gjithë ju përfaqësoni.

Drafti i Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 është tashmë në fazë finalizimi, në përputhje me kuadrin strukturor dhe standardet e sistemit IPSIS dhe pas konsultimit publik dokumenti strategjisë dhe plani i veprimit për zbatimin e tij do të paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave. Strategjia pritet të miratohet në 3-mujorin e tretë të vitit 2022 në përputhje me parashikimet e PPAP-së 2022, si dhe të PKIE-së.

Një tjetër iniciativë, për të cilën ne kemi punuar gjatë këtyre muajve, është edhe skema e mbështetjes shtetërore, të kurseve të programimit për të rinjtë. Ky është një program i ri, i cili prezantohet për herë të parë dhe, ndonëse nuk ka filluar ende implementimin, është drejt finalizimit. Në vijim të një prej masave të propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, zhvillimi i kompetencave digjitale vlerësohet si një aftësi e një rëndësie shumë të lartë për tregun e sotëm të punës, si dhe për më tepër zhvillimi i njohurive kompjuterike dhe aftësive të mendimit kritik te fëmijët dhe të rinjtë. Aktualisht vihet re një numër i ulët i të rinjve të specializuar me aftësi programimi dhe kodimi, ndërkohë tregu i punës ka nevojë për specialistë që ofrojnë këto aftësi.

Në dhjetor të vitit 2021 ne kemi ngritur një grup pune, ku përfshihen Ministria e Arsimit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Ministria e Mbrojtjes për procesin e nxitjes së aftësive të kodimit tek të rinjtë nëpërmjet trajnimeve në fusha të ndryshme për aftësi digjitale. Gjatë periudhës janar-prill 2022 grupi i punës ka përgatitur një analizë të thelluar të ekosistemit të teknologjisë dhe informacionit dhe komunikimit në Shqipëri, si dhe të nevojës që tregu ka për profesionistë në fushat e TIK-ut, një analizë për profilin e ofruesve të kurseve të kodimit, si dhe përgatitjen e një VKM-je që do të përcaktojë kushtet dhe kriteret për skemën e subvencionimit, por edhe propozimet për shtrirjen dhe afatin e zbatimit të projekteve.

Grupi i punës është drejt finalizimit të VKM-së që parashikon mënyrën e funksionimit të skemës, kriteret për kualifikimin e enteve të kurseve të kodimit, si dhe kriteret për përfitimin e bursave nga të rinjtë, si dhe nga individët që u përkasin kategorive të veçanta që do të aplikojnë për të qenë pjesë e kurseve në fushat e teknologjisë dhe kodimit.

Një program, i cili është trashëguar tashmë nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, është programi kombëtar i praktikave të punës. Thirrja e 6 e këtij programi është realizuar pjesërisht nga Ministria e Arsimit, sipas planit të veprimit dhe metodologjisë së miratuar deri në fazën e përcaktimit të numrit të praktikantëve që do të punësohen me kontratë njëvjeçare, ndërkohë që faza finale e këtij programi është kryer nga institucioni ynë dhe falë tij kanë kryer praktikën e punës 572 të rinj në institucione të ndryshme, prej të cilëve ata që janë vlerësuar me pikë maksimale për performancën e tyre, pra 196 prej tyre, tashmë kanë firmosur kontratat e punësimit me institucionet ku kanë kryer praktikën. Përveçse kjo është një eksperiencë shumë e vlefshme për zhvillimin e aftësive profesionale, akademike dhe personale, praktika e punës u vlen të rinjve pjesëmarrës si një përvojë e njohur pune për të vijuar rrugëtimin e tyre në karrierë.

Në muajin prill të këtij viti kemi filluar punën përgatitore për hapjen e thirrjes së 7-të të programit kombëtar të praktikave të punës, tashmë është ngritur grupi i punës, është përgatitur metodologjia për shpalljes e thirrjes, si dhe dokumentet e nevojshme, por është bërë edhe transferimi i platformës nga Ministria e Arsimit tek institucioni ynë.

Gjatë muajve maj-qershor kemi planifikuar zgjerimin e kësaj skeme, kemi planifikuar një tur konsultimi së bashku me të gjitha shoqëritë tregtare, por edhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim për t'u kërkuar atyre të bëhen pjesë e programit kombëtar të praktikave të punës. Kjo për t'u ofruar të rinjve dhe më shumë mundësi punësimi jo vetëm në sektorin e administratës publike, por edhe në sektorin privat, si dhe në sektorin e organizatave të shoqërisë civile.

Procesi i aplikimit do të fillojë më 9 korrik dhe do të zgjasë për një periudhë njëmuajore, ndërkohë që kohëzgjatja e praktikave do të jetë për 3 muaj, siç ka ndodhur në 6 vjetët e mëparshëm, do të fillojë në 12 shtator dhe do të zgjasë deri më 12 dhjetor. Pas përfundimit të programit, të rinjtë që vlerësohen me performancën më të mirë, në varësi edhe të pozicioneve që u ofrohen, do të lidhin kontratat e punësimit me institucionet ku kanë kryer praktikën e tyre të punës.

Një tjetër detyrim ligjor, tashmë i përmbushur i ligjit "Për rininë" ka qenë edhe ngritja e Këshillit Kombëtar Rinor, që është ngritur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, por ka vijuar funksionimin pa ndërprerje dhe pas kalimit të përgjegjësisë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek institucioni që përfaqësoj.

Këshilli Kombëtar Rinor është një entitet konsultues që përbëhet nga të rinj të ndryshëm që përfaqësojnë organizata rinore, këshilla studentorë, por edhe një përfaqësi nga

agjencitë e vetëqeverisjes vendore. KKR-ja është mbledhur 2 herë që pas krijimit të institucionit të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Në mbledhjen e parë u diskutua lidhur me shpërndarjen e fondeve për thirrjen e parë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Në mbledhjen e dytë është diskutuar dhe është prezantuar në Këshillin Kombëtar Rinor Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029, procesi për ngritjen e databazës së rinisë, për të cilën do t'ju flas pak më tej, si dhe programi i garancisë rinore, thirrja e 7 e programit kombëtar të praktikave të punës, si dhe rëndësia e krijimit të këshillave vendorë rinorë, por edhe hapja e thirrjes së dytë të Agjencisë Kombëtare e Rinisë.

Që nga krijimi i këtij institucioni është kryer një proces validimi dhe informimi me anë të shkresave zyrtare me të gjithë drejtuesit e njësisive të vetëqeverisjes vendore, lidhur me detyrimin e tyre ligjor për krijimin e këshillave vendorë rinorë.

Gjatë këtij procesi 45 bashki janë kontaktuar, me të cilat ka pasur një komunikim të vazhdueshëm, ku 31 % e tyre e kanë krijuar tashmë Këshillin Vendor Rinor, ndërkohë që 69% janë në procesin e krijimit të këtyre këshillave.

Këtu është një pikë që do të doja shumë bashkëpunimin tuaj për të nxitur kryetarin e bashkisë dhe për të nxitur entitetet e ndryshme të vetëqeverisjes vendore të jenë sa më aktivë në këtë proces dhe të na ndihmojnë për krijimin e këshillave vendorë rinorë sa më shpejt.

Ju përmenda pak më parë Agjencinë Kombëtare të Rinisë, që është një institucion i ngritur në vitin 2020, ka qenë në varësinë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, por, pas krijimit të institucionit të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, kjo është një agjenci që tashmë shërben si krahu operativ i politikave rinore dhe është në varësinë e institucionit që unë përfaqësoj, ndaj do të doja të ndalesha sado pak në punën që kjo agjenci kryen.

Një nga detyrat kryesore të AKR-së është mbështetja e të rinjve nëpërmjet organizatave rinore dhe bashkive duke pasur një thirrje vjetore për projektpropozime me në fokus rininë.

Në shtator të vitit 2021 është finalizuar procesi i shqyrtimit dhe i vlerësimit të projektpropozimeve rinore për thirrjen e parë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe në nëntor 2021 janë nënshkruar kontratat midis organizatave rinore ose bashkive dhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Nga ky moment ka filluar implementimi i të gjitha projektpropozimeve rinore.

Në nëntor të vitit të kaluar janë organizuar 12 projekte fituese nga organizatat rinore për të rinjtë dhe disa prej tyre vazhdojnë ende zbatimin në 20 bashki të 11 qarqeve të ndryshme të vendit, ku plot 1500 të rinj shqiptarë janë angazhuar dhe po angazhohen për të përfituar drejtpërdrejt nga programet e vullnetarizmit, të punës rinore, debatit, aktivitetet artistike dhe kulturore, sportive dhe kreative, por edhe trajnimet dhe mentorimet për zhvillimin e projekteve të sipërmarrjes në fushën e teknologjisë, në fushën e arteve, zejeve dhe bujqësisë. Ndërkohë, 6500 të rinj të tjerë do të ndikohen nëpërmjet fushatave që kryhen në terren dhe informimit në mediet sociale, por edhe platformave *online* të dedikuara për ta.

Po ashtu, pjesë e kësaj thirrjeje kanë qenë edhe 4 projekte nga bashkitë, që kanë filluar tashmë punën për ngritjen apo përmirësimin e infrastrukturës për sport, kulturë dhe teknologji. Më konkretisht, Qendra rinore në Bashkinë Elbasan, Biblioteka Publike në Bashkinë Roskovec, Qendra Rinore në Bashkinë Lezhë dhe Qendra Rinore në Petrelë, që do të sigurojnë mjedise të përshtatshme për aktivizimin e të rinjve, por edhe për gjallërimin e këtyre zonave.

Pasi kemi kryer një vlerësim shumë të mirë të disa nga sistemeve të granddhënies, sipas kriterëve dhe standardeve të kërkuara nga Bashkimi Europian, në bashkëpunim me UNDP-në, kemi vendosur përshtatjen ligjore për ndryshimin e VKM-së për të reflektuar në këtë mënyrë praktikën më të mira të kërkuara nga Bashkimi Europian për agjencitë shtetërore. Më 11 mars të viti 2022 kemi nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me UNDP-në, që i ka hapur rrugë procesit të rishikimit të mekanizmit në zbatimin e granteve shtetërore për rininë, e bazuar në metodologjinë LOD, një nga praktikën më të suksesshme të Bashkimit Europian për financimin e organizatave të shoqërisë civile, që siguron transparencë, efektivitet dhe gjithëpërfshirje në të gjitha hallkat e këtij procesi. Në bashkëpunim me ekspertët e UNDP-së aktualisht po bëhet rishikimi i VKM-së bazuar në metodologjinë LOD dhe objektivi ynë është që përfundimi i këtij procesi të kryhet brenda muajit maj dhe shpallja e thirrjes për financimin e projektpropozimeve rinore dhe projekteve të infrastrukturës rinore vendore, të bëhet bazuar në kuadrin e ri legjislativ. Bashkë me rishikimin e kuadrit rregullator të thirrjes nëpërmjet ekspertizës së UNDP-së po zbatojmë edhe një program trajnimi dhe rritjes së kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, që të jenë edhe më të gatshëm për t'u shërbyer organizatave rinore, bashkive, por edhe të rinjve në kryerjen e detyrave të tyre.

Në datën 24 dhjetor 2021 është miratuar në Këshillin e Ministrave projektvendimi për *database*-n e rinisë, detyrim i ligjit “Për rininë”, i parashikuar në nenin 18, duke përfunduar miratimin e të gjitha akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Qëllimi i bazës së të dhënave

për rininë është të sigurojë informacion të përditësuar për të rinjtë në vend, si dhe të mbështesë procesin e planifikimit, mbikëqyrjen, administrimin dhe vlerësimin e politikave rinore, si në nivel qendror, edhe në nivel vendor. Aktualisht *database* e rinisë është në proces ndërtimi me anë të mbështetjes nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë dhe Informacionit dhe do të administrohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Në vijim të një seance dëgjimore, të realizuar në datën 21 shkurt 2022 me Komisionin për Punën, Çështjen Sociale dhe Shëndetësinë, si dhe me kërkesë të shoqërisë civile rinore, por edhe për të rinjtë bashkë me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe të Aftësive, kemi vendosur bashkërisht të angazhohemi në një proces të rishikimit të ligjit “Për vullnetarizmin”. Ky rishikim ka qëllim adresimin e aspekteve më problematike strukturore të këtij ligji, duke filluar që nga njohja e punës vullnetare, kontraktimi dhe regjistrimi i vullnetarëve, kostot e sigurimit të vullnetarëve, por edhe ngritjen e mekanizmave mbështetës, që do të mund ta kthenin ligjin nga një ligj frenues në një instrument nxitës dhe mundësues për vullnetarizmin dhe shërbimin vullnetar në Shqipëri.

Angazhimi im në këtë ligj, ndonëse nuk është një fushë e drejtpërdrejtë e punës që unë kryej, duke marrë parasysh që të rinjtë përfitojnë më shumë nga aktivitetet vullnetare, është menduar e arsyeshme nga komisioni dhe, sigurisht, është pranuar për të marrë edhe ne pjesë aktivisht në këtë proces.

Kemi asistuar dhe ndihmuar Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe të gjithë aktorët e përfshirë për sa i përket zbatimit të programit të ekipeve sportive, si në fushën e volejbollit, edhe të basketbollit për vajza dhe djem. Ky projekt ka qëllim angazhimin e drejtpërdrejtë të rreth 14 mijë vajzave dhe djemve, të cilët aktualisht ndjekin studimet në shkollat 9-vjeçare, në gjimnaze dhe në universitete.

Gjithashtu, është parashikuar përfshirja e 350 trajnerëve të basketbollit dhe volejbollit, si dhe trajnime të vazhdueshme për rritje të kapaciteteve. Nga parashikimi ynë do të fillojnë kampionatet në nivel qarqesh në shtator të këtij viti dhe do të vijojnë në fund të vitit, por edhe duke vazhduar për vitin tjetër.

Një rezultat i suksesshëm i muajve të fundit ka qenë edhe aplikimi dhe miratimi për herë të parë në thirrjen e Bashkimit European për rininë, thirrja e *You for Youth*, si pjesë e IPA 3, ku në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por edhe me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, kemi kërkuar një mbështetje prej 5 milionë eurosh për projekte në fushën e rinisë.

Kjo mbështetje është ofruar tashmë nga Bashkimi European dhe programet, për të cilat do të ofrohet kjo mbështetje, lidhen me 3 fusha:

E para, përfshirja e të rinjve nëpërmjet dialogut të strukturuar në konsolidimin e të drejtave të njeriut, vullnetarizmi dhe pjesëmarrja aktive për zhvillimin e komuniteteve lokale, zhvillimin e kulturës dhe sportit. Për të kaluar në terma më konkretë të kjo pjesë, do të lidhet me ndërtimin e kapaciteteve për këshillin kombëtar rinor dhe këshillave vendorë rinorë, për të cilat iu shpjegova pak më parë, por edhe për pjesën e aktivizimit dhe vullnetarizmit për të rinjtë, pa lënë mënjanë edhe mbështetjen e skuadrave sportive, duke pasur fokus kryesor përfshirjen e vajzave në këto aktivitete, por edhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

Pika e dytë lidhet drejtpërdrejt me punësimin e të rinjve dhe të rejave, kryesisht atyre që nuk janë në edukim apo trajnim, nëpërmjet zbatimit të programeve të trajnimeve profesionale, por edhe të arsimimit të vazhdueshëm. Ky program ka si qëllim përmirësimin e kapaciteteve institucionale për implementimin e programit të Bashkimit European, një program flamur i Bashkimit European, që është garancia rinore. Në të njëjtën kohë, gjatë këtij viti do të realizohet edhe zbatimi i programit pilot të garancisë rinore për këta të rinj.

Pika e tretë lidhet me teknologjinë dhe është pikërisht përmirësimi i aftësive të të rinjve dhe të rejave në integrimin e këshillimit të karrierës, si pjesë e edukimit në sistemin shkollor, duke ofruar një përmirësim të aftësive të shekullit të XXI, duke përfshirë mendimin kritik, komunikimin, bashkëpunimin, krijimtarinë nëpërmjet moduleve digjitale, por edhe implementimin e një programi të karrierës në shkolla dhe trajnimin e profesionistëve për zhvillimin e këtij programi.

Në muajin nëntor të vitit 2021 ky material është dorëzuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, sporteve dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe tashmë është miratuar nga Komisioni European. Në këtë kuadër, gjatë muajve mars-prill 2022 ne kemi zhvilluar një sërë takimesh të grupit teknik të punës për implementimin e instrumentit të garancisë rinore në Shqipëri dhe tashmë kemi hartuar dhe miratuar planin zbatues të garancisë rinore.

Një nga objektivat e parë të identifikuar në këtë proces lidhet edhe me angazhimin e të gjitha mekanizmave, duke filluar me këshillat vendorë rinorë, punonjësit rinorë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, por edhe organizatat rinore për të identifikuar të rinjtë që nuk janë në arsimim, trajnim apo edukim të vazhdueshëm, si dhe nxitjen dhe regjistrimin e tyre, në mënyrë që të bëhet adresimi i duhur për secilin rast.

Ndërkohë, do të doja të ndalesha shkurtimisht te bashkëpunimin rajonal që kemi pasur. Në kuadër të bashkëpunimit tonë me zyrën rajonale për bashkëpunim rinor, e cila e ka qendrën në Shqipëri, ne kemi realizuar disa aktivitete, duke filluar së pari me ministerialin për rininë dhe edukimin, ku pas 7 vjetësh pas fillimit të procesit të Berlinit, bashkë me ministren e arsimit të Shqipërisë, kemi realizuar një aktivitet, ku janë ftuar të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për të ardhur në një forum të përbashkët, ku janë mbledhur të gjithë ministrat, zëvendësministrat dhe përfaqësuesit e fushës së rinisë dhe fushës së arsimit, me qëllim diskutimin e bashkëpunimit të mëtejshëm dhe janë hedhur disa hapa të mirë për të vijuar më tej këtë bashkëpunim.

Një tjetër program i suksesshëm, që kemi implementuar me zyrën rajonale për bashkëpunim rinor është programi i shkëmbimeve shkollore, i quajtur “Super shkollat”. Gjatë vitit 2021 nga Shqipëria kanë aplikuar gjithsej 32 shkolla, konkretisht: 9 prej tyre kanë aplikuar për shkëmbime me Bosnje-Hercegovinën, 6 për Kosovën, 2 për Malin e Zi, 5 për Maqedoninë e Veriut dhe 10 për Serbinë.

Nga këto aplikime janë përzgjedhur si fituese nga Shqipëria 11 shkolla, konkretisht 2 për shkëmbime me Bosnje-Hercegovinën, 2 për Kosovën, 1 për Malin e Zi, 1 për Maqedoninë e Veriut dhe 5 për Serbinë. 11 shkollat fituese nga Shqipëria kanë dërguar tashmë, dhe një pjesë e tyre po dërgojnë, 13 nxënës në këtë program. Në total do të përfitojnë 143 nxënës nga programi “Super shkollat”. Shkollat që janë përzgjedhur fituese kanë marrë pjesë në shkëmbimet rinore midis shkollave gjatë muajve shkurt deri në maj. Gjatë muajit prill 8 shkolla nga Ballkani Perëndimor janë mirëpritur nga të rinjtë e Elbasanit, Tiranës, Rrëshenit, Shkodrës, Dervicanit, Pogradecit dhe Kamzës. Inicuar nga zyra Rajonale për Bashkëpunim, ky projekt ka marrë mbështetjen dhe aprovimin tonë që në fillim, sepse vjen si një skemë shkëmbimesh shkollore, që u jep mundësi nxënësve, por edhe mësuesve të shkollave të rajonit, jo vetëm të udhëtojnë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe të fitojnë njohuri shtesë dhe të bëjnë miq të rinj.

Një tjetër organizim ka qenë edhe festivali rinor 2-ditor i organizuar në shtator të vitit 2021, në bashkëpunim me *World Vision*, ku tema ka qenë “Angazhimi Rinor në Ballkanin Perëndimor” dhe qëllimi ka qenë promovimi i mundësive dhe projekteve për aktivizimin, shkëmbimet në rajon, avokatia, krijimi i dialogut midis të rinjve, por edhe aktorët kryesorë politikbërës së bashku me të rinjtë për të nxitur aktivizimin rinor, por edhe kohezionin social.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë të rinjtë që kanë zhvilluar biseda konstruktive me qëllim llogaridhënien me kryetarët e njësisë të vetëqeverisjes vendore të qyteteve të Dibrës, Kurbinit, Shkodrës, Kamzës, Durrësit, Librazhdit, Korçës dhe Maliqit.

Një tjetër pjesë e bashkëpunimit rajonal ka qenë edhe hartimi i draftmarrëveshjes me Kosovën. Tashmë kemi përgatitur variantin e parë të marrëveshjes nga pala jonë, që i është përcjellë për rishikim dhe mendim palës së Kosovës. Gjithashtu, është bërë një rishikim me koordinatoren e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë dhe është realizuar një takim i nivelit teknik mes të dyja palëve. Pas rishikimit pritet të vijohet me fazat e tjera deri në firmosjen e marrëveshjes së re, e cila parashikon një bashkëpunim dhe mbështetje të mëtijshme në fushën e rinisë midis të dyja qeverive.

Këto ishin për sa u përket projekteve në fushën e rinisë.

Do të doja të ndalesha sado pak edhe te projektet për fushën e fëmijëve, ku i pari është programi i kodimit për fëmijët e klasave të para. Në përmbushje të kompetencave që ka institucioni ynë për zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës dhe fëmijës në shkollë, kemi ngritur një grup ndër-institucional pune, të cilin kam fatin ta kryesoj, ku përfshihen edhe anëtarë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Qëllimi i këtij grupi pune ka qenë analizimi i situatës së kurrikulave të lëndës së teknologjisë së informacionit në arsimin parauniversitar, por edhe përditësimi i kurrikulave ekzistuese në mënyrë bashkëkohore. Me kërkesën time janë përfshirë në grupin e punës edhe ekspertë të fushës së teknologjisë dhe informacionit dhe të arsimit parauniversitar nga fondacioni shqiptaro-amerikan për zhvillim, AADF-ja.

Në vijim të aktiviteteve dhe proceseve të ndërmarra, grupi ndër-institucional i punës, gjatë periudhës janar-prill 2022 ka zhvilluar një sërë aktiviteteve dhe ka dakordësuar një numër çështjesh me rëndësi për sa u përket përgatitjeve të programit të teknologjisë së informacionit në klasën e parë, ku përfshihet përgatitja e propozimeve për rishikimin e planit mësimor të arsimit bazë për përfshirjen e lëndës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që nga klasa e parë; është identifikuar profili i mësuesve që do të zhvillojnë programin e teknologjisë së informacionit në klasën e parë; është përgatitur plani mësimor i lëndës së TIK-ut për klasat e para deri në të treta, si dhe është përgatitur shtrirja dhe afatet e zbatimit të lëndës së re të TIK-ut që në klasën e parë.

Gjithashtu, janë përzgjedhur edhe 100 shkolla në të gjithë vendin për zbatimin e lëndës së TIK-ut në klasën e parë për vitin 2022-2023.

Grupi ndërinstitucional i punës ka evidentuar edhe nevojat teknike për zhvillimin e kësaj lënde në klasën e parë, duke përfshirë pjesën e plotësimit të shkollave fillore me laboratorët e nevojshëm të informatikës, hartimin e kurrikulave të reja për lëndën e teknologjisë së informacionit, sigurimin e platformës *online* ku do të zhvillohet kjo lëndë, por edhe trajnimin e mësuesve të TIK-ut për të mbështetur mësimdhënien.

Me qëllim plotësimit të këtyre nevojave dhe realizimit të objektit për zbatimin e këtij programi, duke filluar nga ky vit, si dhe duke pasur në konsideratë angazhimin dhe punën paraprake gjatë fazës së parë, kemi udhëhequr procesin e konsultimit dhe bashkëpunimit me fondacionin shqiptar-amerikan për zhvillim për bashkëfinancimin e kësaj nisme. Aktualisht jemi duke finalizuar miratimin e memorandumit të mirëkuptimit në Këshillin e Ministrave dhe AADF-së, që do t'i hapë rrugë ndërtimit të 100 laboratorëve kompjuterikë në 100 shkollat fillore të vendit, por edhe sigurimin e ekspertizës kombëtare dhe ndërkombëtare për hartimin e kurrikulës së TIK-ut nga klasa e parë në të tretën të shkollave fillore publike dhe trajnimin e mësuesve të TIK-ut për 4 vjet dhe prokurimin e platformës *online* për të mbështetur mësimdhënien. Objektivi i qeverisë është që kodimi në klasën e parë të fillojë në 100 shkolla të shpërndara në Republikën e Shqipërisë në vitin shkollor 2022-2023 dhe të shtrihet në të gjitha shkollat fillore të vendit në 4 vjetët e ardhshëm.

Gjatë kësaj periudhe kemi zhvilluar programin jashtëshkollor për fëmijët dhe të rinjtë. Në bashkëpunim me ASKAP-in, me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë, por edhe ekspertë të UNICEF-it ne kemi përgatitur draftin e programit për aktivitete jashtëshkollore, të cilat synohen të implementohen në 230 shkolla në të gjithë vendin. Ky program ka qëllim të ofrojë kurse jashtëshkollore në 5 disiplina të ndryshme për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në disiplinat e arteve, zejeve, agrikulturës dhe mjedisit, sportit dhe teknologjisë së informacionit.

Gjatë periudhës tetor-dhjetor ne kemi realizuar ngritjen e grupit të punës me përfaqësues nga ministrinë e linjës, që sapo i përmenda, dhe është realizuar identifikimi dhe analiza e situatës për zbatimin e këtij programi jashtëshkollor. Pjesë e grupit të punës kanë qenë edhe ekspertë të huaj, që kanë asistuar për hartimin e këtij programi. Në takimin e grupit të punës, që kemi mbajtur në tetor të vitit të shkuar është vendosur të realizohej një analizë për identifikimin e situatës për zbatimin e programit jashtëshkollor. Kjo analizë është

përfunduar, duke grumbulluar të dhëna për rreth 50 indikatorë nëpërmjet një pyetësoi *online* në të gjitha shkollat dhe është diskutuar në mbledhjen e mbajtur në nëntor.

Gjatë muajve dhjetor 2021-janar 2022 është përditësuar analiza me të dhënat e mëtejshme, që u cilësuan si të nevojshme, duke përfshirë elemente, si: vendndodhja gjeografike e palestrave të ndryshme për çdo bashki, inventari i klubeve jashtëshkollore ekzistente në shkollat e identifikuar, por edhe listën e të diplomuarve nga liceu apo nga shkollat profesionale, me qëllim përfshirjen si pjesë e këtij programi.

Gjatë kësaj periudhe është hartuar drafti i programit, janë plotësuar kurrikulat për pjesën e agrikulturës dhe teknologjisë së informacionit, sipas një formati të miratuar paraprakisht nga ASKAP-i dhe po vijohet përgatitja e kurrikulave për disiplina të tjera.

Gjithashtu, është marrë edhe një ekspertizë teknike për sa i përket pjesë së kostimit, të cilët tashmë janë duke bërë përlllogaritjet e kostove shtesë të nevojshme për implementimin e këtij programi, duke filluar nga pagesat shtesë për mësuesit dhe kordinatorët e ndryshëm të angazhuar si pjesë e programit, por edhe për bazën materiale, për implementimin e tij.

Programi nivelit të parë do të jetë direkt pas orarit të mësimit dhe do të zhvillohet në shkollat ku fëmijët marrin mësimin gjatë ditës nga e hëna në të premte, ndërkohë që pjesa e dytë e programit do të zhvillohet në fundjavë, duke i dhënë mundësi fëmijëve të angazhohen në aktivitete edhe pas standardit normal të zhvillimit të mësimit.

Për sa u përket arteve, siç e përmenda, jemi duke bashkëpunuar me Ministrinë e Kulturës me qëllim ndërtimin e kurrikulave të ndryshme, si për artin muzikor, pamor, teatral, instrumental dhe vokal, dhe kemi identifikuar fushat e përshtatshme, tashmë jemi në kuadër të përgatitjes së kurrikulave për të tria hallkat e ndryshme të implementimit të këtij programi.

Për sa u përket zejeve kemi menduar zeje të ndryshme krahinore, duke identifikuar pjesën e trashëgimisë jomateriale, që ndonjëherë humb midis brezave. E kemi menduar të arsyeshme që edhe brezi i ri ta marrë këtë element shtesë të kulturës sonë.

Për sa i përket pjesës së agrikulturës dhe mjedisit jemi duke bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe po hartojmë kurrikulën me ekspertët e Universitetit Bujqësor dhe jemi duke planifikuar një pilotim të vogël përpara muajit shtator, në mënyrë që të kuptojmë edhe sfidat që mund të hasen gjatë rrugës përpara implementimit në shkallë vendi. Kemi bërë një përlllogaritje të buxhetit për sa i përket implementimit të pjesës së agrikulturës dhe mjedisit dhe kemi identifikuar që mësuesit e dituri-natyrës dhe mësuesit e biologjisë mund të jenë më të përshtatshmit për t'u angazhuar në këtë program.

Gjithashtu, për sa i përket këtij plani strategjik janë menduar edhe disa aktivitete shitesë në bashkëpunim me ministritë e linjës, duke filluar me Ministrinë e Kulturës, ku janë parashikuar vizita të ndryshme në muze nga nxënësit, në site arkeologjike, por edhe në kalatë e zonave. Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë kemi parashikuar vizita në qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore, por edhe në fermerë të ndryshëm në zona, që fëmijët të kuptojnë pak më shumë se si zhvillohet fusha e bujqësisë.

Për sa i përket sportit, në kuadër të të gjitha aktiviteteve që ofron ky program, duke qenë se te pjesa e sportit përmenda pak më parë programin që po implementohet nga Komiteti Olimpik Shqiptar, kemi menduar të shtojmë një element të ri dhe në shtator të këtij viti, kur të fillojmë pilotimin e kësaj skeme, menduam që pjesë e përfshirë në këtë program të jetë edhe programi për fuqizimin nëpërmjet vetëmbrojtjes. Kjo është një lëvizje botërore, që u shërben të rinjve dhe fëmijëve për të mësuar të mbrohen, kryesohet vajzave dhe pjesës më të pambrojtur të popullsisë. Ky program është implementuar tashmë në Shqipëri, por po mendojmë shtrirjen e tij në një shkallë më të gjerë. Me anë të këtij programi, qëllimi është që fëmijët dhe të rinjtë të mësojnë mjete për të luftuar abuzimin verbal, abuzimin emocional, por edhe dhunën fizike.

Gjithashtu, shërben për të mundësuar një strategji komunikimi pa dhunë dhe praktika mbrojtjeje për fëmijët dhe të rinjtë, si të kundërshtojmë gjuhën e urrejtjes dhe bullizmin *online*, dhe një lojë me role, që ofron aftësitë për t'u ndjerë të sigurt në mjedisin ku ndodhen, por edhe i informon për rrjetet formale dhe joformale të ndihmës që ata kanë akses gjatë përditshmërisë së tyre.

Elementi i fundit i programit është pjesa e teknologjisë. Zhvillimi i aftësive teknologjike është një domosdoshmëri për brezin e ri dhe ne synojmë që përmes këtij programi nxënësit të angazhohen në aktivitete, duke filluar nga mënyra se si të përdorim një kompjuter, si të instalojmë një sistem operativ, si të krijojmë një rrjet, si të përdorim pajisjet e reja të kodimit të *Micro:bit*-it dhe *Scratch*, por edhe shumë elemente të tjera.

Projekti i përfshirjes së njohurive teknologjike që nga klasat e hershme, por edhe përditësimi i kurrikulave ekzistuese, sipas nevojave të tregut, synon përgatitjen e nxënësve dhe studentëve për zhvillimet e fundit të teknologjisë.

Një element tjetër, për të cilin po punojmë, është ndërtimi i një aplikacioni *online* për mbrojtjen nga bullizmi. Në konsultimet paraprake që kemi kryer për strategjinë kombëtare të rinisë, 1200 nxënësit që kemi takuar kanë shprehur në mënyrë të vazhdueshme që ndihen të paragjykuar kur shkojnë të takojnë një punonjës psiko-social, ndonëse këta punonjës janë

nëpër shkolla, në momenti që të rinjtë shkojnë për t'i takuar, ndihen të paragjykuar për këtë pjesë. Duke qenë se ky është një element shumë i rëndësishëm, pas pjesës së pandemisë për të rinjtë, kemi filluar tashmë punën për krijimin e një aplikacioni interaktiv dhe të thjeshtë, që të shërbejë si një qendër raportimi dhe informimi për fëmijët, për të rinjtë, por edhe për prindërit për bullizmin dhe për dhunën verbale dhe të mundësojë një konsultim *online* me punonjës të sistemit psiko-social. Ky projekt do të realizohet me të gjitha institucionet që kanë ndërprerjen e pjesës së fëmijëve, duke filluar nga AKSHI për pjesën teknologjike, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Drejtësisë.

Tashmë kemi filluar punën dhe jemi në hapat e ndërtimit të këtij procesi. Sigurisht, do t'ju mbaj në dijeni për hapat e mëtejshëm.

Programi i fundit për fëmijët është edhe mikrofolia. Nuk e di nëse ju ka rënë rasti ta shikoni, një tendë e vendosur afër Kryeministrisë, një projekt ose instalacion, që ka si koncept kryesor edukimin dhe argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve nëpërmjet dhënies së aksesit në kënde të ndryshme: lojëra, edukim, bota e librit, printim tredimensional, realitet virtual dhe shumë të tjera. Ky program menaxhohet nga Bashkia Tiranë, por Ministria e Kulturës dhe institucioni që unë drejtoj kemi bashkëpunuar me qëllimin angazhimin e sa më shumë fëmijëve dhe të rinjve për ta shfrytëzuar këtë program kaq interaktiv për ta. Praktikisht, mikrofolia është një laborator digjital, ku mund të gjenden shumë gjëra, duke filluar nga muzeu digjital, ku të rinjtë dhe fëmijët mund të shikojnë vepra të artit botëror vetëm nga tenda e vogël e mikrofolisë. Hapësira e laboratorit lejon fëmijët dhe të rinjtë të ushtrorjnë aftësitë e tyre krijuese dhe praktike, ndërkohë që kanë edhe një aftësi biblioteke, ku mund të lexojnë vepra të ndryshme, si në gjuhën mëmë, edhe në gjuhë të huaja. Mikrofolia ka filluar më 14 janar 2022 dhe ka funksionuar në mënyrë të vazhdueshme nga e marta në të premtën për fëmijët dhe të rinjtë nga institucionet arsimore, ndërkohë që në fundjavë është lejuar e hapur për vizita nga fëmijët dhe nga prindërit. Praktikisht janë pritur gjithsej 3340 nxënës shkollash dhe kopshtesh që nga dita e hapjes dhe deri në muajin prill. Në fundjavë mikrofolinë e kanë vizituar kryesisht 100-150 persona për çdo ditë, një total prej 1163 personash të interesuar për aktivitetet, eventet, trajnimet dhe *workshop*-et.

Më konkretisht gjatë fundjavës janë zhvilluar 38 aktivitete.

Sa më sipër ishte një përmbledhje e punës së kryer deri tani, por edhe e programeve që janë në proces. Shpresoj shumë të mund të vijojmë bashkëpunimin tonë edhe në të ardhmen, për t'i promovuar sa më shumë këto programe, si për të rinjtë, edhe për fëmijët.

Faleminderit!

Flutura Aça – Zonja Ministre, faleminderit!

Unë ju ndoqa me shumë vëmendje dhe më vjen mirë që për një kohë kaq të shkurtër në këtë ministri, të paktën nga fjalët këtu, duket sikur keni punuar më shumë sesa ata që kanë ardhur, të cilët kanë pasur me vite në ministri, dhe na i kanë mbajtur “sekret”, nuk na i kanë treguar gjërat me kaq transparencë. Në këtë pikë më vjen mirë që i keni dhënë edhe rininë tuaj kësaj performance.

Gjithsesi, kuptohet qartë që ju jeni e ndarë nga ministrinë e tjera, duhet të profiloheni dhe kjo ju pengon, normalisht. Në disa raste m’u krijua përshtypja që më shumë merreni me grante sesa me gjërat konkrete. Çështjet e fëmijëve dhe rinisë sot janë çështje shumë konkrete dhe shumë delikate në Shqipëri, sepse të gjithë fëmijët po ikin.

Megjithatë, në përmbyllje përmendët Bashkinë e Tiranës me projektin e përbashkët, që është gjë shumë e mirë, por përpara kësaj, Bashkia e Tiranës duhet t’u krijojë mundësi dhe t’u lërë ajër fëmijëve dhe të rinjve të marrin frymë, më pas le të ngrerë shatore dhe të bëjë *show* me gjëra të kësaj natyre. Këtë po e them nga ajo që unë gjykoj si qytetare e Tiranës dhe e Shqipërisë.

Kolegët do t’ju bëjnë pyetje.

Nëse dëshironi, mund t’i përgjigjeni çdo kolegu, ose t’i mblidhni pyetjet për në fund, por unë mendoj që është mirë që t’u përgjigjeni pyetjeve të çdo kolegu.

Unë kam edhe disa pyetje të miat, por më parë dua t’ua jap fjalën kolegëve të tjerë.

Për procedurë, zoti Boçi, keni fjalën.

Luçiano Boçi – Së pari, meqenëse unë mungova në mbledhjen e kaluar, 1/3-ta e deputetëve të këtij komisioni ka bërë një kërkesë me shkrim, të cilën e ka dorëzuar, për seancë dëgjimore me ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile në lidhje me çështjen e Butrintit, po e perifrazoj, nuk po i referohem projektvendimit apo projektligjit të sjellë në komision, ka pasur kundërshti, nuk është pranuar nga pjesa e maxhorancës. Ndërkohë, nga mënyra si zhvillohen seancat dëgjimore në këtë komision, por jo vetëm kjo, por edhe si e përcakton Rregullorja e Kuvendit, neni 36, e ka të saktësuar shumë mirë, nuk lë vend për ekuiwokë dhe interpretim, në pikën 1 përcakton që komisioni zhvillon seanca dëgjimore me këta përfaqësues qoftë nga Këshilli i Ministrave, shoqëria civile, ekspertë, me 1/3-ën e firmave ose të kërkesës së deputetëve dhe komisioni është i detyruar ta zhvillojë seancën dëgjimore. Është i detyruar, e ka në Rregullore.

Atëherë, në bazë të kalendarit për çështjen e Butrintit ne të thërrasim ekspertët, përfaqësues të shoqërisë civile, dhe t’i dëgjojmë. Nuk ka rëndësi se kur do të jetë kalendari, si

nesër, si pasnesër, e rëndësishme është të zhvillohet seanca dëgjimore. Kjo ishte kërkesa ime për procedurë.

Ndërkohë, duke dashur t'u lë vend edhe kolegëve të tjerë, sepse zakonisht më qëllon ta marr fjalën i pari dhe të ezauroj edhe pyetjet e të tjerëve, unë do të bëj vetëm 2 pyetje, zonjushë Ministre.

Bora Muzhaqi – Zonjë.

Luçiano Boçi – Më fal, zonjë, nuk e dija. Po hezitaja, në fakt, po të thosha “zonjë” mendoja se do të bëja gabim. Në fakt, ky tjetri është gabim më i vogël, ai i pari do të ishte më i madh.

Faleminderit për paraqitjen tuaj!

Unë kam 2 shqetësime, që janë shumë thelbësore.

Shqetësimi i parë ka të bëjë me fëmijët shqiptarë të pashoqëruar, që kërkojnë azil. Shqipëria është e para në rajon dhe dua të di: sa është numri i fëmijëve shqiptarë të pashoqëruar, që kanë kërkuar azil në vendet e BE-së dhe cilat janë masat që ka marrë ministria juaj për ta kufizuar këtë proces?

Ndërkohë, sa për krahasim, numri ekziston, Maqedonia e Veriut ka vetëm 20 kërkesa, ndërsa Kosova dhe Mali i Zi kanë 0 kërkesa. Pra, ka një kujdes shumë të madh për fëmijët.

Çështja tjetër lidhet me ngjarjen e djeshme, që është shumë sensitive, e cila ka të bëjë me edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në raport me promovimin e simboleve dhe rikthimin e simboleve të komunizmit. Marr shkas nga ngjarja e Cërrikut, por edhe vetë para 1 muaji kam bërë një denoncim tjetër, ku nxënës të gjimnazit në Elbasan, në orën e leximit, një orë që zhvillohet ditën e premte, kanë inskenuar pjesë nga filmi “Debatiku”. Kanë punuar gjerë e gjatë për këtë, e kanë hedhur edhe në rrjetet sociale e të tjera. Ky është një realitet i pamohueshëm dhe nuk kanë ndodhur vetëm këto ngjarje, janë evidentuar edhe ngjarje të tjera. Ndërkohë, sipas rezolutave të BE-së, Shqipëria e ka detyrim të mos u rikthehet simboleve të komunizmit, sepse janë të dënuara tashmë. Cilat janë masat që keni marrë ju, si ministri, që këto ngjarje të mos ndodhin, aq më tepër, që jemi në përsëritje? Ne flasim për edukim me internet, me programim, me gjëra fantastike, europiane, ndërkohë që rininë, fëmijët i kthejmë vite e vite pas, në ato vite të errëta, përpara viteve '90, nëpërmjet formave të tilla, që do t'i quaja të hapura tashmë, nuk janë as djallëzore, janë fare të hapura dhe ndikojnë në mënyrën se si të rinjtë ndërtojnë të ardhmen e tyre në raport me vlerat e Bashkimit European. Cilat janë masat që keni marrë për ta ndaluar një fenomen të tillë në përhapje të gjerë në shkollat tona?

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Boçi!

Fjala është për zonjën ministre!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, të dëgjojmë përgjigjet dhe flasim pastaj.

Zoti Spaho, të lutem, të bëj një ndërhyrje të vogël?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Spaho, zonja ministre sapo tha që janë akoma të pashkëputur plotësisht nga ministria; është normale që këto gjëra edhe të ndërthuren me njëra-tjetrën.

Zonja Ministre, ju lutem, fjala është për ju.

Bora Muzhaqi – Së pari, nëse do të mund të kërkoja diçka, duke qenë se të paktën në komisionet e mëparshme zakonisht ka pasur shumë përsëritje pyetjesh, por edhe për t'ju kursyer kohën, do të doja të bënim një kalim të të gjitha pyetjeve dhe të mund t'i identifikojmë sipas radhës. Siç e shihni, unë jam duke mbajtur shënime. Ju premtoj se të gjitha pyetjeve, edhe nëse nuk do të arrij dot sot, do t'u kthej përgjigje me *e-mail*. Nuk do të lë asnjë pyetje pa përgjigje, por në kuadër të kohës do të doja shumë t'i dëgjoja të gjitha pyetjet, në mënyrë që të mos kemi përsëritje.

Flutura Açka – Si të dëshironi ju, por në praktikën e këtij komisioni është që çdo deputet dëgjon përgjigjen, pasi mund të ketë edhe ndërhyrje ndërkohë, nëse përgjigjja juaj nuk i duket e plotë. Të paktën, në këtë komision kjo është praktika, nëse është e mundur.

Bora Muzhaqi – Nuk do ta ndryshojmë praktikën?

Flutura Açka – Jo, nuk do ta ndryshojmë.

Bora Muzhaqi – Dakord.

Faleminderit për pyetjet!

Në fakt, unë e detajova shumë gjerë të gjithë aktivitetin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ku duhet theksuar edhe pjesa e diferencës që, në fakt, nuk është një ministri, por një ministër Shteti, që do të thotë se ka një kabinet relativisht të vogël dhe nuk ka një portofol. Kjo do të thotë se një pjesë e madhe e detyrave dhe angazhimeve që ne ndërmarrim si kabinet dhe unë, si ministre, bëhet në bashkëpunim me ministrinë e tjera. Të dyja fushat që iu referuat janë fusha për të cilat patjetër do të më duhet të bashkëpunoj me ministrinë e linjës.

E para, në dijeninë time është diçka që duhet koordinuar me 2 ministri dhe patjetër duhet të marr të dhënat e nevojshme. Nuk mund të kthej një përgjigje për të dhënat specifike

për numrin e fëmijëve që kanë kërkuar azil, por patjetër mund t'i gjej, t'i identifikoj, t'jua bëj me dije, duke ju përmbledhur edhe të gjitha masat që janë marrë nga institucionet, me të cilat ne bashkëpunojmë.

Ndërsa për sa i përket pyetjes së dytë, është diçka për të cilën ndoshta nuk jam personi më i përshtatshëm për t'ju kthyer përgjigje. Do të doja shumë ta bëjë këtë dhe patjetër që do të marr masat e duhura për t'ju kthyer një përgjigje.

Arsyeja e ardhjes sime këtu sot, ju falënderoj për ftesën, mbi të gjitha është që të kërkoj edhe rekomandimet tuaja. Ju e dini që ky është një institucion i ri, i cili ka filluar punën nga 21 shtatori i vitit të kaluar, që do të thotë ka vend për përmirësime, ka vend për rregullime, ndaj edhe çdo sugjerim që ju bëni për tematika të rëndësishme, të cilat ne duhet t'i adresojmë si pjesë e punës sonë, patjetër jemi të gatshëm ta bëjmë pjesë të punës.

Kështu që, ju falënderoj për të dyja komentet, por nuk jam në gjendje në këtë moment të kthej një përgjigje specifike për të dyja fushat, por premtoj se do ta kesh një përgjigje nga ana e institucionit tim, pas konfirmimit me të 2 ministrinë e linjës, që janë të angazhuara në mënyrë të drejtpërdrejtë me fushat, të cilave iu referova.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja Ministre!

E kuptoj që kabineti dhe koncepti i ministrisë është diçka e re në konfigurimin qeveritar të qeverive që janë pas viteve '90, sepse kemi qenë të vëmendshëm në këtë pikë dhe ndoshta keni të drejtë që nuk e dini numrin e azilantëve fëmijë, por është një problem, që është mediatik dhe ndërkohë ju duhet të ishit interesuar. Thashë, nuk është faj i drejtpërdrejtë, por një interesim në raport me ministrinë përgjegjëse për çdo çështje që lidhet me fëmijët, sepse siç ju i shihni pozitivisht për t'iu futur programe të reja në shkolla, që ka lidhje me Ministrinë e Arsimit, sepse edhe kjo nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me ju, të gjitha ato që ju thatë s'kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ju, duhet të shqetësoheni edhe në rastin kur ka keqtrajttime, kur ka raste të vështira të fëmijëve dhe të jepni edhe ju qëndrimet dhe deklaratat tuaja. Gjëja e parë që duhet të bënit paraprakisht është qëndrimi në raport me fenomenin e azilit nga fëmijët e pashoqëruar, sepse Shqipëria është e para në rajon dhe është shqetësim.

Ndërsa për rastin tjetër, e di që nuk është e drejtpërdrejtë, asgjë nuk del e drejtpërdrejtë te ministria juaj, si ministri me portofol të tillë për të menaxhuar. Të gjitha janë në lidhje me ministrinë e tjera, se qeverisja është një, por ju për të gjitha rastet duhet të ngrini shqetësimet tuaja dhe të merrni masat që ju takojnë. Nuk po them të urdhëroni Ministrinë e Arsimit, por ta ngrini si shqetësim në një takim bilateral, në një takim më të gjerë me stafet, sepse është fenomen i përsëritur. Nuk është se ndodhi kjo ngjarje dhe unë po bëj atë zhurmën

e madhe. Unë shqetësohem, sepse është bërë rregull, është bërë fenomen kjo gjë. Herë pas here shkollat tona kanë shfaqje të stimuluar të simboleve të komunizmit, ndërkohë ne e kemi dënuar atë periudhë, ka rezoluta për dënimin e krimeve të komunizmit dhe ne nuk duhet të vazhdojmë t'i edukojmë fëmijët tanë me këtë frymë. E di që si ministre nuk keni gjë në dorë për t'i ndaluar, por disa reagime ju duhet t'i keni dhe duhet të shqetësoheni për të gjitha fenomenet.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Boçi!

Fjalën e kanë zoti Ajazi dhe më pas zonja Bakiu.

Besion Ajazi – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Ministre, mirë se erdhët në komision!

Faleminderit për prezantimin pak të gjatë, por të detajuar!

Për shkak të atij prezantimi, realisht u kam vënë kryq 3 pyetjeve, sepse e mora përgjigjen, por përpara se të kaloj te pyetjet, më duhet t'ju them që personalisht, jo ju në emër nominal, por çdo ministër, që do të ishte aty, e mbështes dhe do ta mbështesja në vazhdim edhe për shkak të vështirësive që ju thatë, duke qenë se jeni një ministri shteti pa portofol dhe me një kabinet jo të plotë dhe jo me atë numër stafi që do të duhej të ishte, por edhe për faktin që është një ministri e re, e ngritur rishtazi dhe e ndarë nga ministritë e vjetra të linjës dhe, sigurisht, duke qenë se keni një fushë shumë specifike dhe delikate në veprimtarinë tuaj, siç janë të rinjtë dhe fëmijët, që janë e ardhmja, janë Shqipëria e nesërme.

Unë kam 2-3 pyetje të shkurtra.

Pyetja e parë është: nga dita që ju keni marrë detyrën e deri sot çfarë ka ndryshuar në politikat rinore, projektet, mbështetjen që ju jepni e të tjera? Ju e thatë pak a shumë, por të jetë më e qartë edhe për ne, edhe për opinionin publik dhe për të interesuarit që na ndjekin.

Pyetja e dytë është: cili është vizioni juaj apo programi juaj për aktivizimin e të rinjve? Çfarë po bëni dhe çfarë do të bëni?

Pyetje e tretë është: a ka përfitues nga thirrjet ndërkombëtare, nga grantdhëniet? Sa është fondi që ne kemi përthithur deri tani nga organizatat rinore?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flutura Açka – Dua t'ia bëj më të lehtë zonjës ministre, është më e lehtë për të.

Bora Muzhaqi – Faleminderit për pyetjet!

Në lidhje me pyetjen e parë, se çfarë ka ndryshuar në politikat rinore, siç përmenda gjatë fjalës sime, pika e parë që ka ndryshuar është zbatimi më i mirë i ligjit “Për rininë”. Përpara krijimit të këtij institucioni një pjesë e akteve nënligjore të ligjit “Për rininë” nuk kishin përfunduar, tashmë të gjitha aktet nënligjore të ligjit “Për rininë” janë kryer me sukses.

Për sa i përket krijimit të këshillave vendore rinore, ndonëse është një detyrim i bashkisë, ne jemi angazhuar aktivisht për t’u qëndruar afër, për t’i asistuar, për t’i ndihmuar që në momentin e parë që ky institucion është ngritur. Siç e përmenda, nuk kemi pasur kurrë një strategji të dedikuar për të rinjtë në Shqipëri, tashmë jemi në fazën e finalizimit të një strategjie kombëtare për rininë, që do të jetë për 7 vitet e radhës. Gjithçka është bërë në bashkëpunim me kuadrin rregullator të IPSIS-it dhe çdo gjë në përputhje edhe me direktivat e planit të Bashkimit Europian për të rinjtë. Sigurisht, kjo nuk është një letër dhe një copë dokumenti, që nuk ka elemente konkrete. Çdo pikë që përmenda në lidhje me strategjinë kombëtare të rinisë është e mbështetur drejtpërdrejtë me një program, që shërben për nxitjen dhe fuqizimin e të rinjve, duke filluar nga fuqizimi i zërit të tyre nëpërmjet Këshillit Kombëtar Rinor, fuqizimi nëpërmjet këshillave vendore rinore, ofrimi i më shumë mundësive.

Ju përmendët fjalën “grante” më parë dhe, në fakt, një nga elementet kryesore që Agjencia Kombëtare e Rinisë kryen është menaxhimi i fondeve për rininë. Janë fonde shumë të pakta, por po bëjmë maksimumin që të kenë sa më shumë impakt tek të rinjtë. Sivjet plot 12 organizata të fushave nga më të ndryshmet kanë zhvilluar aktivitete nga njëri cep i Shqipërisë në tjetrin, me qëllim aktivizimin e të rinjve, përfshirjen e tyre, zhvillimin e kapaciteteve dhe njohurive, si në pjesën e vullnetarizimit të punës rinore, pjesën e promovimit të sipërmarrjes, pjesën e teknologjisë, por, mbi të gjitha, për të mësuar më shumë edhe për të drejtat e tyre.

Për shembull, javën e kaluar një nga organizatat që kishte fituar si pjesë e grantit të ofruar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë ka zhvilluar një trajnim psiko-social të të rinjtë, për t’u mësuar atyre si të mund të fuqizojnë shëndetin e tyre mendor, ku mund të drejtohen për problematika të ndryshme që mund të kenë hasur dhe, për më tepër, për të kuptuar pak më shumë edhe për veten e tyre.

Kjo është pak, ndërkohë ju përmenda edhe programin për teknologjinë, skemën tonë të mbështetjes për të rinjtë, që duan t’i futen fushës së teknologjisë.

Nga ana tjetër, është “Garancia rinore”, program i Bashkimit Europian, i cili do të fillojë implementimin shumë shpejt.

Të gjitha këto janë elemente të reja, nuk kanë ekzistuar më parë dhe patjetër, ndonëse detyra jonë shpesh lidhet me institucionet e ndryshme të qeverisë shqiptare, roli ynë është koordinues dhe shtesë. Në të shkuarën, përpara se ne të kishim një institucion, i cili menaxhonte në mënyrë të drejtpërdrejtë fushën e rinisë, problematika ka qenë që rinia shihej si një element shtesë. Detyra ime është që të gjitha institucioneve t'ua vendos rininë në kryeradhë. Ndonëse jo të gjitha iniciativat mund t'i bëjmë ne, me ekipin tonë të vogël, detyra jonë është të ngremë zërin, të tërheqim vëmendjen, të tregojmë elementet ku mund të bëhet më shumë dhe besoj se këtë e kemi bërë më së miri këta 7 muajt e fundit, me angazhimin e drejtpërdrejtë me të gjitha ministrinë e linjës, që merren drejtpërdrejtë me fëmijët dhe me të rinjtë. Është edhe komenti që i ktheva kolegut tuaj më parë, detyra jonë është, pikërisht kur shohim që ka problematika dhe situata që duhen zgjidhur, të bashkëpunojmë. Ndonjëherë nuk është nevoja të dalim nëpër media e të flasim, të tregojmë mendimin që kemi për çështje të ndryshme, disa gjëra ndodhin edhe thjesht në bashkëbisedime midis kolegësh, ku u vëmë në dijeni një problematikë shqetësuese dhe fillojnë e merren hapa të nevojshëm për zgjidhjen e kësaj problematike. Ndoshta unë kam pasur defektin që nuk kam dalë shumë në media për të treguar për punën, por kjo nuk do të thotë që puna nuk është kryer dhe kjo nuk do të thotë që bashkë me kolegët nuk kemi adresuar shumë çështje të rinisë.

Programi për aktivizimin e të rinjve lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me strategjinë. Strategjia ka shumë fusha të ndryshme, ka shumë masa konkrete, duke filluar nga elementet më bazike. Ju përmenda pak më parë këshillimin e karrierës. Ky nuk është një koment i ardhur nga zyrat e institucioneve, këshillimi i karrierës është një koment i ngritur drejtpërdrejtë nga të rinjtë.

Për shembull, në Bashkinë e Tiranës tashmë ne po implementojmë një model të ri, i cili është këshillimi i karrierës si shërbim komunitar, që do të thotë se përtej faktit që këshillimi i karrierës po zhvillohet nëpër shkolla, po kryhet edhe nëpërmjet bashkisë. Ky patjetër është një pilotim që po kryhet fillimisht këtu, është një financim nga organizata "Risi Albania", që po kryhet për herë të parë në Tiranë, por kjo nuk do të thotë që nuk do ta implementojmë dhe nuk do ta shtrijmë këtë program në të gjitha bashkitë e vendit pasi të shohim rezultatet, të shohim nëse ka qenë i suksesshëm dhe të rinjtë e kanë pëlqyer, i janë afruar dhe qasur këtij shërbimi.

Ndërkohë, këshillimi i karrierës, një nga elementet që po bëjmë së bashku me ministrinë e linjës, që është Ministria e Arsimit, po përgatitet të përfshihet në kurrikulat e klasës së nëntë. Kjo duket si diçka shumë e thjeshtë dhe pa impakt, por arsyeja pse impakti

është i madh, është se në këtë moment këshillimin e karrierës e zhvillojmë në vitin e tretë të gjimnazit dhe kjo është shumë vonë. Të rinjtë që duan të ndjekin arsimin profesional e kanë të pamundur ta bëjnë këtë, sepse e vetmja mënyrë për ta bërë është ta zgjedhin në klasë të nëntë, prandaj përfshirja e këtij elementi shtesë për orientimin e karrierës në klasën e nëntë do t'u ofrojë këtyre të rinjve të zgjedhin drejtimin profesional. Nuk është e thënë që të gjithë të rinjtë t'i drejtohen universitetit. Një pjesë e tyre mund të jenë më të aftë në fushat e trajnimit profesional, apo edhe më tej, mund të vendosin arsye të ndryshme për të zgjedhur në karrierën e tyre.

Përtej kësaj ka edhe elemente të ndryshme të rishikimit të kurrikulave lidhur me teknologjinë e informacionit. Ju përmenda pak më parë edhe laboratorët e rinj, të cilët do të përdoren jo vetëm nga 7 mijë fëmijë të klasave të para, por do të përdoren edhe nga 60 mijë fëmijë të arsimit parauniversitar. Jam e bindur që për çdo qytet që ju përfaqësoni këtu është një shkollë, sepse edhe shpërndarja gjeografike e tyre është bërë në mënyrë të atillë, për të kapur të gjithë diapazonin e Republikës së Shqipërisë dhe për të siguruar që pilotimi i këtij programi të jetë sa më i shpërndarë gjeografikisht.

Të gjitha politikat që ne po ndërtojmë për të rinjtë bazohen në aspektin lokal, prandaj unë u rikthehem disa herë këshillave vendore rinore, sepse ato janë thjesht një grup konsultues. Janë disa të rinj që qëndrojnë me kryetarin e bashkisë dhe kërkojnë llogari për mënyrën si shpenzohen fondet për të rinjtë dhe ky është një element shumë i rëndësishëm, sepse sado që ne, si institucion, të bëjmë nga Tirana për të rinjtë shqiptarë, është e pamundur të koordinohesh në të gjitha hallkat e ndryshme të zhvillimit lokal dhe të rinjtë, ndonëse politika mund të bëhet nga këtu, kanë nevojë për një qendër rinore në qytetin ku ndodhen.

Për shembull, javën e kaluar ne ishim në Berat dhe inauguruam qendrën rinore për të rinjtë e Beratit. Ky është një opsion shumë i mirë, pasi ata të rinj nuk do të vinin dot te qendra e Petrelës, që po ndërtojmë aktualisht. Prandaj edhe qëllimi i politikave të të rinjve, sigurisht është bazuar nga komentet e tyre.

Fola pak për pjesën e karrierës dhe arsimimit, por ndërkohë, edhe "Garancia rinore", edhe programet e ndryshme, që ne tashmë po ndjekim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit, fokusohen në mënyrë të drejtpërdrejtë te krijimi i kapaciteteve të të rinjve për të gjetur punë të denja, punë që paguhen mirë dhe që u lejojnë atyre të shohin Shqipërinë si zgjedhje.

Përveç kësaj, është edhe një element tjetër, që nuk duhet ta përmend shumë, është ndërkombëtarizimi i universiteteve, e cila është një platformë që po zhvillohet dita-ditës.

Ndonëse nuk është në fushën time të drejtpërdrejtë, është diçka që e kam ndjekur me shumë interes, sepse patjetër edhe të rinjtë e kanë kërkuar, në të gjithë konsultimin e strategjisë së rinisë.

Pyetja e fundit lidhet me grantdhëniet. Ju shpjegova që Agjencia Kombëtare e Rinisë ka një fond të limituar. Vitin e kaluar 48 milionë, nëse nuk gaboj, janë ofruar për të rinjtë, shumë kjo e ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë, 28,8 milionë për organizatat rinore dhe 19,2 milionë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pra një fond relativisht i vogël. Këtë vit kemi arritur ta dyfishojmë këtë fond dhe shpresojmë shumë se do të mbështesim edhe më shumë aktivitete për të rinjtë.

Për t'ju shpjeguar thjesht, kjo nuk është agjencia apo ministria që kryen aktivitete për të rinjtë. Këto janë organizata që gjenden në terren, gjenden në qytetet e Shqipërisë, punojnë çdo ditë me të rinjtë, aktivizohen me ta, kuptojnë se cilat janë nevojat e tyre. Nëse do të listoja tani të gjitha aktivitetet e bëra nga organizatat, do të kuptonit sa impakt kanë pasur, por duke qenë se nuk dua t'ju marr kohë, po ju përmend vetëm një shembull.

Javën e kaluar zhvilluam aktivitetin gala të një prej organizatave, qëllimi i të cilës ishte zhvillimi i audicioneve në 6 qytete të Shqipërisë, ku morën pjesë plot 1600 të rinj, nëse nuk gabohem, nga të cilët 150 prej tyre u përzgjedhën, u trajnuan në disiplina të ndryshme si kënga, kërcimi, vallëzimi dhe teatri dhe më tej bënë një shfaqje shumë të bukur, ku, në monitorimin e ekspertëve të fushës, zhvilluan edhe talentet dhe krijimtarinë e tyre. Ishin nga të gjitha qytetet e Shqipërisë, erdhën në Tiranë, zhvilluan një shfaqje, që kënaqi prindërit e tyre. Kjo duket diçka e vogël, por në jetën e të rinjve të disa prej zonave të Shqipërisë, ku aktiviteti është i pakët, bën një ndryshim të madh.

Kjo është thjesht për t'ju konkretizuar natyrën e granteve. Ne bëjmë monitorimin e këtyre projekteve në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar që impakti tek të rinjtë e zonave të ndryshme të jetë sa më i madh dhe, për të qenë e sinqertë, edhe ndryshimi, që po bëjmë tani në VKM-në e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, për të siguruar që procesi të jetë sa më transparent, sa më eficient dhe konform të gjitha standardeve të bashkimit European, ka pikërisht këtë qëllim. Ka edhe një qëllim pak më të gjerë dhe shpresoj shumë në mbledhjen e radhës, kur të kemi një dëgjese me ju, të mund t'ju them, është që Agjencia Kombëtare e Rinisë të mos funksionojë vetëm si një institucion që varet nga buxheti i shtetit, por në të ardhmen të ketë edhe mundësinë të aplikojë për fonde të ndryshme nga Bashkimi European, për të siguruar që të rinjtë shqiptarë të kenë më shumë mundësi dhe, mbi të gjitha, të kenë më

shumë aktivitete, jo vetëm të limituar në buxhetin e ngushtë e të vogël, që siç e dimë, rinia ka në dispozicion tani që flasim.

Shumë faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Ministre!

Besion Ajazi – Një ndërhyrje shumë të shkurtër, nuk do t'ju marr shumë kohë.

Zonja Muzhaqi, kur ju pyeta për vizionin apo programin tuaj për aktivizimin e të rinjve, edhe për përgjigjen që dhatë, kisha parasysh edhe këtë të fundit që thatë. Morët një shembull një organizim nga një aktivitet gala i një organizate, ku ishin 1600 të rinj, u përzgjodhën 150, bënë një shfaqje dhe, me të vërtetë, ai perceptimi juaj është real. Janë shumë fëmijë, në disa zona të Shqipërisë, kryesisht në qytete të vogla, që nuk kanë asgjë për sa u përket aktivizimit rinor, aktiviteteve, shfaqjeve të ndryshme, përfshirjeve të ndryshme dhe ndoshta nuk jam shprehur shumë qartë që në fillim, në bërjen e pyetjes dhe këtu ishte edhe thelbi i pyetjes. Në rregull ju keni një program, keni një vizion dhe po punoni, por çështja është që te këto qytetet të vogla, a keni gjëra konkrete, në mënyrë që të aktivizoni edhe ata të rinj se ka edhe atje të rinj, madje ka të rinj shumë të talentuar? Ky ishte thelbi, pavarësisht se për një pjesë të pyetjes e dhatë përgjigjen.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit!

Para se t'ia kaloj fjalën zonjës Bakiu, ju thatë se nuk jeni shumë mediatike. Në fakt, quajeni si vërejtje të bukur nga ana e këtij komisioni, duhet të jeni mediatike, sepse ju përfaqësoni Shqipërinë dhe ne kemi nevojë ta shikojmë Shqipërinë sot me sytë tanë, jo të vdekur. Kështu që duhet të jeni mediatike për ta dhe të mos i lini radhë politikës që t'ju marrë territoret, ku një pjesa jonë në parlament, duam apo nuk duam ne, janë të rrjedhur fare dhe nuk duhet të hyjnë fare në asnjë lloj ekrani. Kështu që bëjeni detyrën tuaj edhe mediatike, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë nuk e di unë, mund të fillojë edhe tek unë! Kështu që nuk e përjashtova as veten në këtë pikë, por që në sytë e mi ne u kemi marrë territor atyre të rinjve, kështu që merrini territoret që ju takojnë.

Faleminderit!

Zonja Bakiu.

Merita Bakiu – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre, për të gjithë performancën që dhatë!

Në fakt, diskutimin sot nuk do të doja që ta bënim fare politik. Arsyeja e vetme është se kemi të bëjmë me pjesën e rinisë dhe të fëmijëve, që është pjesa më e brishtë e shoqërisë dhe është e ardhmja e këtij vendi. Gjithashtu, duke qenë se edhe profesioni im është mësuese, kjo pjesë më bën që të jem më e ndjeshme në diskutimin e sotëm. Në fakt, duke dëgjuar atë çfarë ju thatë, unë do të dëshiroja që të gjitha ato që ju thatë në fjalën tuaj, të ishin vërtet reale, sepse në të vërtetë nuk ekzistojnë si të tilla.

Sot ne kemi një Shqipëri që po vuan një plagë të tmerrshme të 30 vjetëve të fundit, eksodin e të rinjve, që dihet se është plaga më e madhe e shoqërisë. E përmendi edhe zoti Boçi, dhe ju thatë se nuk e dinit, se nuk ishit shumë e informuar. Pyetja ime ishte e tillë: sa është numri i të rinjve që emigrojnë çdo vit? Mbase për këtë pyetje nuk keni një numër, sepse e përmendët që duhet të rakordonit me ministrinë e tjera, por cilat janë arsyet e emigrimit të këtyre të rinjve?

Duke u nisur nga statistikat e bëra nga Instituti i Statistikave në shkollat e mesme, për vitin akademik 2020-2021 janë regjistruar 107 mijë e 989 nxënës. Sivjet, për vitin akademik 2021-2022 janë 103 mijë 467 nxënës. Pra, i bie që janë rreth 5 mijë të rinj më pak. Ju thatë se po bënit arritje kaq të mëdha për rininë dhe bëtë një rezymë, atëherë si shpjegohet kjo ulje e numrit të të rinjve?

Gjithashtu, bëhet fjalë për studentët. Sot unë përfaqësoj një qytet të vogël, siç është Kruja, dhe ju folët për këshillat vendorë rajonale ose bashkiakë, mund ta themi. Kam qenë në kontakte të vazhdueshme me punonjës të administratës së bashkisë dhe di t'ju them që, në qoftë se themi sot Shqipëria po vuan një plagë të madhe që ka emigrimin e të rinjve, qyteti i Krujës dhe qytete të tëra të vogla kanë plagën tjetër të madhe, përveç këtyre të rinjve që kanë ngelur në Shqipëri, nuk kthehen pas studimeve universitare në qytetet e tyre. Sot, në bazë të statistikave, qyteti i Krujës ka një rritje të numrit të përqindjes së moshës plus 65-vjeçare dhe kemi një ulje të tmerrshme të përqindjes së moshave të reja. Atëherë, ju, si ministri e re që jeni dhe, gjithashtu, duke bashkërenduar me ministrinë e tjera, a keni projekte se si mund t'i ktheni këta të rinj që mbarojnë studimet e larta në qytetet e tyre? Ndërsa për pjesën e studentëve unë shikoj që në qytetin e Krujës shumë studentë, sidomos ata që kanë mbaruar infermieri dhe mjekësi, janë të larguar të gjithë nga Shqipëria dhe sot kjo është dhimbje e madhe. Në qytetin e Krujës vuajnë për specialistë, pasi mungojnë mjekët specialistë, sepse ata që kanë mbaruar, janë larguar nga Shqipëria. A ka ministria shifra të studentëve që kanë mbaruar studimet e larta në Europë dhe në botë? Si po bashkëveproni me përfaqësitë

diplomatike që ju të keni projekte për t'i tërhequr në Shqipëri këta studentë që kanë mbaruar studimet, në mënyrë që të kontribuojnë në vendin e tyre?

Gjithashtu, u fol për Agjencinë Kombëtare të Rinisë, e cila është një institucion që garanton dhe promovon të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes së edukimit joformal. Veprimtaria e AKR-së shtihet në të gjithë Shqipërinë, duke siguruar kushtet për mbështetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore. A keni projekte, edhe një herë, për bashkitë e vogla që t'i nxisin këta të rinj? Cilat janë programet e përbashkëta ndërmjet jush dhe AKR-së për vitin që jemi dhe periudhën afatmesme?

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, CRCA-ja, ka publikuar një raport të DASH-it që është e 15 prillit të vitit 2022. Ky raport i DASH-it sjell një tablo mjaft shqetësuese për problematikat e fëmijëve shqiptarë, ku i paraqet si viktimat të dhunës, të shfrytëzimit dhe të abuzimit, si dhe prek ngacmimin seksual në formë shqetësuese. Çfarë masash keni marrë ju si ministri? A keni kërkuar plotësimin e një kuadri ligjor, sepse duket që kuadri ligjor është i cunguar në këtë fushë?

Në raportin e Departamentit të Shtetit vjen shqetësimi ku kërkohet mbështetja e fëmijëve dhe e familjeve të tyre me ndihmë financiare dhe, gjithashtu, edhe mbështetje psikologjike për të gjitha ato familje dhe ata fëmijë, që raportojnë shfrytëzim ose dhunim në familje. A ka qeveria ndonjë plan se si mund të rregullohet kjo gjë? Deri sot që ne flasim, raporti i Departamentit të Shtetit tregon se nuk kanë asnjë lloj mbështetjeje nga ana e shtetit.

Fëmijët e trafikuar është problematika tjetër shumë shqetësuese nga raporti i Departamentit të Shtetit. Sjell në vëmendje se 80 fëmijë nën moshën 18 vjeç rezultojnë të humbur nga korriku i vitit 2020 e deri sot që ne flasim. Si është bashkëpunimi juaj me Ministrinë e Drejtësisë dhe masat që po merrni?

Folët pastaj kur diskutuat për programet lëndore në shkolla, ku thatë se keni disiplina lëndore. Në fakt, nuk janë disiplina lëndore, por janë fusha apo module lëndore që duhet të përdoren nëpër shkolla. Disiplinat janë diçka tjetër, që nuk kanë lidhje me atë që ju përmendët.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Bakiu!

Fjala për ju zonja Ministre.

Bora Muzhaqi – Faleminderit për pyetjet!

U përpoqa, në fakt, t'i mbaja shënim të gjitha dhe, me çfarë vura re, te dy temat e para diskutohej gjithmonë për largimin e të rinjve, numri i të rinjve që emigrojnë, ulja e numrit të

tyre në shkollat e mesme dhe pastaj ishte problemi më specifik i Krujës që nuk kthehen pasi kryejnë studimet në Tiranë, besoj, apo nuk kthehen më në Krujë. Ndjesë, vetëm po i konfirmoj që të mos kem humbur diçka nga biseda.

Së pari, siç e dini, është një institucion i ngritur më 21 shtator që do të thotë se një pjesë e madhe e asaj që unë fola deri tani janë kantiere të hapura, që do të thotë se janë programe që kanë nisur, që janë strukturuar, që janë hartuar, por nuk kanë filluar ende zbatimin. Unë mendoj fort se një nga pikat kyçe që e kemi diskutuar në mënyrë të vazhdueshme edhe me të rinjtë e Krujës, kemi qenë në takim me të rinjtë e gjimnazit “Skënderbeu” të Krujës dhe kudo që kemi shkuar, migrimi patjetër ka qenë patjetër një nga temat kryesore. Prandaj, edhe në Strategjinë Kombëtare të Rinisë kjo është një pikë kyçe dhe shumë nga masat që ne identifikojmë në Strategjinë Kombëtare të Rinisë lidhen me pjesën e migrimit. Ndonëse ndonjëherë duket sikur lidhja nuk është direkte apo e drejtpërdrejtë me pjesën e migrimit, impakti që ato kanë është fiks tek ajo fushë.

Unë ju përmenda pak më parë skemën për teknologjinë. Skema për teknologjinë duket një element që nuk ka lidhje me migrimin, por, në fakt, në qoftë se shikojmë numrin e të rinjve që largohen, përveç infermierëve dhe mjekëve që ju përmendët, një numër i madh i të rinjve, që largohen, janë ata që kanë ekspertizë dhe specializim në fushën e teknologjisë. Pikërisht ky është një treg i pambushur tani që flasim. Zyrtarisht kemi 500 vende pune në fushën e teknologjisë dhe vende pune që kanë paga realisht shumë të larta dhe detyra jonë si qeveri është që t’i mbushim këto vende, duke qenë se kanë atë funksionin e zhvillimit të të rinjve ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, janë më shumë, sepse 500 janë vetëm në fushën e teknologjisë, por një nga problemet që kemi identifikuar edhe në bashkëbisedimet që kemi pasur me të rinjtë ka qenë edhe mungesa e informacionit nga të dyja anët. Këtu do t’u kthej përgjigje të dyja elementeve që gjenden në strategji për një pjesë ka filluar puna dhe për pjesën tjetër do të fillojë puna në vijim.

Pika e parë është mungesa e të dhënave dhe studimeve për të rinjtë në Shqipëri. Prandaj, në strategji ne kemi propozuar krijimin e një katedre të veçantë brenda universitete shqiptare, me qëllim studimin e fushës së rinisë, sepse patjetër që të mund të bëjmë politika të mira për të rinjtë, duhet të kemi bazën e të dhënave. Të paktën unë, si ministre, në momentin e parë që m’u caktua kjo detyrë, vura re që kishim një mungesë të të dhënave të sinkronizuara për sa i përket fushës së rinisë nga shumë elemente të ndryshme. Ndonëse INSTAT-i bën një

punë të mirë për një pjesë të të dhënave, shumë nga të dhënat ne nuk i kemi, që do të thotë se kjo e bën punën tonë si vendimmarrës, por edhe si politikëbërës shumë të vështirë. Prandaj, kjo është një nga masat që propozohet në strategji.

Nga ana tjetër, mungesa e informacionit qëndron edhe për të rinjtë. Shumë nga të rinjtë nuk kanë informacion për sa u përket programeve të ndryshme që ne ofrojmë, si programe shtetërore, por edhe programe të tjera që ofrohen nga tregu privat, për shembull faqet e ndryshme për kërkimin e punës, trajnimet e ndryshme apo opsionet e ndryshme që ata kanë. Prandaj, ne, në kuadër të programit të Bashkimit Europian për rininë, kemi menduar edhe ndërtimin e një platforme, ku të bëhet një përmbledhje e të gjithë materialit që ka të bëjë me rininë, duke filluar këtu që nga ministritë e ndryshme të linjës që ofrojnë bursa të ndryshme për të studiuar brenda dhe jashtë vendit, ashtu edhe nga institucionet e ndryshme që mund të ofrojnë praktika pune për ata që kanë vende pune në dispozicion për t'u siguruar që, së pari, të rinjtë t'i dinë të gjitha mundësitë që ata kanë në dispozicion. Edhe kjo është një diçka e drejtpërdrejtë që do t'i ndihmojë të rinjtë të informohen pak më shumë.

Ndjesë, kisha edhe një pikë tjetër, por më lini ta kujtoj!

Për sa i përket krijimit të më shumë mundësive për të rinjtë, unë mendoj se largimi i të rinjve (pavarësisht se e kanë bërë këtë pyetje shpesh në takimet me të rinjtë dhe përgjigjet janë nga më të ndryshmet) shpeshherë bëhet sepse ata duan të ndjekin një lëndë, e cila nuk ofrohet në Shqipëri, që do të thotë që edhe përshtatja e kurrikulave të universiteteve duhet të jetë diçka që tashmë ka filluar me universitetet dhe përshtatja e këtyre ofertave, që vijnë nga universitetet, duhet bërë me kërkesat e tregut. Kjo do të thotë që disa lëndë ne tashmë nuk i ofrojmë. Kjo është diçka të cilën unë patjetër e kam përcjellë te ministria e linjës dhe po trajtohet tashmë.

Një tjetër kërkesë ka qenë punësimi, siç e diskutova, mundësia për të pasur vende të ndryshme pune. Prandaj, kjo platformë, e cila bën një listim të të gjitha opsioneve të mundshme, është e frytshme. Ju përmenda programin kombëtar të praktikave të punës, ku 196 të rinj janë punësuar dhe qëllimi ynë është ta dyfishojmë këtë numër për vitin tjetër dhe këta janë të gjithë të rinj që u krijohet një mundësi për t'u bërë pjesë e tregut shqiptar, pavarësisht zonës nga vijnë. Madje, në një nga takimet që bëmë me të rinjtë, të cilët kishin përfituar nga programi i praktikave të punës nga 37 të rinj që kishin marrë pjesë në programin e Bashkisë së Tiranës, 32 prej tyre nuk ishin nga Tirana, kështu që qëndron edhe komenti juaj për sa i përket largimit. Çfarë po bëjmë? Rikthehemi pikërisht te pjesa e Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Ju përmenda që çdo program, që ne identifikojmë nëpërmjet

organizatave rinore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore, ka impakt të drejtpërdrejtë në zonën ku aplikohet dhe Bashkia e Krujës ka qenë pjesë e disa prej projekteve që kemi financuar. Qëllimi këtyre projekteve është që të krijojnë më shumë mundësi për të rinjtë që ndodhen në ato zona. Në fakt, kur kemi vlerësuar projektet, të cilat kanë aplikuar vitin e kaluar, qëllimi ka qenë edhe shpërndarja gjeografike, sidomos duke iu referuar edhe komenteve të kolegëve të mëparshëm, për t'u identifikuar tek ato zona që ka më shumë migrim, tek ato zona që të rinjtë kanë më shumë nevojë për përpjekje. Për shembull, diçka që mua më ka bërë shumë përshtypje, po i referohem specifikisht rastit të Krujës, mbaj mend që vjet njëria e vetëqeverisjes vendore e Bashkisë së Krujës nuk ka aplikuar fare për të marrë fonde nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Unë do të doja shumë dhe do të angazhohem personalisht që këtë vit ta informoj sa më shumë të jetë e mundur bashkinë që të mund të aplikojë, sepse është një mënyrë shumë e mirë ku mund të krijohet një hapësirë shtesë për të rinjtë e Krujës. Kështu që do të kisha dëshirë të përpiqeshim bashkërisht, që t'i motivojmë kolegët tuaj dhe të mitë, që të mund të bëjnë aplikime dhe të kërkojmë mundësi të tilla. Patjetër që mundësitë ndonjëherë janë të shumta, por duhet të fillojmë t'i bëjmë këto aplikime. Edhe për të rinjtë vlen e njëjta gjë. Nga të gjitha bisedat që kemi bërë dhe nga të gjitha programet që diskutova me ta, fokusi kryesor ishte krijimi i mundësive në Shqipëri. Ky është qëllimi i të gjitha programeve.

Përmendët Agjencinë Kombëtare të Rinisë për edukimin joformal. Në fakt, ne kemi zhvilluar një sërë aktiviteteve vitin e kaluar, nëpërmjet Agjencinë Kombëtare të Rinisë. Një prej tyre ka qenë kampi veror me të rinjtë. Nuk i kam tani vlerat. Nuk e di nëse Arlinda mund të më ndihmojë me vlerat e duhura. Këtu më duhet t'ju rikujtoj se fondi, për sa i përket edukimit joformal, është shumë minimalist dhe kjo duhet mbajtur parasysh kur përmend aktivitetet, se e di që, kur them "kamp veror", mund t'ju duket diçka shumë e vogël, por të paktën të rinjtë aty kanë zhvilluar module të ndryshme trajnimi për këshillimin e karrierës, kanë zhvilluar sporte të ndryshme, janë përfshirë dhe kanë krijuar edhe miqësi të reja.

Një tjetër aktivitet që kemi bërë me anë të Agjencinë Kombëtare të Rinisë, në kuadër të edukimit joformal, ka qenë dhe identifikimi i të rinjve të ndryshëm të suksesshëm, duke filluar që nga rezultatet e larta në shkollë, por edhe të atyre që janë sportistë dhe artistë të dalluar. Jemi përpjekur t'i promovojmë ata në të gjitha opsionet e mundshme, por edhe për të krijuar një rrjet të rinjsh të talentuar, që kanë zgjedhur Shqipërinë dhe duan ta vazhdojnë të ardhmen e tyre këtu.

Ju përmenda pak më parë edhe festivalin e rinisë, që ka pasur si qëllim përfshirjen e sa më shumë të rinjve. Konsultimi i strategjisë së rinisë është zhvilluar me 200 të rinj dhe kjo ka qenë në kuadër të edukimit joformal. Tashmë jemi në kuadrin e planifikimit të një aktiviteti tjetër, i cili ka në fokus aftësitë teknologjike, që do të zhvillohet në fund të këtij muaji dhe do të marrin pjesë rreth 60 të rinj, të cilët do të trajnohen për fushat digjitale, sepse, edhe nga eksperiencia e të rinjve, kemi kuptuar që ndoshta kurrikula nuk arrin t'u ofrojë atyre të gjitha nevojat që kërkon tashmë tregu i punës për sa i përket kësaj pjese. Jemi të gjithë familjarë që përdorimi i kompjuterit dhe i programeve të ndryshme është pjesë e përditshme e punës sonë dhe jo gjithmonë të rinjtë arrijnë ta elaburojnë këtë pjesë aq sa duhet për të marrë një ofertë konkurruese në tregun e punës.

Për sa i përket CRCA-së, që ju e përmendët, CRCA-ja është një organizatë që ka shumë vite që operon në Shqipëri, ka qenë një nga partnerët kryesorë me të cilët kemi pasur bashkëbisedime të vazhdueshme për sa u përket problematikave që ata kanë identifikuar në fushën e fëmijëve. Kemi filluar disa impenjime të drejtpërdrejta me ta. Ata tashmë kanë marrë mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë për rrjetin e tyre *Isigurt.al*, e cila është një nismë e mbështetur drejtpërdrejt nga qeveria shqiptare. Qëllimi i kësaj nisme është identifikimi i materialeve të papërshtatshme të publikuara në rrjete sociale publike të fëmijëve, jo vetëm raportimi, por edhe mbyllja e këtyre faqeve. Pra, po flasim për rastet kur një bashkëmoshatar poston një foto të papërshtatshme të mikut të tij të klasës dhe pikërisht kjo platformë shërben si mjeti ndalues dhe frenues për zhvillimin e këtyre aktiviteteve. Madje, kanë lidhur marrëveshje me *Facebook*-un, me *Instagram*-in dhe me *Twitter*-in, në dijeninë time. Tashmë janë në proces për *TikTok*-un, që është një sfidë e të gjithë botës, jo vetëm e Shqipërisë, për shkak të mënyrës se si është ndërtuar. Kështu që, patjetër, edhe këtu duhet punë.

Për sa i përket komentit tuaj për kuadrin ligjor për abuzimin seksual, tashmë kemi për të rishikuar në parlament dy propozimet që kanë ardhur si nga shoqëria civile, por edhe nga një nga deputetët, dhe besoj se në atë fushë jemi duke ecur para dhe në drejtimin e duhur. Patjetër që ajo nismë do të ketë të gjithë mbështetjen time maksimale, për t'u siguruar që të bëjmë maksimumin që kemi në dorë për t'i mbrojtur fëmijët nga abuzimi seksual qoftë ky nga të njohurit, qoftë nga të panjohurit.

Ndjesë, nëse kam harruar ndonjë pyetje! Të lutem, më rikujto, nëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, trafikimin.

Ju kërkoj ndjesë, se e paskam shkruar, por më shpëtoi!

Para se të flas për fëmijët e trafikuar, kam diçka për të shtuar në pikën e mëparshme. Nuk e di sa mund të jeni në dijeni, por Ministria e Shëndetësisë tashmë ka ngritur dhe një qendër tjetër për trajtimin dhe ndihmën ndaj fëmijëve dhe rasteve të dhunuara. Tashmë janë bërë tri qendra efektive në të gjithë Shqipërinë, të cilat janë ndërtuar me modelin *barnhouse* dhe shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për fëmijët. Kjo është diçka e re, që nuk është ofruar më parë në Shqipëri.

Për sa i përket pyetjes për fëmijët e trafikuar, kjo është një nga temat kryesore, të cilën jemi duke e bashkëbiseduar tashmë me Ministrinë e Drejtësisë. Në mos gaboj, jemi duke punuar për hartimin e kodit miqësor për fëmijët me Ministrinë e Drejtësisë, për t'u siguruar që edhe kjo të jetë një temë e cila të trajtohet në mënyrën e duhur dhe të mund të gjenden zgjidhjet më të përshtatshme në të ardhmen.

Shumë faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Ministre!

Ka një ndërhyrje nga zonja Bakiu. Më pas do të kalojmë në..

Merita Bakiu – Në fakt, tani që po diskutonim për këtë, m'u kujtua edhe diçka tjetër. Gjatë kohës kur isha në fushatë, jam hasur me një targetgrup të fëmijëve të ngjuar.

Çfarë masash keni marrë për këta fëmijë? Gjëja më e dhimbshme ishte të gjeje fëmijë të ngjuar, që nuk kishin asnjë lloj mbështetjeje nga shteti.

Flutura Açka – Po, zonja Ministre.

Bora Muzhaqi – Të falënderoj që e solle në vëmendje!

Në fakt, kjo është një temë që jo vetëm e kemi diskutuar në mënyrë të vazhdueshme në zyrën tonë, sepse mbaj mend një rast para disa kohësh, që është publikuar në media për fëmijët e ngjuar të zonës së Lezhës, nëse nuk gaboj, që e kemi diskutuar shumë thellësisht. Më duhet të them që jemi në hapat e parë të identifikimit të mënyrës se si mund t'u qëndrojmë afër këtyre fëmijëve. Është një problematikë që na shqetëson. Jemi duke dialoguar edhe me ministrinë e linjës, për të gjetur mënyrat më të mirat. Edhe për këtë temë shprehem shumë e gatshme që të ulemi dhe të bashkëpunojmë.

Nëse ju do të keni sugjerime për mënyrën më të mirë se si qeveria mund t'u qëndrojë afër këtyre fëmijëve dhe mund t'ua bëjë pak më të lehtë jetën, do të ishte patjetër... Në dijeninë time, është diçka e parashikuar edhe në strategjinë e arsimit, por patjetër që është një fushë ku ka shumë për të bërë dhe duhet të angazhohemi të gjithë për të vijuar.

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Ministre!

Kisha një pyetje, që e bëri zonja Bakiu, para se t'ia kaloj fjalën zonjës Zhupa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, me radhë. Nëse do të vendosni një balancë, është tjetër gjë, por unë po respektoj kërkesën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si të dëshironi ju. Vendoseni ju këtë, me konsensus. Unë jam gati.

Meqenëse në punën tuaj ju orientoheni nga konventa ndërkombëtare e të drejtave për mbrojtjen e fëmijëve, mendoj se një nga këto pika është dhe çështja e fëmijëve të ngjuar. Nuk është një gangrenë që e keni ndeshur ju, së pari, ka qenë një gjë e bartur prej vitesh, e kemi ngritur dhe në këtë komision me shumë forcë.

Të paktën, nëse keni një evidencë, sa fëmijë të ngjuar ka sot?

Çfarë nevojash konkrete kanë ata, se është problemi i edukimit, janë problemet sociale, problemet e sigurisë?

Si mund të dilet nga ky qerthull?

Ne, si komision, jemi të gatshëm dhe të hapur që, çfarëdo drafti të sillni në mbrojtje të tyre dhe si mund të gjendet një zgjidhje, t'ju ndihmojmë, sepse të paktën unë që jam marrë 20 e kusur vite me këtë çështje, jam shumë e ndjeshme dhe kam vizituar shumë prej këtyre familjeve. Nuk e di nëse ju keni vizituar ndonjë, por në Shkodër ka familje të cilat vërtet janë duke përjetuar drama të mëdha, sidomos fëmijët. Kështu që, nëse ka një moment ku e kemi prekur këtë konventë është pikërisht kjo, që ka lidhje me fëmijët e ngjuar.

Në funksion të po kësaj gjëje, ju e dini që kohët e fundit Ministria e Arsimit i ka kthyer shkollat shqiptare, shkollat e Tiranës, ndoshta për momentin eksperimentale, në qendra komunitare. Sigurisht, u riparuan palestra e të tjera.

A nuk mendoni se kjo bie ndesh me prioritetet tuaja? Sepse fëmijët aty janë shumë të ekspozuar, duam apo nuk duam ne, ndaj dhunës, ndaj njerëzve, të cilët, meqenëse është komunitare, kanë të drejtë të hyjnë në palestër, kur ndërkohë është palestër e fëmijëve. Tani ka një përplasje.

A e ndieni që ka një përplasje me punën tuaj, e cila do qartësisht të ndihmojë fëmijët, kur, në fakt, në këtë mes nuk ndihmohen fëmijët, por ekspozohen edhe më shumë ndaj njerëzve të dhunshëm, si dhe ngacmimeve seksuale e gjërave të tjera, të cilat mund të japin pasoja që nuk i kemi parashikuar?

Faleminderit!

Pas përgjigjeve tuaja, fjalën e ka zonja Zhupa.

Bora Muzhaqi – Së pari, shumë faleminderit për ofrimin e mbështetjes për fëmijët e ngjuar!

Më duhet t'ju them që nuk më ka rastisur të vizitoj fëmijë në këtë situatë. Ndoshta do të më duhet ta bëj, dhe do ta bëj me shumë kënaqësi, për të kuptuar edhe më nga afër sfidat e tyre, sepse të paktën teoria ime dhe praktika që kam zbatuar gjatë kësaj periudhe ka qenë bashkëbisedimi me të rinjtë. Mendoj se ata vetë i shprehin më mirë sfidat që kanë sesa ne të rriturit ndonjëherë i identifikojmë problematikat e tyre. Në fakt, kjo është pjesë e agjendës për të drejtat e fëmijës dhe ne tashmë jemi duke bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe patjetër që do të rikthehem me një plan konkret për këtë çështje. Ndonëse nuk hyn në tagrin tim të drejtpërdrejtë, do të angazhohem personalisht për të kuptuar çfarë mund të bëjmë në këtë fushë dhe si mund ta bëjmë. Nuk i kam të dhënat konkrete dhe nuk do të doja të shprehesh në mënyrë të pasaktë. Kështu që do të më lejoni t'i rikthehem në një moment të dytë kësaj çështjeje. Patjetër që jam e gatshme të bashkëpunojmë për të bërë më shumë në këtë fushë.

Për sa i përket konceptit të shkollave si qendra komunitare, ndoshta nuk do të isha në gjendje të përgjigjesha, por për shkak edhe të programit të aktivitetit jashtëshkollor, kemi bërë një analizë shumë të mirë të shkollave si qendra komunitare, për t'i marrë si model dhe për të parë se ku mund të përmirësonim, ku mund ta çonim pak më larg dhe ta bënim më mirë apo të kryenim më shumë funksione sesa ka kryer shkolla si qendër komunitare.

Në fakt, nga e gjithë analiza që kemi kryer, patjetër që ka një punonjës sigurie, i cili ndodhet gjatë gjithë kohës në ambientet e shkollës. Ky person kujdeset që në ambientet e shkollës, pavarësisht përdorimit të shkollës si qendër komunitare, të mos lejohet hyrja e personave që nuk lidhen me fëmijët. Pra, po flasim vetëm për fëmijët, për mësuesit e autorizuar për të qenë në atë zonë, për personelin që kryen pastrimin apo monitorimin e shkollës, por edhe për administratën institucionale. Kështu që, në momentin kur shkolla përdoret nga fëmijët, në dijeninë time, nuk ka në asnjë moment ndokënd tjetër, i cili nuk është i përcaktuar për të shkuar aty.

Në fakt, eksperiencat që kam dëgjuar nga drejtuesit e shkollave, nga mësuesit, por dhe nga vetë fëmijët për shkollën si qendër komunitare, kanë qenë shumë pozitive. Madje, kanë dashur ta shtrijmë pak më tej, sepse aktivitetet që ata kryejnë në kuadër të kësaj nisme, duke filluar që nga programet e ndryshme për klasat e fizikës, të kimisë, që ata i vazhdojnë pas orarit të mësimi, klubet e ndryshme të letërsisë, që zhvillohen në shkolla të ndryshme, kanë qenë eksperiencat shumë pozitive. Kanë kërkuar më shumë mbështetje që ky program të

shtrihet edhe më tepër, sepse, në fakt, jo të gjitha shkollat e Shqipërisë janë pjesë e këtij programi. Nëse nuk gabohen, janë 465 shkolla pjesë e konceptit të shkollave si qendra komunitare nga 1200. Madje, çdo shkollë që nuk është qendër komunitare, sa herë më rastis të bëj ndonjë vizitë, si nga nxënësit, si nga drejtuesit, kërkohet gjithmonë që edhe ata të jenë pjesë e konceptit të shkollave si qendra komunitare, por, sigurisht, ka një listë kriteresh dhe jo të gjitha shkollat mund të bëhen pjesë. Të paktën kjo ka qenë eksperiencia ime në terren, por edhe nga studimet që kam kryer.

Nuk e kam hasur këtë që ju përmendët, por nëse keni raste të tilla, na i bëni me dije, që t'i ndjekim specifikisht.

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Ministre!

Në fakt, e kisha fjalën më shumë për palestrat që përdoren në formë klubesh private. Kanë filluar të dalin si kërpuhat pas shiut. Këtu e kam shqetësimin, sepse ka klasa që janë edhe pasdite, ju e dini këtë, ka fëmijë që studiojnë edhe pasdite. E kam fjalën këtu, që kush mund të na sigurojë që nuk kemi “hije”, që mund të na...? Këtu e kam, te këto farë klubesh që kanë hyrë, për shkak të këtij drejtimi që u është dhënë shkollave shqiptare, kur duhet të jenë ekskluzivisht për fëmijët, por ngaqë nuk bëjmë dot fusha sporti në ndonjë vend tjetër, hyjmë në terrenin e fëmijëve pa të drejtë. Këtë po them, nëse ka ndonjë *crash* në këtë pikë.

Bora Muzhaqi – Ndjesë! Po i rikthehem, se nuk e kisha kuptuar temën.

Në dijeninë time, ndodh kryesisht në Bashkinë e Tiranës. Me sa di unë, në zonat e tjera nuk ndodh kaq rëndom...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, edhe në Fier.

Kam përshtypjen se janë disa bashki ku përdoret ky koncept, jo në të gjitha bashkitë është përdorur. Në dijeninë time, rakordimi bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shkollën, për t'u siguruar që nuk ka përplasje ndërmjet zhvillimit të orarit të mësimit dhe hyrjes së këtyre klubeve sportive. Është edhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit se si duhet të zhvillohet dhe kjo është edhe eksperiencia që kemi hasur nga analizat që kemi kryer deri tani.

Flutura Açka – Për ta përmbyllur, po ju jap rastin e shkollës “Jeronim de Rada”, ku fëmijët janë edhe turni i parë, edhe turni i dytë, pra ka fëmijë edhe pasdite. Pasdite është dhe palestra, ku janë djem të rritur, që kanë të drejtën e tyre, sepse u është ofruar palestra. Ky është problemi. Unë po sjell shqetësimet e prindërve, të cilët m'i kanë referuar mua. Prandaj po ju transmetoj shqetësimin e tyre.

Po, zonja Zhupa.

Bora Muzhaqi – A mundem?

Ju kërktoj ndjesë!

Po e mbaj shënim dhe do ta identifikoj rastin, për të parë se si është situata. Ju falënderoj që e ngritët këtë shqetësim!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Futura Açka – Ka një ndërhyrje zonja Bakiu dhe më pas do t’ia jap fjalën zonjës Zhupa.

Merita Bakiu – Zonja Ministre, shqetësimi që ngriti zonja Açka është shumë i drejtë. Në fakt, shkollat komunitare janë shumë të mira për fëmijët dhe kanë shumë gjëra pozitive, për metodat interaktive që përdorin, por mendoj se duhet të jeni më të kujdesshëm dhe të bashkëpunoni dhe me Ministrinë e Arsimit, sepse shkollave komunitare u humb e gjithë esenca ose i gjithë qëllimi që kanë, kur bëhen të zbatueshme si shkolla komunitare në shkollat me dy turne. Pra, nuk duhet të jenë shkolla komunitare shkollat të cilat punojnë me dy turne, sepse janë të dështuara në këtë projekt.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Flutura Açka – Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Në fakt, më vjen mirë që, më në fund, kemi në komision ministren për Rinisë dhe Fëmijët, zonjën Bora Muzhaqi.

Flutura Açka – Ju lutem, mos flisni pa mikrofon!

Ina Zhupa – Siç e thashë, më vjen mirë që e gjetët kohën. Në këtë komision është kërkuar seanca dëgjimore me ju që në datën 1 nëntor të vitit 2021 dhe jo rastësisht, por për shkak të një deklarate publike nga ju për komentin që ju kërkuan gazetarët për vrasjen e Mateos. Në fakt, komenti juaj, aspak i pëlqyeshëm nga ana ime, por edhe aspak profesional, ndoshta edhe ju vetë keni reflektuar për atë koment, më shtyu qoftë të reagoja publikisht (në atë kohë kam kërkuar edhe dorëheqjen tuaj), qoftë t’ju kërkjoja në komision. Shumë ujëra kanë kaluar, por realisht problem shqetësues mbetet dhe është abuzimi seksual me fëmijët.

Ky parlament ka edhe një iniciativë të deputetes Erisa Xhixho për regjistrin e krimeve seksuale.

Doja të dija edhe nga ana juaj, çfarë keni bërë në këtë drejtim?

A jeni një institucion që kujdeseni edhe për këtë aspekt, në lidhje me rritjen e fëmijëve dhe koordinimin me institucionet e tjera, që nga policia dhe të gjitha institucionet e

tjera, të cilat janë përgjegjëse dhe preken nga ky fenomen? Sepse doja të rikthehesha pikërisht aty ku ka lindur nevoja për t'ju thirrur ju në komision.

Mendoj se kur thoni që qasja ime ndaj medias është e ulët dhe nuk ofroheni shumë në deklaratat publike, kjo është zgjedhja juaj personale. Jeni në tagrin tuaj për të bërë PR-in siç e mendoni ju më mirë, por kur jeni në një aktivitet publik dhe përgjigjeni në formën me të cilën u përgjigjët, atëherë përsëri duhet të mbani një lloj përgjegjësie publike për gjërat që thoni dhe nuk duhet t'ju vijë keq në rast se prekni ndjeshmëritë e përfaqësuesve të opozitës, të prindërve, të njerëzve e komuniteteve. Ndaj, në këtë aspekt, ju kërkohet të jeni më e përgjegjshme në komunikimin tuaj publik, sidomos për çështjet e fëmijëve dhe të rinjve.

Së dyti, në fjalën tuaj, të cilën po e dëgjoja me shumë vëmendje dhe në raportim, përmendët planin e ri kombëtar të rinisë. Si ministre, besoj se jeni në dijeni që ka pasur më parë një plan kombëtar të rinisë. Qeveria shqiptare e ka miratuar në vitin 2015. Ka qenë plani kombëtar 2015-2020. Pra, nuk është e vërtetë që ka pasur një mungesë të një dokumenti strategjik për rininë. Po ashtu, është edhe diçka tjetër e vërtetë, siç e thotë edhe CRCA-ja në faqen 33, nëse doni, mund t'ju vendos në dispozicion dokumentin, që deri më sot, të paktën ju, si ministri e krijuar, duhet ta kishit detyrën tuaj të parë, nuk ka asnjë raport monitorimi apo vlerësimi të përgatitur nga qeveria dhe nga institucionet për këtë plan që ju kishit miratuar dhe ka mungesë totale monitorimi e vlerësimi çdo 6 muaj, siç bëhet zakonisht për planet kombëtare, për të parë përmbushjen e indikatorëve, realizimin e aktiviteteve, kërkesën e llogarisë, matjen e performancave të stafit të zyrave e të tjera. Duke ju munguar kjo, keni bërë një plan të ri veprimi, të cilin na e trajtoni si një dokument të rëndësishëm strategjik e të tjera.

A nuk mendoni se punën tuaj duhej ta nisnit fillimisht me një raport monitorimi dhe vlerësimi publik, të vënë në dispozicion, për të parë edhe problematikat e planit dhe për t'i përmirësuar në planin tjetër që ju keni, që ia paraqitët edhe këtij komisioni?

Së treti, ju përmendët disa herë Bashkinë e Tiranës dhe bashkitë e tjera dhe e cilësoni si pjesë të sukseseve të detyrës suaj kur ka tendera, grante, që u dedikohen fëmijëve dhe rinisë.

Dua t'ju them një rast se si për këto projekte shpërdorohen para dhe nuk shkojnë te qëllimi i duhur, te fëmijët apo të rinjtë. Për shembull, në nëntor të vitit 2020, besoj se ju keni bërë një analizë të situatës para se të vinit si ministre, Bashkia e Tiranës shpenzoi 50 mijë euro për të blerë 10 tableta për të identifikuar fëmijët e rrugës. Këtu dalim edhe te një problem tjetër, për të cilin do t'ju pyes. Pavarësisht këtij shpenzimi, sigurisht të kotë, sepse

sot mjafton të dalim të dyja bashkë, të hipim në një makinë ose të ecim në rrugë dhe lypësit i kemi edhe në bulevardin qendror të Tiranës, në gjendje të mjerueshme, duke fshirë makinat dhe duke kërkuar para, nuk u zgjidh asgjë.

Nga ana tjetër, ju, si ministre për Fëmijët, të cilët i keni targetgrupin kryesor, çfarë politikash keni menduar të ndërmerri për këtë fenomen, në bashkëpunim me institucionet e tjera?

Së katërti, përmendët Agjencinë Kombëtare të Rinisë, e cila ka bërë disa projekte, por e njëjta gjë mungon edhe te këto projekte, mungon një transparencë monitoruese, mungon një raport efektiviteti i këtyre projekteve se si kanë ndikuar në rehabilitimin e një problematike të caktuar. Pra, jo thjesht projekt për projekt, por një projekt, i cili lë gjurmë në komunitetin ku vepron dhe shëron një problematikë ose përmirëson një gjendje, dhe hap mundësinë ndoshta edhe për projekte të tjera për gjëra që nuk kanë përfunduar dhe që kanë nevojë të përfundohen. Kjo duhet të jetë një kërkesë juaja ndaj Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe ju, si ministre, të keni tagrin për të kërkuar llogari dhe për të kërkuar këto raporte monitorimi, jo thjesht për t'i marrë ato projekte dhe për t'i shitur si sukses qoftë në komision, qoftë në medie, por të keni një qasje tjetër ndaj tyre dhe për të qenë ju autoriteti, në të cilin ata duhet t'i dorëzojnë këto lloj raportimesh monitorimi, sepse ju shërbejnë në punën tuaj të përditshme në objektivat që keni si ministri për fëmijët dhe për rininë.

Përmendët, po ashtu, pjesën e praktikave të punës në administratën shtetërore. Siç e dini, unë te kjo pjesë jam e ndjeshme, duke qenë vetë pedagoge, më pyesin gjithmonë studentët se kë institucion duhet të zgjedhin për praktikë, çfarë bëhet në praktikë, pra më bëjnë një reflektim dhe unë ua them jo vetëm me garanci, por edhe me shifra zyrtare. Këto janë nënpyetje të pyetjes së praktikave. Problematika e parë është që VKM-ja nr. 395/2015, që përcakton rregullat për miratimin e Programit kombëtar të Praktikave, është shumë evazive në rubrikën e kriterëve që duhet të ketë një student për t'u futur si praktikant dhe kjo vjen si eksperiencë e vetë studentëve. Çfarë ndodh? Mënyra se si ata përzgjidhen më shumë ka kontribuar si mënyrë e hapjes së një dërrë punësimi, që u shërben qëllimeve elektorale, sidomos kur ka fushata, por edhe politike kur nuk ka fushata, sesa mirëfilli për punësimin e të rinjve, të më të mirëve, të atyre studentëve ekselentë, të cilët janë në sistem, sepse është e lënë evazive, që u lihet në dorë institucioneve se kush duhet dhe kush nuk duhet të jetë praktikant. Këtu mund të jetë roli juaj si ministre.

E para, a jeni në dijeni të kësaj problematike? E dyta, a parashikoni ju që të kërkonti ndryshim të kësaj VKM-je, si anëtare e Këshillit të Ministrave që jeni, sepse është fusha juaj e drejtpërdrejtë e detyrës?

Përsëri këtu ju thatë, dhe është evidentuar se nga 572 të rinj që përfunduan praktikën, vetëm 196 prej tyre lidhën një kontratë njëvjeçare me administratën shtetërore. Ju thatë se bëhet një vlerësim nga punëdhënësi, të paktën unë kështu e dëgjova, dhe ju mund të na e sqaroni. Pra, bëhet një vlerësim nga praktikëdhënësi, se, në fakt, punëdhënësi bëhet më vonë, por nga institucioni për performancën e tyre dhe kjo më pas shërben për punësimin, në qoftë se unë e kuptova drejt. Numri në raport është shumë i vogël, ndaj ju si ministri e Shtetit, a keni planifikuar masa konkrete për rritjen e numrit të atyre që marrin kontrata njëvjeçare, për fituesit e praktikave? Nëse jeni të kënaqur me këtë numër, mund të na e thoni dhe nuk është ndonjë problem. Madje, nëse mendoni se duhet ta zvogëloni numrin, edhe këtë mund ta thoni.

Ju folët këtu për bashkitë dhe grantet shtetërore të parashikuara për bashkitë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Të lutem, se sistemin e patronazhistëve e njohim shumë mirë dhe këtu nuk është rasti që unë të kaloj në tema të tjera, por po vazhdoj me pyetjet për zonjën Muzhaqi.

Thatë se keni problematika, në fakt, në lidhje me punën që bëjnë kryetarët e bashkive të vendit në projektet me fokus rininë, duke marrë shembull rastin e fundit, Krujën e të tjerë, a jeni ju në dijeni që kryetarët e bashkive janë të gjithë të majtë dhe të Partisë Socialiste? Duke bërë këtë kritikë, a e rrezikoni pozicionin tuaj të punës për kryetarët e bashkive? Kjo ishte për ta shtensionuar situatën për pyetjet e tjera që do të vijnë.

Për sa i përket shërbimit komunitar, dua t'ju informoj se shërbimi komunitar ka qenë pjesë e kurrikulës shkollë, por në vitin 2013 u hoq. Ju, si Ministri e Rinisë dhe e Fëmijëve, a do t'i propozonit Kryeministrit Rama rikthimin e shërbimeve komunitare në kurrikulën mësimore? Në dijeninë time, ju keni qenë edhe në Komisionin e Çështjeve Sociale, në mos gabofsha, dhe e dini që është diskutuar ligji për vullnetarizmin, apo jo? Cilat janë propozimet tuaja për adresimin e ngërçeve aktuale të ligjit të vullnetarizmit, sepse na intereson edhe neve si komision, pasi lidhet me rininë dhe me pjesën e CV-së së tyre? Ju besoj e dini shumë mirë se një nga problemet që kanë studentët kur duan të punësohen, është se u kërkohet eksperiencë pune, ndërkohë që ata sa kanë dalë nga bankat e shkollës. Pra, të kesh eksperiencën e punës, atë eksperiencën e parë, është shumë e vështirë dhe për vullnetarizmin i ndihmon jashtë mase për sa i përket anës së mbushjes së CV-së së tyre për punësimin e mëpasshëm.

Çështja tjetër, këtu kam edhe disa nënpyetje, lidhet me atë që ju thoni për gjuhën e kodimit që duhet të fillojë që në klasë të parë. Këtu do të ndalemi pak së bashku.

E para, ju thoni që në klasën e parë, Kryeministri thotë 10 vjeç. Si një qeveri që jeni, çështja e parë është: a do ta ndani mendjen se kur është më e mira, që në klasën e parë, pra 6-7 vjeç, apo 10 vjeç, siç thotë Kryeministri?

Çështja e dytë: si janë përzgjedhur dhe çfarë kriteresh keni përdorur për të përzgjedhur 100 shkollat në të cilat do të futet ky program? Sa nga këto shkolla janë në zona të thella rurale, që ndoshta as kanë parë ndonjëherë kompjuter me sy?

Platforma *online*, që ju thoni, si do të funksionojë, kur neve nuk na ka funksionuar mësimi *online*? Mësimin *online* e kemi bërë nëpërmjet *WhatsApp*-it, *Facebook*-ut ose nuk është bërë fare, sidomos në zonat rurale.

Pra, kemi 2 realitete, që nuk përputhen me njëri-tjetrin, ai që është objektivi juaj dhe ajo që ju thoni. Pra, është premtim i Ministrisë për Rininë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për sa i përket asaj që ju thatë, siguria e internetit në Shqipëri është 0 dhe këtë e keni vënë edhe vetë në planet tuaja. Kur siguria e internetit në Shqipëri është 0, çfarë parashikoni ju, duke qenë se i afroni nxënësit që të vegjëll, që në klasë të parë me teknologjinë, me IT-në, që të korrespondojë siguria 0 dhe rreziqet që ajo mban, me aftësitë e tyre të zgjeruara në fushën e IT-së? Si t'i kombinojmë këto të dyja bashkë në realitetin shqiptar?

Kam edhe diçka shumë të rëndësishme: cilin model keni marrë ju dhe cili shtet tjetër europian ka gjuhën e kodimit që në klasë të parë? Kjo për të ditur se cilit model i referoheni ju dhe cilave praktika të mira u referoheni ju, kur doni të na fusni gjuhën e kodimit që në klasë të parë. Apo do të bëni një eksperiment me Shqipërinë? Pra, cilat shtete, sepse ka njerëz këtu që e dinë PNUD-in shtet, e kanë këtë praktikë?

Së fundi, përmendët artet dhe kulturën.

E para, ka një shkurtim të mësuesve të muzikës në shkollat tona të 9-vjeçares dhe shkollat e mesme.

Së dyti, shkollat në Berat, në Fier, në Elbasan, që trajtojnë muzikën, janë në kufijtë e mbijetesës. Të paktën për pjesën e mësuesve ky ka qenë një shqetësim, që edhe vetë mësuesit e muzikës e kanë ngritur. A do të advokoni ju, që të rriten orët e mësimi aq sa kanë qenë para vitit 2013 dhe të kenë mundësi më shumë nxënësit për të bërë mësim arti, muzike apo të çdo forme tjetër?

Këto janë pyetjet e mia për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flutura Açka – Ju lutem, kolegë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për procedurë, zonja Tahiraj ka fjalën.

Dasantila Tahiraj – Faleminderit, zonja kryetare!

Atëherë, unë kam një propozim për procedurë. T’i marrim të gjitha pyetjet, sepse do të zgjatemi, nëse vazhdojmë me pyetje-përgjigje, dhe pastaj zonja ministre t’u përgjigjet.

Faleminderit!

Flutura Açka – Zonja Tahiraj, faleminderit, por nuk mund ta ndryshojmë, sepse i bie pastaj të jenë “ca të nënës dhe ca të njerks”, por po ju jap një radhë: pas përgjigjeve të zonjës ministre fjalën e kanë zoti Spaho, zonja Tase, zonja Buxheli dhe zonjushë Ulliri.

Florenc Spaho – E kam për procedurë.

Flutura Açka – Për procedurë, urdhëroni!

Florenc Spaho – E kam për procedurë, sepse në fakt “koha është flori” dhe ministrja këtu është për t’iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të kolegëve, por për pyetjet të cilat nuk i adresohen ministrisë së saj, por duan opinionin dhe komentet e zonjës Bora Muzhaqi, jo se i përkasin targetit të ministrisë së saj, ju lutem, të mos i marrim kohën. Ina, nëse dëshiron, t’ia çojë pyetjet dhe çfarë mendon...

(Zonja Ina Zhupa ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju kërkohet ndjesë zonja Zhupa për etiketimin, që ju thirra direkt në emër, edhe pse jemi miq!

Atëherë, pyetjet që duhet të jenë për ministrinë përkatëse, të jenë edhe me përgjigjet që i përkasin ministrisë.

E dyta, me pyetje dhe nënpyetje, që qëllimin e kanë vetëm te një pyetje, më duket se po harxhojmë kohën kot, për të marrë vëmendje mediatike.

Në fakt, e falënderoj zonjën Zhupa për mënyrën si u drejtua, sepse kemi parë mënyra të ndryshme nga zonja Zhupa, por sot të paktën kjo është mënyra më e mirë që i drejtohet një ministreje dhe të gjithë kolegëve.

Flutura Açka – Zonja ministre e ka në autoritetin e saj të bëjë *delete* çfarë ajo mendon që nuk është në kompetencën e saj, kështu që është e thjeshtë kjo çështje.

Ina Zhupa – Zonja ministre, kur prezantoi, sigurisht na vuri në dijeni, edhe kryetarja e Komisionit po ashtu ia vuri në dukje që ka kompetenca ku ndërthuret ministria e saj me ministri të tjera, sepse është normale që çështjet e fëmijëve dhe të rinisë do të kenë ndërthurje

edhe me ministrinë e tjera. Nuk është rasti vetëm i Ministrisë për Rininë dhe Fëmijët, por dhe kur vijnë zonja Ekonomi, zonja Bilali e të tjerë, patjetër ka ndërthurje me dikastere të tjera. Nëse zonja Muzhaqi nuk ka përgjigje për disa pyetje, mund të thotë që nuk ka përgjigje, që nuk e di. Nuk është turp, nuk ka asnjë problem këtu!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flutura Açka – Zoti Spaho, ju lutem!

Mos harroni edhe një gjë, madje i kërkoj ndjesë zonjës ministre, që nuk e ftuam këtu në kohën e buxhetit, kështu që kjo është një arsye të rrijë më gjatë me ne, për shkak se ky është takimi ynë i parë, kur duhet të kishte pasur një takim edhe më të hershëm. Këtë e thashë thjesht për procedurë edhe unë.

Zonja Ministre, fjala është për ju.

Bora Muzhaqi – Faleminderit për fjalën!

Së pari, do ta filloj me një çështje, që më tërhoqi vëmendje. M'u tha se nuk kam ardhur.

Zonja kryetare, faleminderit ju për shpjegimin, por nëse do të më kishit ftuar, do të kisha ardhur. Për çdo kërkesë që kam pasur nga komisionet deri më sot, jam treguar maksimalisht e gatshme t'u kthej përgjigje kolegëve për çdo pyetje të bërë. Personalisht jam paraqitur në komision, duke përfshirë edhe ligjin "Për vullnetarizmin", që ndonëse nuk lidhet drejtpërdrejt me mua, por për shkak të natyrës, çështjes dhe se si lidhet me të rinjtë, kam gatishmërinë maksimale. Kur flasim për të rinjtë dhe fëmijët, është apo nuk është në tagrin tim të drejtpërdrejtë, marr shënime dhe i komunikoj me kolegët. Fundja, një pjesë e detyrës së të qenurit ministër është edhe të ngremë zërin për gjëra që nuk na takojnë drejtpërdrejt, siç edhe ju si deputet, një nga detyrat kryesore që keni, është të ngrini zërin për problematikat e të rinjve në zonat tuaja. Të them të drejtën, do të doja t'ju shikoja edhe në parlament, por edhe në komisione, të jeni sa më aktiv për këtë çështje. Ne nuk i dimë të gjitha gjërat, pavarësisht se përpiqemi maksimalisht t'i mësojmë të gjitha problematikat, por jo gjithmonë ia arrijmë qëllimit, kështu që është edhe detyra juaj, si nga krahu i majtë, edhe nga krahu i djathtë, të na i bëni me dije këto çështje.

Unë e kam marr ftesën më 10 maj dhe sot jam prezent sipas kërkesës. Jam shumë e gatshme të rri me ju sa të ezaurohen të gjitha pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë flas për *email*-e zyrtare konkrete, të cilat nuk i kam marrë.

Ndjesë, zoti Koçi, por kushdo që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Komisioni qartazi nuk e ka menduar të arsyeshme që unë të isha këtu. Edhe unë bie dakord me komisionin. Për sa u përket mendimeve personale që dikush mund të ketë, i shpreh nëpërmjet medias, siç i keni shprehur dhe shumë mirë keni bërë. Në Shqipëri kemi mjaftueshëm liri medietike, kështu që të gjithë mund të themi gjërat që mendojmë.

Për sa i përket rastit që ju i referoheni, besoj e dini, e keni parë CV-në time. Unë nuk vij me eksperiencë medietike, që do të thotë se ndonjëherë një përgjigje e thënë në kuadër të një situatë të vështirë nga ana emocionale, jo vetëm për të gjithë qytetarët shqiptarë, por edhe për mua, si ministre e re në këtë detyrë, mund të ketë shkaktuar një përgjigje që nuk ka qenë e menduar dhe ishte në kuadër të aktivitetit tjetër, pa pasur absolutisht lidhje me çështjen. Deklarimi dhe reagimi im për këtë çështje është ezauruar tashmë. Patjetër, janë marrë masa të nevojshme që raste të tilla të mos përsëriten. Për mendimin tim, kjo është pjesa më e rëndësishme, nëse merren masa ligjore të rëndësishme nga qeveria për të adresuar problematikat e kësaj natyre.

Më kryesorja, që vlen për t'u përmendur është që një deklaratë, e bërë në një moment kur të gjithë qytetarët shqiptarë ishin të agravuar, nuk besoj se do të kishte shtuar vlerë, por sidoqoftë, unë jam shprehur për atë rast dhe është e kotë të thuash se sa e madhe është keqardhja kur ndahet një fëmijë i vogël nga jeta, për çfarëdolloj arsye, por për më tepër kur ka edhe përgjegjësi për t'u marrë. Besoj se për atë rast janë marrë masat e duhura dhe janë bërë publike.

Për sa i përket një pjese të madhe të pyetjeve, sidomos kur dëgjova se ju keni kërkuar prezencën time edhe më parë, do të kisha dashur shumë të ishit këtu kur unë prezantova një pjesë të madhe të punës, sepse vura re që erdhët me vonësë. Nëse do të ishit, do të kishit kuptuar pak më shumë për përgjegjësitë e mia.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Megjithatë, me shumë kënaqësi unë do t'u referohem sërish të gjitha pikave që lidhen me veprimtarinë e punës së kryer deri tani.

Do të fillojmë me një element të rëndësishëm. Unë e përmenda edhe më parë në komentin e koleges suaj për sa i përket CRCA-së, që shprehet për monitorimin dhe vlerësimin për planin dhe fjalja "Ju thatë se për sa i përket planit, keni pasur një plan", askush nuk tha që nuk kemi pasur një plan. Ka qenë plani kombëtar i veprimit për rininë. Çfarë përmenda është se nuk kemi pasur kurrë një strategji kombëtare për rininë dhe siç kuptohet

nga ana legislative është se, së pari, kemi një strategji, e cila është shumëvjeçare, dhe shoqërohet nga një plan veprimi. Plani i veprimit është 2-vjeçar për të konkretizuar të gjitha masat dhe hapat e duhur që do të ndërmerren për hartimin e strategjisë. Pra, për t'ju bërë më konkrete situatën, duke qenë se tani jemi duke punuar me strategjinë kombëtare të rinisë 2022-2029, plani i veprimit do të jetë 2022-2024.

Rikthehemi te plani.

Përmendët se për sa i përket planit të veprimit, i cili ka qenë për periudhën 2015-2020, më lejoni t'ju kujtoj se unë jam bërë zëvendësministre e Arsimit në muajin maj të vitit 2021, por përtej kësaj, detyra ime e parë ishte të vlerësoja çfarë ishte bërë në këtë fushë.

Ju përmendët monitorimin.

Më lejoni t'ju sqaroj diferencën midis monitorimit dhe vlerësimit, sepse mendoj që ka vend për sqarim.

Monitorimi kryhet kur një strategji zbatohet dhe vlerësimi kryhet pasi ka mbaruar. Pra, duke qenë se detyrën unë e kam marrë në maj të vitit 2021, ishte krejtësisht e pamundur të bëja një monitorim prapaveprues të një plani veprimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Unë ju dëgjova deri në fund dhe i kam mbajtur të gjitha shënim.

Ju lutem, më dëgjoni, dhe nëse do të keni komente, do të rikthehemi sërish!

Plani kombëtar, duke qenë se ishte për periudhën 2015-2020 dhe unë e kam marrë detyrën në maj 2021, është logjikisht e pamundur të bëja një monitorim. Megjithatë, detyra e parë që kam bërë jo në kuadër të këtij institucioni, por në të shkuarën, kur isha zëvendësministre e Rinisë, ka qenë vlerësimi i planit kombëtar të rinisë. Vlerësimi i planit kombëtar të rinisë është kryer dhe pjesa e rëndësishme, që vlen të theksohet, është se CRCA-ja ka qenë një nga organizatat e përfshira në këtë vlerësim, sepse një pjesë e madhe e planit kombëtar të rinisë lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me aktivitete që kryhen nga organizatat rinore. Pikërisht kjo organizatë ka qenë pjesë e konsultimeve tona për këtë raport vlerësimi. Megjithatë, siç vutë re dhe siç e vutë në dukje, për shkak të ndryshimit të përgjegjësisë dhe të fushës së kompetencës së rinisë sa në një ministri në një ministri tjetër, monitorimi nuk është kryer siç duhet. Kjo është arsyeja pse kjo strategji e re kombëtare në pjesën e parë të saj adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë se si do të kryhet monitorimi dhe vlerësimi në të ardhmen, sepse jo gjithmonë mund t'i kthehemi asaj që nuk është bërë mirë, por mund të bëjmë më mirë këtë që kemi në të ardhmen. Ky ka qenë një nga leksionet më të rëndësishme

të dala nga plani kombëtar i veprimit dhe do të zbatohet në mënyrën e duhur për sa i përket strategjisë së rinisë.

Për sa i përket planit, në mungesë të një faqeje interneti, nuk e kemi shpallur zyrtarisht, por ju pretoj që sapo të jetë gati faqja e re e internetit të institucionit që unë përfaqësoj, patjetër që edhe ky plan do të jetë i shpallur. Ne e kemi në dispozicion me të gjitha palët e interesit dhe kushdo që ka shprehur dëshirën për ta lexuar, i është vënë në dispozicion. Nëse ju do të doni ta keni këtë plan vlerësimi, mund t'ju kalojmë.

Përmendët një element tjetër për sa u përket tenderëve dhe granteve që i dedikohen fëmijëve dhe të rinjve.

Së pari, unë nuk mbaj mend të kem përdorur ndonjëherë fjalën “tenderë”, ndoshta më ngatëroni me ndonjë nga kolegët ministra. Për më tej, edhe fjalën “grant” nuk e përmenda, por specifikisht përmenda “grantdhënie”, sepse ne bëjmë thirrje për projekt-propozime rinore dhe projektpropozimet rinore janë vlera shumë të vogla, nëse doni që t'ju konkretizoj, bëhet fjalë për 3 milionë lekë për organizatat, ndërsa për disa të tjera është deri në 1 milion lekë. Këto janë vlerat për të cilat po flasim.

Sa i përket monitorimit dhe vlerësimit më lini t'ju rikujtoj edhe një fakt tjetër, Agjencia Kombëtare e Rinisë është ngritur në vitin 2020, që do të thotë që thirrja e parë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë ende nuk është finalizuar, zakonisht monitorimi dhe vlerësimi realizohet, pasi përmbillen të gjitha programet. Patjetër, është në detyrat dhe kompetencat kjo gjë, unë e kam kërkuar dhe do të jetë gati që në momentin e parë kur kjo thirrje të mbyllet. Në momentin që do të mbyllet thirrja, që do të jetë i gjithë plani i monitorimit të çdo aktiviteti që është kryer, do të jetë publikisht në faqen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë në dispozicion të kujtqo që do ta lexojë.

Sa i përket mungesës së transparencës dhe të elementeve të tjera nuk e di nëse e keni pasur mundësinë të lexoni se çfarë iniciativash të reja kemi ndërmarrë sa i takon Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Në fakt, kur diçka bëhet për herë të parë ka leksione për t'u mësuar dhe për t'u nxjerrë dhe nga leksionet që ne kemi nxjerrë. Sa i takon punës që po bëjmë me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, është përshtatja e metodologjisë së thirrjes me një praktikë të pranuar dhe të mirënjohur të Bashkimit Europian, metodologjia LOD. Pra, ne tashmë jemi duke punuar për të ndryshuar dhe riformatuar VKM-në, e cila përcakton metodologjinë e thirrjes së Agjencisë Kombëtare të Rinisë për ta bërë atë konformë të gjitha direktivave dhe rregullave të Bashkimit Europian, edhe pse ky nuk është një detyrim, por një iniciativë jona me qëllim përmirësimin e transparencës, eficiencës, por edhe të informacionit publik për të

interesuarit lidhur me këtë fushë. Edhe kjo është në proces, kështu që besoj se brenda këtij muaji do të jemi në gjendje të finalizojmë të gjithë pjesën e procedurave ligjore. Thirrja e dytë do të hapet me kuadrin e ri ligjor, sipas çdo kërkesë të Bashkimit Europian.

Po kaloj te një temë tjetër e rëndësishme që janë praktikat e punës. Ju iu referuat praktikave të punës në administratën shtetërore, por, në fakt nga shifrat e fundit që unë kam kanë qenë 116 institucione të administratës shtetërore dhe 8 shoqëri tregtare që kanë marrë pjesë. Sa i përket shifrës 572, fakti që nga 572 janë punësuar 196 të rinj, për mua raporti 1 me 3 përafërsisht (duhet ta llogarisim, por ne e kemi më të mirë matematikën), gjithsesi përtej humorit, është një raport shumë i mirë. Besoj të gjithë i keni pasur eksperiencat tuaja kur keni aplikuar në fusha të ndryshme për aplikime pune, por atje ku kam studiuar unë raporti ishte 1 me 50, kështu që raporti 1 me 3 mua më duket mirë, por kjo nuk do të thotë që ne nuk jemi duke marrë iniciativa të ndryshme për ta zgjeruar dhe përmirësuar këtë skemë.

Për këto arsye unë jua përmenda që në fillim të prezantimit tim që ne gjatë këtij muaji dhe muajve në vijim do të bëjmë një fushatë promovuese të shoqëritë tregtare dhe te organizatat e shoqërisë civile me qëllim t'u kërkojmë të futen për t'u bërë pjesë e programit tonë të praktikave kombëtare, sepse kjo sigurisht do t'u ofronte të rinjve më shumë mundësi, siç e përmendi me të drejtë zonja Zhupa, që nuk janë vetëm në shtet, por edhe në shoqëritë tregtare. Qëllimi ynë është që nga 8 shoqëri tregtare që kishim vitin e kaluar këtë vit sikur ta dyfishonim apo trefishonim këtë numër patjetër që mundësitë për të rinjtë do të jenë më të larta.

E njëjta gjë vlen edhe për pjesën e organizatave të shoqërisë civile, duke qenë se ata i angazhojnë shpesh të rinjtë, pse jo, të mos jenë pjesë e një skeme të mirëkoordinuar dhe të organizuar nga ne?

Ju përmendët nevojën për ndryshim të VKM-së dhe të kriterëve evazive. Në fakt, VKM-ja e lejon hapësirën ku kriteret përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës, që do të thotë që patjetër nëse keni komente, sugjerime se si duhet shkruar këto kriterë ne i bëni me dije. Sivjet jemi ende në kohë për hartimin e kësaj strukture, duke qenë se ky është viti i parë në të cilin institucioni që unë përfaqësoj do ta drejtoj nga fillimi deri në fund këtë proces, kështu që mbetemi në diskutim.

Po u rikthehem kryetarëve të bashkisë.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë, të paktën që nga momenti që e kam marrë këtë detyrë, e kam marrë për të ngritur zërin për atë target-grup që unë përfaqësoj, fëmijët dhe për të rinjtë. Pavarësisht se çfarë

drejtimi politik ka kryetari i bashkisë, qoftë i Shkodrës apo i Lezhës, ndjesë që po i marr të dy si shembull, por pak rëndësi ka, njëri është aplikues, pasi po ndërton qendrën rinore, ndërsa tjetri është një aplikues që nuk ka aplikuar, pra joaplikues. Për mua i rëndësishëm është fakti që në çdo bashki të Republikës së Shqipërisë të ketë aktivitete për të rinjtë dhe për fëmijët dhe nëse angazhimi dhe përfshirja e kryetarëve të bashkisë është i nevojshëm, praktikisht jemi duke bërë një tur dhe personalisht po shkoj të takoj çdo kryetar bashkie për t'i informuar për detyrat ligjore, si për KVR-të, si për aplikimet që ne kemi në dispozicion.

Mbi të gjitha, më lejoni t'ju them se, pasi të mbarojmë takimin me ju sot, nga zyra ime është përgatitur një shkresë që do t'u dërgohet të gjithë kryetarëve të bashkive për t'u vënë në dukje mungesën e përgjigjes nga ana tyre dhe në rast se do të vazhdojnë të mos plotësojnë detyrimet e tyre ligjore, siç është detyrimi specifik i krijimit të KVR-ve, patjetër që do të penalizohen edhe kur vjen puna te projektet e ndryshme ku ata aplikojnë. Pra, pavarësisht bindjeve politike, të rinjtë dhe fëmijët nuk janë as të majtë dhe as të djathtë kështu që detyra ime është t'i përfaqësoj njësoj. Sa u përket kryetarëve të bashkive, nëse i kanë shpresat se po qenë të majtë nuk do t'u biem, nuk është rasti.

Po i rikthehem shërbimit komunitar. Komenti që ju keni bërë është shumë i drejtë, shërbimi komunitar nuk është më pjesë e kurrikulës, por ndërkohë programi jashtëskollor, të cilin jua detajova pak më parë, do të ketë një element të vullnetarizmit dhe të aktivitetit komunitar, të cilin të rinjtë do të mund ta marrin si pjesë jashtëskollore, jo si një pjesë e drejtpërdrejtë për kurrikulën. Duhet parë eksperiencën e të rinjve dhe duhet analizuar nëse për ta ka qenë më i vlefshëm shërbimi komunitar apo nëse do të jetë më i vlefshëm ky opsioni i ri, të cilin ne po u ofrojmë, i cili është me zgjedhje, sepse shërbimi detyrimi komunitar i detyrueshëm deri diku është pak si kontrast në vetvete.

Ju përmendët ligjin e vullnetarizmit. Unë kam qenë pjesë e komisionit dhe mendoj se është diçka që duhet të dalë si propozim i ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sepse ata janë entiteti zbatues i këtij ligji, ndonëse fillimisht ky ligj është propozuar nga një deputet, është një nga rastet e pakta që ne kemi ku një deputet propozon ligje të tilla, prandaj do të doja shumë të ishte një rast suksesi. Duke u nisur nga eksperiencën dhe të gjitha bashkëbisedimet që ne kemi pasur me organizatat e shoqërisë civile, organizata, të cilat tashmë që prej 2 vjetësh kanë bërë një vlerësim shumë të mirë të ligjit "Për vullnetarizmin", ata kanë dalë në konkluzionin që shumë prej temave që ne u referuam në komision nuk janë fiks temat që i shqetësojnë ata. Fushat e ndryshme që i shqetësojnë ata, unë jua përmenda pak

më parë, fillojnë që nga aspekti i lidhjes së kontratës, sepse një nga elementet që ligji ynë nuk e adreson është rasti kur kemi kontrata kolektive.

Po jua sjell si shembull, në një moment një organizate i duhen 1000 të rinj, por këta të rinj duhen vetëm për 1 ditë, sepse është një aksion vullnetar pastrimi, pra edhe kjo është punë vullnetare, por ndërkohë ligji që është parashtruar, aplikuar dhe zbatuar kërkon ose u jep detyrimin organizatave që të lidhin kontratë me 1000 personat që do të marrin për një aktivitet 2-orësh, kjo patjetër që e bën jetën e tyre të vështirë. E njëjta gjë është kur nuk bën një diferencim ndërmjet një kontrate vullnetare ku një i ri merr pjesë për 3 muaj, duke bërë realisht një punë të mirëfilltë vullnetare apo një i ri që vjen një ditë, unë kam pasur 2 praktikantë në zyrë që kanë ardhur për 1 ditë për të marrë eksperiencë, ishin 16-17 vjeçarë, të cilët kishin dëshirën për të parë se çfarë bëhej në kabinetin tim, por kjo nuk është mirëfilli punë vullnetare, sepse është për 1 ditë mund ta quajmë thjesht eksperiencë, prandaj duhet edhe diferenca.

Një nga problematikat e tjera që u diskutua në bisedën pas komisionit ishte një element që shpeshherë ngatërrohet, praktika e punës, sepse praktika e punës dhe vullnetarizmi janë dy gjëra krejt të ndryshme. Patjetër, eksperiencia vullnetare shërben si praktikë pune, për të treguar të sërë cilësish dhe aftësish të të rinjve që kanë marrë pjesë në këto eksperiencia, por nuk është e njëjta gjë.

Për këto arsye ne kemi rënë dakord, madje sot i kam dërguar edhe një *e-mail* komisionit për t'i vënë në dijeni për të gjithë punën që është kryer nga grupi ynë i punës me përfaqësinë e Ministrisë së Financave dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit, por më e rëndësishmja me të gjitha organizatat e shoqërisë civile që janë angazhuar dhe që përdorin ligjin në përditshmërinë e tyre, sepse janë pikërisht ata që mund të adresojnë problematikat në të cilat ne duhet të fokusohemi. Ne pikërisht këtë i kemi kërkuar komisionit, që të bëjmë në dëgjuesë tjetër me organizatat e shoqërisë civile për të kuptuar nga ata pikërisht se cilat janë pikat që ne duhet t'i ndryshojmë dhe të bëjmë rregullimet e duhura për këtë ligj në mënyrë që të jetë funksional, pra të mos ndalues ose frenues siç ka rezultuar në disa elemente deri tani.

Pyetja e fundit kishte të bënte me gjuhën e kodimit.

Së pari, më lejoni t'jua rikonfirmoj që fillon që në klasën e parë, nga mosha 6 deri në 7 vjeç, me aq sa jam në dijeni të ligjit tonë të hyrjes në klasën e parë. Dua t'ju flas pak më gjatë për këtë, sepse mendoj që është e rëndësishme për ta kuptuar më mirë, sepse ndonjëherë lindin pyetje nga mungesa e informacionit. Ky është një program shumë i thjeshtë, nuk jam duke folur për atë kodimin që ju keni parasysh me numra apo shkronja, vizat e gjata të kodit

që janë të kuptueshëm për ne të jemi të rritur e jo më për të vegjlit, por po flas me kodim me blloqe. Kodimi me blloqe, mënyra më e thjeshtë për t'ia shpjeguar një prindi është si legot, besoj se i keni parasysh ato lojërat plastike që formohen njëra pas tjetrës, kjo është ajo që do të mësojnë fëmijët në klasë të parë. Pra, është një lloj kodimi ky ti me anë të një platforme *online* merr kuba të ndryshëm dhe i vendos në një seri radhe aktivitetesh, duke mësuar rrjedhën logjike të zhvillimit të episodit.

Për shembull, nëse një top përplasat me murin e majtë, ai top dyfishohet, nëse një top përplasat me murin e djathtë ai top trefishohet. Ky është formati i lojës që fëmijët do të mësojnë nëpërmjet një formati interaktiv dhe praktikisht nuk është e nevojshme që të dinë të shkruajnë apo lexojnë, sepse programi është shumë vizual, pra edhe një fëmijë që nuk e ka aftësinë për të mësuar numrat apo për të lexuar në vetvete mund ta përdor. Është në formatin e një loje, interaktiv dhe u krijon interesin e përgjithshëm fëmijëve që jo vetëm të luajnë në shkollë, ka një logim ku mund të logohen me emrin dhe mbiemrin e tyre dhe kur shkojnë në shtëpi kanë sërish mundësi të luajnë me të njëjtin program dhe të mësojnë më tepër nga ky program.

Sigurisht, edhe mësuesit janë një pjesë e rëndësishme. Ne jemi në dijeni që mësuesit nuk kanë ecur me hapin e kohës, kështu që edhe ata do të përfshihen në një proces të gjatë trajnimit për t'u siguruar që ata të parët e kuptojnë se çfarë është ky program dhe të dinë t'ju mësojnë më së mirë fëmijëve. Pjesë e rëndësishme është fakti që është konsideruar lëndë me zgjedhje dhe pa notë, që do të thotë se fëmijët e klasës së parë nuk do të vihen nën presionin e marrjes së notës për këtë lëndë, por do të jenë një lëndë që ka si qëllim kryesor zhvillimin e mendimit kritik dhe forcimin e aftësive logjike dhe argumentuese të këtyre fëmijëve. Pra, nuk është vetëm programi, pasi mund të duket programimi si diçka shumë e vështirë dhe mund të themi pse po jua mësojmë fëmijëve që në klasë të parë, por në të vërtetë është diçka shumë e thjeshtë, është format loje dhe mënyra për të krijuar lidhjet logjike, konsekuencat. Diçka pozitive e këtij programi është që edhe sigurinë në internet ia mëson pikërisht në formë loje.

Nuk e di nëse e keni vënë re ndonjëherë në kompjuter komentim që del: shihni kompjuterët që janë afër meje. Të shohësh kompjuterët që janë afër teje do të thotë që t'i lejosh akses një kompjuteri tjetër për t'u futur në kompjuterin tënd. Kjo u mësohet fëmijëve në mënyrën e një shakaje, ku ti je midis disa miqve në klasë dhe nëse dëshiron ose jo të bashkëbisedosh me miqtë në klasë, nëse do t'ia japësh copën e letrës shokut tënd ose jo. Pra, sa i takon mënyrës se si është disenjuar e gjithë kurrikula, më duhet t'ju them se ajo është

dizenjuar me anë të ekspertizës së një eksperti anglez, i cili është marrë gjithë jetën me sistemin e arsimit parauniversitar dhe të teknologjinë e informacionit dhe gjithçka është menduar në formatin e lojës dhe që të jetë më e përthithshme nga fëmijët e klasës së parë, ky është qëllimi.

Megjithatë, duke thënë këtë, arsyeja pse është vendosur të bëhet në 100 shkolla është për ta pilotuar, për të marrë mësim dhe ndoshta për të kuptuar nëse kjo platformë është e duhura, nëse kjo mënyrë e të bërit të kësaj lënde përcillet mirë nga nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, prandaj edhe monitorimi dhe vlerësimi do të jetë shumë i rëndësishëm.

U bë edhe një koment tjetër se si janë përzgjedhur 100 shkollat. Më duhet t'ju them se për këtë është bërë një listë kriteresh së cilës i është qëndruar një për një, duke filluar nga shpërndarja gjeografike. Qëllimi ka qenë një shkollë për secilën bashki, sepse, sigurisht, numri ishte i limituar, ka qenë numri total i nxënësve, numri i klasave të para në shkollë, si dhe numri i nxënësve në klasat e para. Sa i takon shpërndarjes, për momentin nuk i kam të ndara, sipas dy shpërndarjeve, por jemi përpjekur të fusim edhe shkollat e zonave rurale, por duke qenë se është pilotim dhe është momenti i parë, si dhe fondet që kishim në dispozicion nuk ishin të mjaftueshme për t'u shtrirë në të gjitha shkollat e Shqipërisë, kjo do të jetë vetëm faza e parë e këtij programi, shpresoj që do të kemi mundësinë të marrim mësim nga më të ndryshmet.

Më bëtë edhe pyetje tjetër, së cilës patjetër që dua t'i kthej përgjigje, sepse e kam dëgjuar që ngrihet shpesh: çfarë modeli keni zgjedhur? Më lini t'ju them që nuk jemi të parët, jemi pothuajse të fundit në përfshirjen e teknologjisë në klasat e para. Nëse do të shihni shembujt e rajonit shumë të tjerë përpara nesh e kanë bërë, do të kisha dashur ta kishim bërë pak më herët implementimin e kësaj, por në fakt jo. Për të qenë e sigurtë, ndonëse nuk ka qenë detyra ime specifike, por në kuadër të grupit të punës së bashku me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në arsimin parauniversitar është bërë një analizë shumë e detajuar, sipas të dhënave të *Euridays*-it, një material, i cili përfshin pjesën e edukimit digjital të shkollave në Europë. Janë studiuar gjithsej 18 vende dhe nga këto 18 vende në 11 sisteme arsimore teknologjia e informacionit trajtohet si një lëndë e veçantë e detyrueshme dhe në 10 sisteme ajo integrohet si lëndët e tjera, pra si e detyrueshme, ndërsa ¼ e sistemeve arsimore i kombinojnë të dyja qasjet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Patjetër që mund t'ju them 1 apo më shumë, vetëm më lini t'i identifikoj se cilat janë të duhurat. Nëse marrim shembullin e Çekisë, në Çeki zhvillohet në klasën e parë si lëndë e

veçantë dhe ka gjithsej 29 orë mësimore në total; në Rumani zhvillohet në klasë të parë, në Serbi, Greqi, Francë dhe Letoni zhvillohet në klasë të parë, por ka edhe shumë vende të tjera ku zhvillohet në klasë, por studimi ynë, duke qenë se për shkak të rregullave duhet të bazohet në studime zyrtare kemi marrë...

(Diskutime pa mikrofon.)

E kuptova shqetësimin tuaj dhe do të gjej rastin, edhe pse nuk ishte me mikrofon, t'ju kthej përgjigje, sepse është një shqetësim i vlefshëm. Pavarësisht që ne e kemi përmendur gjatë gjithë kohës kodimin në klasë të parë, sigurisht lënda është Teknologji e Informacionit. Nëse do t'i shihni të gjitha materialet zyrtare të publikuara, është përfshirja e Teknologjisë së Informacionit që në klasë të parë, tani që jemi duke folur e kemi në klasën e katërt, por mënyra se si ndahet kurrikula ka diferencat e saj dhe nuk besoj se vlen ta diskutojmë këtu përmbajtjen e kurrikulës specifike dhe t'i futemi se çfarë ka ora e parë, e dytë dhe ora e njëzetënëntë. Nëse dëshironi, mund ta bëjmë edhe këtë bisedë, duke i gjetur të gjitha materialet e nevojshme, por më besoni që kurrikula nuk përfshin vetëm kodimin, por është edhe për pjesën e teknologjisë së informacionit, pjesën e sigurisë në rrjet, pjesën e logjikës dhe të informacionit e kështu me radhë.

Po rikthehem te platforma. Pjesa e parë e shpjegimit tim sa i përket programit të kodimit lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me 100 laboratorë të rinj teknologjik dhe prandaj kjo nismë nuk po shtrihet në të gjitha shkollat e Shqipërisë, por po shtrihet në ato shkolla ku duke filluar nga javët në vijim, sapo të fillojë puna për zbatimin e këtij programi, do të ndërtohen laboratorë teknologjik të rinj në 100 shkolla. Pra, këto 100 shkolla do të kenë kompjuterë të rinj, të cilët e mbështesin dhe e suportojnë nga ana teknike këtë platformë, do të kenë lidhje interneti të qëndrueshme që u siguron lidhjen me internetin për përdorimin e platformës, do të kenë mësues të trajnuar për përdorimin e këtyre pajisjeve, kompjuterëve, ekranit interaktiv që do të kenë në dispozicion në klasë. Kjo është edhe arsyeja pse e kemi shtrirë në 100 shkolla, sepse kaq ishte edhe mundësia për t'u shtrirë ashtu siç duhet dhe me infrastrukturën e nevojshme që ta bëjë të mundur zhvillimin e kësaj lënde.

Sa i takon pjesës se si funksionon mësimi *online*, do të duhet të pyesni kolegët.

Kam edhe diçka tjetër që dua ta ndaj me ju, platforma që është përzgjedhur është izraelite, sepse pyetët për modelin disa herë, dhe është një nga platformat më të mira në këtë fushë dhe ka rezultuar shumë e suksesshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo vetëm në Izrael, por është aplikuar edhe në SHBA dhe në vende të tjera të ndryshme, por do të më duhet t'i identifikoj të gjitha vendet ku është aplikuar.

Sa i përket modelit...

(Diskutime pa mikrofon.)

Merita Bakiu – Është kurrikul, të paktën ajo që kemi ngritur si problem, e papërshtatshme me sistemin tonë këtu dhe është e gjitha e dështuar. Keni 20 minuta që flisni, unë ju përgëzoj nëse ato arritje që thoni janë në të gjithë Shqipërinë. Dua të di: a përshtatet kjo kurrikul për një fëmijë që është në fshat, ku nuk ka fare drita, ndërsa ju i thoni për kodim?

(Diskutime pa mikrofon.)

Fshati nuk ka drita.

Hajdeni në Bruz, në malin e Krujës, nuk ka dritë.

Ju flisni për digjitalizim...

(Diskutime pa mikrofon.)

Sugjerimi im është që të rishikohet kurrikula dhe të përshtatet jo me Izraelin, por me Shqipërinë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, nuk është përshtatur, se është e dështuar në çdo hap. Jeni të dështuar me tekstet që keni përkthyer dhe me disa module që nuk i aplikoni dot, ndërsa ju i quani arritje. Nuk janë arritje. Ajo është për Tiranën dhe për Durrësin...

(Diskutime pa mikrofon.)

A e kuptoni se çfarë po bëni, po bëni diferencim të fëmijëve. Ju po fusni një kurrikul vetëm për pjesën e atyre fëmijëve që mësojnë në qytet, ndërsa ata të fshatit po i diskriminoni. Kjo është përshtatja e kurrikulës që ta përshtasni...

(Diskutime pa mikrofon.)

Zotëri, krijoni kushtet...

Petro Koçi – Duhet të flasim me ministren e Arsimit...

Merita Bakiu – Jeni duke e quajtur arritje, ka 20 minuta që flet dhe i quan arritje, ndërkohë që nuk janë, kjo është e gjitha.

Flutura Açka – Zonja Ministre, ju lutem, përmbliidheni fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ina Zhupa – Zonja Ministre, për ta sqaruar këtë çështje...

Flutura Açka – Zonja Zhupa, shtypeni butonin e mikrofonit, sepse e ka fjalën ministrja, më pas do të vazhdojmë me ndërhyrjet.

Bora Muzhaqi – Po përpiqem, por ishin 12 pyetje, prandaj po i identifikoj një për një për të mos thënë që nuk u ktheve përgjigje pyetjeve.

Isha duke folur për modelin dhe arsyeja pse nuk i referohem dot...

Flutura Aça – Ju lutem, kolegë, mbani qetësi!

Bora Muzhaqi – Unë mendoj që, për sa kohë ka pyetje për këtë temë, është një temë që ia vlen të ndalesh, sepse është e rëndësishme, ndoshta të gjithë ju keni fëmijë dhe unë së shpejti do të kem fëmijë.

Sa i takon modelit arsyeja pse nuk ju përmenda një model specifik është sepse në ndryshim nga ajo që bëjmë ndonjëherë duke marrë një model shabllon dhe e fusim në kurrikul, kjo nuk është bërë, por kemi studiuar 18 vende të rajonit dhe të Bashkimit Europian për vlerësimin. Fakti që platforma është izraelite nuk do të thotë që platforma është kurrikula, pasi kurrikula është hartuar në përputhje me versionet se çfarë duhet dhe çfarë është e nevojshme nga aspekti i kurrikulës.

Duke qenë se po flasim për shtatorin e vitit 2022, unë jua përmenda, por do t’jua përmend edhe një herë tjetër, po jua ritheksoj se ky program do të fillojë për vitin shkollor të këtij viti në 100 shkolla për klasat e para. Kjo do të thotë që detyra ime si ministre, detyra juaj, detyra jonë si qeveri është që për vitin tjetër të bëjmë një plan. Është e drejtë ajo që thoni ju, në disa fshatra dhe qytete të ndryshme. Kjo gjë mund të ketë edhe problematikat e veta dhe për këto arsye ne nuk po e fillojmë direkt tek ata, sepse për momentin që jemi duke folur nuk i kemi fondet dhe mundësitë për t’u shtrirë tek ata, por detyra jonë është që deri vitin e ardhshëm t’i gjejmë mundësitë dhe t’i bëjmë parashikimet në mënyrë që të shtrihemi më tej.

Ju thatë që nuk ka shkolla në fshat. Ne kemi shkolla në fshat, por po të doni mund t’ju jap edhe listën e shkollave të përzgjedhura sapo të marrim miratim edhe nga institucionet përgjegjëse. Në Krujë, në mos gaboj janë 3, 2 në qytet dhe 1 në fshat, por më duhet të rikthehem edhe një herë sa u takon të gjitha shkollave. Më besoni në atë që po ju them, së pari, siç e thonë anglezët më lejoni *benefit of the doubt*, pra më jepni mundësi ta fillojmë programin dhe të shohim se si do të rezultojë. Unë mendoj që do të jetë i suksesshëm dhe një mundësi e shtuar për fëmijët tanë që të ecin përpara në një botë teknologjike, të cilën nuk kanë pasur mundësi ta kenë deri tani. Unë mendoj që kurrikulat aktuale që ne kemi deri tani për teknologjinë e informacionit nuk përshtaten aq sa duhet me kërkesat që ky treg ka, sepse nuk jemi duke folur për matematikë apo fizikë këtu, unë di që ligjet e Njutonit vazhdojnë të jenë po ato që ishin, por në rastin e teknologjisë së informacionit ligjet, në sensin e shakasë, ndryshojnë dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme.

Në kuadër të bisedës që kemi bërë bashkë gjatë këtyre orëve të fundit, jam e bindur se ka ndodhur një ndryshim në fushën e teknologjisë, i cili do të duhet të përditësohet, por këtë ne nuk e bëjmë dot me kurrikulat, sepse është një brez i tërë. Problematika tjetër e reformave në arsim është fakti që shpeshherë duhet të jemi të duruar, sepse duhet pak kohë që të dalin rezultatet, prandaj do t'ju kërkoja të mos e paragjykonit shumë këtë program përpara se të fillojë zbatimin dhe të kemi një perceptim të duhur nga nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit. Unë shpresoj shumë që po ua ofrojmë të gjitha mundësitë si në aspektin strukturor, si nga trajtimi i burimeve njerëzore, si nga përgatitja e një kurrikule që mund të zbatohet dhe mund të përshatet me nevojat dhe kërkesat që fëmijët e një zone kanë, pra duke u krijuar të gjitha mundësitë për implementimin e duhur të këtij programi edhe programi do të jetë i suksesshëm.

Çfarë shoh unë si vështirësi? Implementimi për vitin tjetër, sepse do të na duhet të gjejmë fonde dhe donacione sa u përket edhe atyre 1100 shkollave që mbeten. Kjo është sfida ime. Kjo është një sfidë, të cilën duhet ta luftojmë bashkë, sepse, patjetër, çdo shkollë në Shqipëri meriton një laborator teknologjik të një cilësie sa më të mirë dhe kjo është një detyrë e përbashkët, ndoshta me mua të parën, prandaj unë do ta bëj pjesën time.

Kam edhe një pyetje të fundit, të cilën nuk e kam trajtuar ende, të zonjës Zhupa. Ju përmendët pjesën e...

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse e tërhiqni pyetjen, nuk i kthej përgjigje.

Flutura Açka – Ju lutem, lëreni ministren ta përmbledhë fjalën!

Bora Muzhaqi – Përmbledhja është pak e vështirë, por po trajtoj pyetjen e fundit që më ka mbetur.

Pyetja kishte të bënte me artet dhe zejet, por me ato që dëgjova shtimi i orëve të mësimit, rritja e rrogave për mësuesit, kësaj nuk do t'i kthej një përgjigje të drejtpërdrejtë, sepse nuk është fusha ime. Gjatë fjalës sime unë fola gjatë për programin jashtëshkollor, për pjesën e arteve, të zejeve, të teknologjisë, të kopshteve të gjelbra, të vullnetarizmit dhe të edukimit mjedisor dhe elementi pozitiv i këtij programi është fakti që shumë mësues do të angazhohen edhe në orët shtesë pas mësimit.

Pra, duke iu kthyer në mënyrë indirekte përgjigje pyetjes së zonjës Zhupa, që përmendi pjesën e uljes së numrave të mësuesve të artit, duke qenë se ky program jashtëshkollor, të cilin kemi ndër mend ta fillojmë në shtator të këtij viti, do të ingranojë shumë nga këta mësues, ndoshta do të jetë edhe pozitiv në aspektin e rritjes së numrit të

mësuesve në fushën e arteve, ku futet piktura, muzika, teatri, kori e të gjitha elementet e tjera. Po i kthehem zonjës Bakiu, e cila u shpreh se fjala “disiplinë” nuk është e duhura, por do ta ndryshojmë.

Besoj se nuk lashë asnjë pyetje pa i dhënë përgjigje, kështu që po e mbyll fjalën time këtu.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Ministre!

Zonja Zhupa, fjala për ju, por ju lutem shkurtimisht, 2 minuta!

Ina Zhupa – Dy minuta, zonja Ministre, për pasaktësitë dhe paqartësitë.

E para, Agjencia Kombëtare e Rinisë është krijuar me vendimin nr. 681, datë 2.9.2020, pra nuk është organ i ri dhe nuk është në thirrjen e saj të parë, por përkundrazi ka dhënë 12 projekte për shoqatat dhe 4 projekte për bashkitë në vlera që shkojnë rreth 60 milionë lekë, ndërkohë që ju thatë se është organ i ri. Ka thirrjen e parë dhe nuk kemi pse të kemi punë monitorimi.

Së dyti, sa u përket shteteve që unë ju kërkova, ju më thatë një listë të shteteve që bëjnë Teknologji Informacioni. Ajo që keni thënë deri tani në të gjitha mediat është fakti që keni folur për gjuhën e kodimit, ndërkohë që gjuha e kodimit është lëndë më vete dhe hyrja në Teknologjinë e Informacionit, çfarë është kompjuteri, si ndizet e të tjera, është lëndë më vete. Nëse ju, kur flini për kodim, keni parasysh hyrjen në informatikë dhe në teknologjinë e informacionit është gjë tjetër, edhe nëse po e përdorni fjalën kodim, sepse kështu ju duhet për projektet dhe disa investitorë strategjikë, prapë kjo është çështje tjetër.

Së treti, zonja Ministre, unë ju pyeta për një problematikë shumë të madhe, që duhej të ishte shqetësimi juaj kryesor, për fëmijët që lypin në rrugë, fëmijët e rrugës dhe fëmijët me probleme.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Zhupa!

Fjala për ministren.

Më pas fjalën e ka zoti Spaho.

Bora Muzhaqi – Së pari, as pasaktësi dhe as paqartësi. AKR-ja, siç jua përmenda, e keni edhe në materialin që ju kam dërguar, aty shkruhet qartazi, është ngritur me vendimin nr. 681, të datës 2.9.2020. Kjo ishte pikërisht ajo çfarë thashë unë.

Kur flasim...

(Diskutime pa mikrofon.)

Do të doja shumë të më dëgjoni. Sa i përket krijimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë më duhet t'ju them se është krijuar në vitin 2020. Sa i takon hapjes së thirrjes së parë, do të më duhet të rishoh datat, por nëse nuk gabo, është hapur në gushtin e vitit 2021. Thirrja e parë zakonisht zgjat nga 6 deri në 12 muaj, që do të thotë se ende nuk është përmendur.

Nëse do të më kishit dëgjuar sa i përket pjesës së thirrjeve dhe projekteve të përzgjedhura, unë specifikisht ju përmenda që janë 12 organizata rinore që kanë përfituar nga thirrja e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, si dhe 4 bashki Që ne të bëjmë një raport vlerësimi, po i rikthehem sërish, duhet jo vetëm që të përzgjidhen fituesit, por duhet të përmbillet i gjithë projekti, por projektet, siç jua thashë zgjasin nga 6 deri në 12 muaj. Duke qenë se projektet kanë filluar në nëntor të vitit të shkuar, ato përfundojnë në nëntor të këtij viti, një pjesë e madhe e tyre, disa kanë përfunduar. Sa u takon atyre që kanë përfunduar, ka raporte monitorimi dhe vlerësimi që bëhen sipas kërkesave ligjore nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Sa i përket fondit është 49 milionë, për sqarim edhe kjo pjesë.

Kur flasim për gjuhën e kodimit, po i rikthehem, sepse është e rëndësishme dhe duhet diskutuar. Unë kam të hapur kurrikulën e propozuar për klasën e parë, ku 5 deri në 10% i përket botës së kompjuterit, kompjuteri im, rregullat, pjesët e kompjuterit, mausi, si të hapim programe, të vizatojmë së bashku, format dhe ngjyrat, algoritmet në botën reale; 20 deri 25% përfshin hyrjen në multimedia; 60 deri në 70% përfshin botën e kodimit, ndërsa 5% përfshin sigurinë në internet.

Që të shpjegohe mi, ka një pjesë legjislative kur vjen te pjesa e kurrikaleve, ky ndoshta është një debat që duhet bërë midis atyre që kanë ekspertizën e duhur për hartimin e kurrikulave, që lidhet me emrin që i vendoset një kurrikule. Elementi i ri që përfshihet në këtë kurrikul, në qoftë se keni pasur rastin të shihni kurrikulat e teknologjisë së informacionit që nga klasa e katërt deri në vitin e tretë, besoj se jeni në dijeni që në klasën e nëntë është momenti i parë kur fillon kodimi me kurrikulën që ne kemi. Ndërkohë, propozimi ynë është që kodimi të mos fillojë në klasën e nëntë, por të fillojë që në klasën e parë. Patjetër, një fëmijë nuk mund t'i mësohet vetëm një gjë në asnjë lëndë, është njësoj sikur të thoshim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Së pari, gjuha e kodimit nuk është një gjuhë kodimi, tani që flasim kemi një varietete të gjuhës së kodimit, madje një pjesë e tyre në kohën që ne flisim, dolën jashtë funksionit. Gjuha e kodimit, është një temë shumë e gjerë. Ne nuk kemi folur në asnjë moment për gjuhë kodimi, më lejo të të sqaroj për këtë pjesë, por kemi folur për kurrikulën e kodimit në klasën e parë, për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Eja të futemi në debat nëse termi

“Teknologji informacioni dhe komunikimi” është ndoshta termi i duhur për ta quajtur këtë lëndë! Shumë shtete e quajnë ndryshe. Kjo është një përzgjedhje, që në fakt nuk bëhet as nga unë, as nga ju, por bëhet nga disa ekspertë, që merren në mënyrë të përditshme me hartimin e kurrikulave.

Më lejoni t’ju them që unë i besoj ekspertizës së tyre, sepse kam përshtypjen që kanë më shumë kohë që merren me pjesën e kurrikulave, seç mund të kem unë në këtë detyrë, që sigurisht jam marrë më shumë me aspektin e drejtimit dhe jo të hartimit të kurrikulës.

Për sa i përket pjesës së fëmijëve të rrugës, që ju i përmendët në morinë e shumë të pyetjeve, e cila mbeti pa përgjigje, është një temë shumë e rëndësishme. Nuk e di sa më dëgjuat për sa i përket aplikacionit për pjesën e bullizmit të fëmijët, ku një nga elementet e atij aplikacioni do të jetë edhe elementi i raportimit jo vetëm nga vetë fëmijët, por edhe raportimi nga prindërit apo palët e treta për të adresuar raste të tilla.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka shumë funksione ai aplikacion dhe një nga ato është edhe që edhe vetë fëmijët mund të raportojnë për problematika të ndryshme.

Megjithatë, një nga elementet kryesore që do të doja të ndalesha, është një nga programet shumë të rëndësishme që po ndërmarrim me UNICEF-in, që duhet programi “Qëndro!”, qëllimi i të cilit është t’i mbajmë fëmijët në shkollë. Një nga problematikat kryesore të fëmijëve të rrugës është pikërisht ky, që largohen nga shkolla ose prindërit e tyre nuk i çojnë në shkollë. Ky program është duke u draftuar dhe duke u konkretizuar me hapat që do të ketë. Do të më lejoni sërish të rikthehem edhe për këtë pjesë, pasi janë hapat e parë të këtij programi. Është një program me vlerë të konsiderueshme, me donacion nga UNICEF-i dhe qeveria italiane për qeverinë shqiptare, për të rritur numrin e fëmijëve dhe të rinjve që qëndrojnë në shkollë.

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Spaho.

Florenc Spaho - Faleminderit, kryetare!

Në fakt, një pjesë e pyetjeve u ezauruan për shkak të shpjegimit që bëri ministrja, por edhe për shkak të pyetjeve të kolegëve.

Ju falënderoj dhe ju përgëzoj, zonja Ministre, për të gjithë energjinë që sollët! Faleminderit, edhe stafit tuaj, sepse te relacioni dhe memoja që na keni sjellë duket një bashkëpunim i madh me një sërë ministrish!

Më parë thatë se jeni një staf i ngushtë prej 8 vetash, relativisht shumë i vogël për një punë kaq të madhe për bërjen e këtyre projekteve. Në fakt, fillimisht çdo punë nis me projekte, fillon me ide, me vizion dhe më pas implementohen. Falë jush dhe stafit tuaj keni bërë një projekt për të gjitha ministrinë përkatëse, që kanë lidhje direkte apo indirekte me ministrinë tuaj.

E para, do të doja të dija deri ku keni arritur sa u përket shumë të rinjve, që në një moshë të hershme u duhet të zgjedhin edhe profesionin e të ardhmes së tyre? Në fakt, shumë të rinj kanë nevojë për një mbështetje lidhur me këshillimin e karrierës. Patjetër që ky tagër mund të jetë i Ministrisë së Arsimit, por është edhe Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve, e cila mund të merret drejtpërdrejtë me projekte të tilla, si *workshope* e takime me të rinjtë, ku t'i adresojnë ata drejt profesioneve më të nevojshme dhe më të prekshme sot.

E dyta, sa i përket eksperiencës së punës së të rinjve, jam dakord me atë që thotë zonja Zhupa, që shumë institucione shtetërore, por edhe private kërkojnë staf të kualifikuar me eksperiencë pune.

Unë në parlament jo më larg se para 3-4 javësh kam ngritur një shqetësim, të cilin e kam hasur në zonat që mbuloj. Grupet e bizneseve u kanë dhënë mundësi shumë të rinjve që të marrin eksperiencën e punës pranë bizneseve të suksesshme, të vogla apo të mëdha. Pra, këto biznese u kanë hapur dyert shumë studentëve që janë në proces arsimimi, por janë gjendur përballë një fakti jo të këndshëm, pasi janë përballur me disa inspektorë të Tatimeve, që i kanë gjobitur.

Lidhur me këtë problematikë, kjo është një marrëdhënie përtej kompetencave tuaja, por duhet një kombinim mes Ministrisë së Financave dhe ministrisë suaj dhe ministrive përkatëse, që të bëni të mundur t'u lejojë këtyre studentëve të bëjnë praktika profesionale, të cilat t'u njihen si eksperiencë pune. Nuk ka rëndësi në çfarë viti mund të jetë studenti, por duhet krijuar një mekanizëm i fortë për të mos lejuar informalitetin, sepse apriori, në qoftë se një student i Stomatologjisë është në një klinikë dentare dhe mund të jetë në vitin e tretë apo të katërt, patjetër që është duke marrë një eksperiencë pune dhe nuk mund të punojë, por në qoftë se po ky student mund të punojë në një hotel, të themi, në rolin e recepsionistit apo një ndihmësi, patjetër që është duke punuar dhe ne nuk mund të lejojmë që të ketë informalitet. Pse të mos krijohet ky mekanizëm për të gjithë ata studentë që kërkojnë të marrin eksperiencë pune?

Në dijeninë time, në Urdhrin e Punonjësit Social apo të Psikologut thuhej se në qoftë se nuk do të kishte një vit eksperiencë pune, ky student nuk mund të jepte provimin për të

marrë licencën e psikologut ose të punonjësit social, ndërkohë, edhe pa një vit eksperiencë pune nuk mund ta punësonite asnjë institucion shtetëror apo institucion privat. Pra, gjithmonë krijohen mekanizma në kundërshtim me njëri-tjetrin. Ka pasur shumë studentë, në fakt, dhe unë njoh shumë prej tyre, të cilët paguanin kontributet te një institucion, organizatë apo OJF, në mënyrë që t'u njëhej si eksperiencë pune dhe më pas shkonin drejt provimit për t'u licencuar.

E treta, unë ju kam ndjekur, në fakt, dhe ju keni prekur shumë bashki, kryesisht edhe në qarkun e Elbasanit. Do të doja të dija në çfarë faze janë projektet për të gjitha bashkitë? Çfarë synoni të arrini? A do të ketë projekte, të cilat do të vijnë duke u shtuar? Flas për bashkitë e qarkut të Elbasanit, sepse për Elbasanin di që janë dy projekte, të cilat po i ndiqni dhe i keni implementuar edhe nëpër shkolla, falë jush dhe Ministrisë së Arsimit, në fakt, por keni qenë iniciuese e këtyre projekteve.

Faleminderit!

Flutura Açka – Zonja Ministre, fjala për ju.

Bora Muzhaqi - Faleminderit, për pyetjet!

Do t'ju kthej përgjigje për përditësimet që kemi bërë gjatë kësaj kohe, që nga takimi i fundit.

Sa i përket orientimit të karrierës, kjo qëndron. Është një nga shtyllat kryesore që ne do ta përfshijmë jo vetëm si pjesë e strategjisë, por edhe nëpërmjet bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit. Po punojmë për krijimin e kurrikulave për klasën e nëntë dhe mendojmë se kjo do të japë një element shumë pozitiv dhe do t'u ofrojë të rinjve mundësinë të zgjedhin nëse duan të shkojnë në shkollë profesionale apo nëse duan të shkojnë në gjimnaz të përgjithshëm. Ky do të jetë një element i ri i shtuar.

Nga ana tjetër, një element që e preka qepar lidhet edhe me pjesën e këshillimit të karrierës, si shërbim komunitar, sërish edhe kjo një detyrë që mund të ofrohet edhe nga ana e bashkive. Kemi disa projekte të suksesshme, që janë implementuar në bashki të ndryshme, përmenda një më parë, rastin e Matit dhe të Dibrës. Në Mat kemi pasur një rast shumë të suksesshëm në bashkëpunim me një organizatë të shoqërisë civile. Nga eksperiencia e të rinjve aty do të shohim nëse ajo qasje ka rezultuar e suksesshme dhe nëse do t'ia vlejë që të shpërndahet në të gjithë Shqipërinë.

Një element tjetër lidhet me një nga programet që jemi duke e diskutuar së bashku me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit. Ata kanë nisur një program që quhet gjenerata “R” dhe qëllimi i këtij programi është rritja e informacionit

për shërbimet që ofron zyra e punës, sepse shumë të rinj nuk e dinë çfarë është. Agjencia e Punësimit është duke ndërtuar tashmë një platformë të re, ku paraqiten të gjitha pozicionet e punës për një bashki të caktuar apo për një zonë të caktuar, duke ua bërë kështu të rinjve edhe më të lehtë që të identifikojnë pozicione të ndryshme të punës dhe patjetër që do të bëhet një tur promovimi. E përmenda edhe më parë, që pjesa e informimit të të rinjve është shumë më e rëndësishme dhe vërtetë duhet t'i japim fokusin e duhur. Gjej rastin për të kërkuar edhe mbështetjen tuaj!

Sa i përket pjesës së praktikës së punës profesionale, besoj se do të kemi mundësinë ta diskutojmë më gjatë në Komisionin e Çështjeve Sociale, sepse aty do të diskutojmë edhe ligjin për vullnetarizmin. Një nga pikat e identifikuar drejtpërdrejtë ka qenë pikërisht kjo, penalizimi i të rinjve që bëjnë praktikën e punës dhe konsiderohen si të punësuar të plotë. Kemi bërë edhe një diskutim me zëvendësministren e Financave si dhe me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit për mënyrën më të mirë se si mund ta zgjidhim. Patjetër në Komisionin e Çështjeve Sociale do të marrim edhe inputin nga ana e organizatave të shoqërisë civile për të kuptuar se si mund ta bëjmë sa më mirë dhe për më tepër për të mos penalizuar ato biznese që u ofrojnë këtë mundësi të rinjve, sepse në fund fare kjo është ajo që ndodh dhe krijon problematika.

Më pyetët lidhur me statusin e projekteve dhe ndoshta kjo u vlen edhe kolegëve që pyetën më parë sa i përket monitorimit dhe vlerësimit. Një nga programet që kemi mbështetur ka qenë Bashkia e Tiranës. Ne jemi në kuadër të rikonstruksionit të Qendrës Kulturore për të rinjtë në Petrelë. Bashkia e Tiranës ka aplikuar me një projekt për Petrelën dhe ne në fakt ishim shumë të gëzuar që ishte Petrela, sepse aty ka një numër të madh të rinjsh pa një qendër kulturore që t'i priste ata. Në fund të muajit mars më në fund Bashkia e Tiranës ka bërë miratimin e projektit në këshillin teknik dhe së shpejti do të fillojë edhe prokurimin për zbatimin e projektit për të rikonstruktuar këtë qendër rinore.

Sa i përket Bashkisë së Elbasanit, tashmë kjo bashki është duke implementuar projektin “*Talent start up, Elbasan*”, i cili ka një kohëzgjatje 10-mujore. Çdo gjë ka ecur sipas planit, ka filluar prokurimi dhe sipas parashikimeve duhet të ketë përfunduar para disa ditësh. Aktivitetet që kanë zhvilluar janë: “*Talent start up, Elbasan 2*” ka hapur një kinema verore; është zhvilluar një konkurs “*Elbasan’s got talents*” dhe një shfaqje teatrale “*Funy money*”. Përgëzimet më të mëdha për Bashkinë e Elbasanit, për krijimin e këshillit vendor rinor për përfshirjen e rinjve e Elbasanit! Ndërkohë gjatë muajit maj ata janë duke zhvilluar një trajnim

për të rinjtë për përdorimin e njohurive teknologjike dhe po bëjnë video montime audio. Përgjithësisht kanë qenë shumë korrektë si bashki, kështu që nuk po përcjell komente.

Bashkia e Roskovecit ishte një nga projektet e tjera. Ata kanë kërkuar rikonstruktimin e bibliotekës publike dhe krijimin e një klubi libri për të rinjtë. Për shkak të arsyeve atmosferike janë vonuar pak me zbatimin e projektit por tashmë kanë filluar procedurën e prokurimit, më thonë, kështu që edhe nga Bashkia e Roskovecit do të kemi lajme të mira shumë shpejt.

Për sa i përket Bashkisë së Lezhës, sërish kanë kërkuar implementimin e një projekti të quajtur “Qendra rinore në Lezhë”, i cili do të ketë një kohëzgjatje prej 12 muajsh. Tani që flasim Bashkia e Lezhës është në fazën e hartimit të specifikimeve teknike dhe shumë shpejt do të hapë edhe procedurën e prokurimit.

Sigurisht, mund të vazhdoj edhe me 12 organizatat rinore, të cilat kanë filluar implementimin e projekteve të tyre, ku një pjesë e madhe e tyre kanë zhvilluar një sërë aktivitete. Një nga organizatat e Bashkisë së Cërrikut ka realizuar projektin 12 – mujor me titull “Edukimi dhe sporti frymëzojnë”. Qëllimi i këtij projekti ka qenë integrimi social i të rinjve të Bashkisë së Cërrikut nëpërmjet ofrimit të aktiviteteve, që lidhen me këshillimin e karrierës, si një mënyrë për të larguar të rinjtë nga veset dhe zakonet e këqija. Projekti është ndarë në dy faza, edukimi dhe karriera. Në fazën e parë janë evidentuar problematikat dhe nevojat e të rinjve të Bashkisë së Cërrikut, duke bërë intervista të drejtpërdrejta. Gjithashtu kanë përfunduar edhe disa kurse përgatitore për të rinjtë që kishin prapambetje në mësim. Kjo është zhvilluar për 5-mujorin e parë të implementimit të këtij programi. Faza e dyta është realizuar tashmë dhe temë diskutimi ka pasur “Diskutojmë me profesionistin”. Pra, të rinjtë kishin mundësi të flisnin me dikë, i cili ishte i fushës dhe mund t’u jepte njohuritë e duhura për të pasur një profesion. Nga 10 sesione janë zhvilluar vetëm 3 dhe 7 të tjerat do të zhvillohen në vijim. Pjesa më e bukur e këtij programi në fakt ka qenë zhvillimi i një bashkëbisedimi, ku kanë marrë pjesë të rinjtë dhe kanë folur për elemente të ndryshme të karrierës, i cili është zhvilluar në kinemanë e qytetit. Kanë edhe 4 të tilla që do të zhvillohen në vazhdim, deri në përfundim të dymbëdhjetëmujorit për implementimin e këtij projekti.

Një tjetër projekt “Të rinjtë në sipërmarrje”, një projekt shumë i këndshëm, i cili është zbatuar në 3 qytete: Shkodër, Korçë dhe Vlorë. Ky program quhet “Kupa krijuese e biznesit”...

Flutura Açka – Më falni, zotëria ju pyeti specifikisht për Elbasanin! Të gjitha projektet janë të shënuara këtu dhe janë shumë të qarta besoj.

Bora Muzhaqi - Për të qenë e sinqertë, nuk i kishit të gjitha informacionet e detajuara për sa u përket monitorimit.

Flutura Aça – Ju thërrasim prapë.

Meqenëse po flisnim për Elbasanin, këta tani mund të bëjnë kinema verore, por, pasi të majtët e shkatërroan kinemanë shumëstinore. Kjo është çështja e Elbasanit. Nuk ka qytet më të trishtë se Elbasani për pjesën e argëtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk po bëj politikë, por po flas si qytetare elbasanase.

Fjala për zonjën Eralda.

Eralda Bano – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre, për të gjithë fjalimin tuaj, edhe për përgjigjet shteruese!

Në përgjithësi këto vitet e fundit është abuzuar shumë me fëmijët dhe të rinjtë, flas edhe për evente të ndryshme politike që janë zhvilluar. Rasti më i fundit ishte ditën e djeshme. Për herë të parë ne kemi një ministre për të rinjtë dhe fëmijët dhe do të doja shumë që të paktën si një detyrim moral ju duhet të kishit një reagim, e kam fjalën këtu për simbolet e komunizmit që janë përdorur tek eventet e fundit. Të indiktosh direkt apo indirekt simbolet e komunizmit tek të rinjtë, për mendimin tim, sidomos sot në demokraci, është pak të thuash krim. Të shohim prapë shallin e pionierit të filizat e vendit, reagimi i parë që të vjen është keqardhja! Të duash dhe të riprodhosh simbolet dhe kuptimet e një kohe kur jetohej dikur në diktaturë, do të thotë të jesh pa aq i zi në shpirt saç ishte edhe Enver Hoxha!

E kërkoj si qytetare një reagim tuajin, duke qenë se ju përfaqësoni të rinjtë dhe fëmijët. E para.

Pyetja e dytë: sa është numri i të rinjve dhe minorenëve që ndodhen në mjediset e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale?

Cilat janë veprat penale për të cilat akuzohen ose janë dënuar?

Cili është niveli i shkollimit të tyre?

Si mbrohen të drejtat e tyre në këto institucione dhe a janë vërejtur shkelje të të drejtave të këtyre të rinjve, dhunë verbale, psikologjike apo fizike?

A bashkëvepron ministrja e Rinisë dhe Fëmijëve me Ministrinë e Arsimit për çështje të tilla të përbashkëta?

A ka ministria juaj një *database* të të rinjve në diasporë dhe cili është bashkëpunimi me Ministrinë e Diasporës në këtë drejtim?

A keni ndërmarrë ndonjë fushatë për të rinjtë për njohjen e programeve ndërkombëtare për ta dhe mënyrën se si mund të bëhen pjesë e këtyre programeve?

E fundit, duke qenë se prioritet keni sportet, sa janë investimet në fushën e infrastrukturës në shkollat e arsimit parauniversitar dhe universitar?

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Bano!

Fjala për ju, zonja ministre.

Bora Muzhaqi – Më lejoni t’ju them që kam lindur në mars të vitit 1990, që do të thotë që nuk e kam jetuar atë kohë. Jam brezi që prindërit na i kanë treguar të gjitha dhimbjet dhe problematikat e asaj kohe lidhur gjithë tragjedinë që i ka ndodhur popullit tonë.

Ju kërkoi ndjesë, unë nuk e kisha ndjekur specifikisht rastin, por po e dëgjoj këtu nga ju dhe do të kisha dashur të kisha një informacion më të gjerë rreth kësaj para se të jepja një reagim të mirëfilltë, por ju premtoj që do ta bëj këtë gjë! Pas takimit të sotëm do të merrem personalisht me këtë rast, do të informohem për çfarë ka ndodhur dhe do t’ju kthej një përgjigje.

Ju kërkoi ndjesë që nuk jam në dijeni!

Për sa i përket pjesës tjetër, për numrin e të rinjve dhe minorenëve se cilat janë veprat penale që kanë kryer apo cili është niveli i shkollimit, siç përmendën edhe kolegët, ne jemi në komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë. Po bashkëpunojmë lidhur me strategjinë e re për “Mbrojtjen e të rinjve në konflikt me ligjin”. Një nga kërkesat e mia të drejtpërdrejta ka qenë që të keni një qendër për rehabilitimin e këtyre të rinjve. Do të vazhdoj të mbaj të angazhuar gjatë gjithë kohës edhe kolegët, që të vazhdojmë të merremi me këtë detyrë të rëndësishme sa u përket të rinjve që janë në konflikt me ligjin.

Duhet të isha e përgatitur për sa u përket numrave të saktë, por, nëse i dëshironi, do t’jua dërgojmë në bashkëpunim me kolegët e Ministrisë së Drejtësisë.

Për sa i përket Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me ta, pasi një pjesë e madhe e punës dhe detyrave që kam lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë ministri, sepse, si pjesa e fëmijëve, por edhe e të rinjve deri në moshën 18 vjeç është diçka që na lidh në mënyrë të drejtpërdrejt me Ministrinë e Arsimit, por edhe pas kësaj moshe, kur të rinjtë vazhdojnë universitetin, kemi sërish bashkëpunim me këtë ministri.

Ndërkohë, pyetja tjetër juaja ishte nëse kishim *database* për diasporën, siç përmenda edhe në fjalën time, kemi mungesë të dhënash në fushën e rinisë, ndaj edhe te Strategjia

Kombëtare e Rinisë kemi kërkuar të kemi një katedër të veçantë që e studion këtë pjesë dhe të përpiqemi të kemi një sinkronizim të të dhënave që kur të flasim për politikën si implementohen ato, të kemi mundësinë t'i bazojmë në një set të dhënash dhe të biem të gjithë dakord kur diçka është arritje apo nuk është arritje.

Kemi filluar edhe bashkëpunimin me Agjencinë e Diasporës. Për momentin nuk e kemi një listë të të rinjve që janë në diasporë, por kemi komunikuar me disa rrjete të ndryshme, siç është rrjeti i të studentëve shqiptarë në botë, gjithashtu edhe me shoqata të ndryshme, të cilat na kanë vënë në dispozicion listën e të rinjve që jetojnë jashtë, por nuk kemi një *database* të mirëfilltë.

Komenti juaj është shumë i drejtë, është diçka që duhet ta kishim, kështu që do ta vendosim edhe këtë në listën e detyrave tona.

Sa u përket sporteve dhe investimit për to, së pari, është një fushë, e cila mbulohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sigurisht që ka disa elemente që unë i kam ndjekur në kuadrin e një dëshire për të bashkëpunuar dhe për t'i ndihmuar që puna të bëhet sa më mirë.

E di që investimet në infrastrukturën sportive kanë qenë shumë të larta vitet e fundit, madje, nëse më lejon ta konkretizoj bisedën, kam qenë në shumë shkolla dhe kam parë palestra të reja sportive, që më kujtuan shkollën time kur isha jashtë Shqipërisë. Të paktën të rinjtë janë super të kënaqur me këto investime që janë bërë, madje, unë do të doja të shkoj me tej, të bëjmë ende investime në infrastrukturën sportive.

Këto ishin përgjigjet e pyetjeve.

Faleminderit!

Flutura Aça – Do të respektojmë radhën! Zonja Buxheli, pastaj zonja Ulliri.

Lindita Buxheli – Zonja Ministre, shumë shkurt, sepse të gjithëve u ka sosur durimi!

Një pjesë e pyetjeve janë ezauruar, kështu që unë kam një pyetje shumë konkrete. Para disa ditësh keni qenë në Lushnje, nëse do të kishim qenë të ftuar aty, do t'ua kursenim të gjithëve këtë pjesën, mund ta kishim konsumuar aty. Pra, mund ta keni parasysh për herë tjetër që prezenca e deputetit mund të ezaurojë shumë gjëra në zonë.

Marr shkas nga mungesa e specialistëve të bujqësisë, sepse Lushnja dihet, është një rreth me gati 90% drejtim bujqësor. Janë rreth 16 specialistë bujqësie, kjo nuk është pjesa juaj, ne kemi diskutuar me ministren përkatëse, por folët për këshillimin e karrierës. Sot që flasim janë rreth 1200 nxënës, që mbarojnë shkollën 9-vjeçare. Do të ishte mirë një këshillim për ta, pasi jo të gjithë duan të shkojnë në gjimnaz, por vazhdimi i arsimit profesional mund

ta zbusë sadopak situatën, nëse dalin profesionistë të mesëm bujqësor, pasi dihet që ai është tërësisht një rreth bujqësor.

Flasim që mungojnë rreth 16 specialistë bujqësorë, kështu që strategjia nga ana juaj për këshillimin e karrierës do t'i vlente shumë asaj zone, pra Lushnjës, Divjakës, ku mund të jenë 1300-1400 nxënës që përfundojnë arsimin e mesëm 9-vjeçar.

Bora Muzhaqi – Faleminderit!

Është shumë e drejtë kritika që bëni dhe ju premtoj se herën e ardhshme që do të shkoj në Lushnjë do të sigurohem të kem prezencën e deputetëve, për të parë edhe problematikat që ngrihen nga ana juaj.

Unë përmenda pak më parë këshillimin e karrierës. Nuk do të zgjatem. Këshillimi i karrierës është diçka për të cilën po punojmë, qëllimi është ta fusim që në klasën e 9-të. Jemi duke punuar bashkë me Ministrinë e Arsimit për rishikimin e kurrikulave në mënyrë që të bëjmë pikërisht këtë që thoni ju, një element tjetër me të cilin po punohet nga universitetet është identifikimi i pozicioneve të ndryshme që janë në zhdukje ose që ka pak të rinj që i ndjekin ato për të siguruar se cilat do të jenë masat për të ardhmen. Pikërisht rasti i specialistëve bujqësorë, por edhe shumë profesione të tjera që mund të jenë pjesë e kësaj liste.

Flutura Açka- Zonja Ulliri.

Andia Ulliri – Faleminderit!

Unë do të trajtoj disa çështje që i kam ngritur edhe në seancat e tjera dëgjimore me ministrat përkatës. Këshillimi i karrierës ka një problematikë për maturantët e rinj, sepse nuk përputhet shpeshherë dëshira, mundësitë dhe mungesa e tregut të punës. Unë e kam ngritur si çështje dhe më vjen çudi që edhe ju, si ministre e Rinisë, mendoni që nuk ka, ndërkohë që Ministria e Arsimit më ka treguar që ka dhe funksionojnë zyrat e karrierës, gjë që unë e kam dëshmuar dhe deklaruar që nuk është e vërtetë. Unë mendoj se është një punë e mirë nisja e kësaj iniciative, do të thosha edhe në klasat e 9-ta.

Unë mendoj se të rinjtë sot duhet të kuptojnë se Shqipëria ka potencial, ka vende pune, por siç thotë edhe zoti Rama, nuk ka profesionistë. Duke qenë kështu, duhet adresuar fakti që ka mungesa të ndryshme në treg dhe analiza, të cilat nuk përkojnë.

Dua të ndalem këtu edhe në çështjen që unë kam ezauruar në komision dhe që është arsimi profesional. Çfarë roli luan ministria juaj për arsimin profesional? A keni ju strategji ose plane, projekte që targetojnë këta të rinj? Cila ka qenë iniciativa juaj, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave?

Arsimi profesional përbën një çështje shumë të rëndësishme për shoqërinë shqiptare dhe mendoj se ka shumë vende vakante, të cilat mund të plotësohen duke i dhënë atyre mundësinë e informimit dhe duke i drejtuar ata ose orientuar ata drejt këtyre mundësive të reja. Unë dua të di rolin tuaj dhe strategjitë që ju keni në këtë drejtim.

Disa nga pyetjet janë ezauruar, por unë dua të them se kam pasur konsultat e mia me Agjencinë Rinore, gjithashtu, pata një konsultë në klubin e të rinjve parlamentarë, ku u tha se nuk ka mungesë informacioni, është e rrallë të ketë mungesë informacioni, por në të vërtetë bashkitë kanë probleme me mënyrën e aplikimit për të marrë projekte. A keni ngritur ndonjë grup pune që t'i orientojnë bashkitë e vogla?

Dua të vëmë fokusin te bashkitë e vogla, të cilat janë shqetësim i anëtarëve të këtij komisioni që bashkitë e mëdha kanë resurse, kanë burimet njerëzore, por janë bashkitë e vogla ato që kanë mungesa.

Duke dashur të vë theksin të disa problematika që të rinjtë kanë, jo vetëm si deputete e re, por më takon të ngre zërin çdo herë që vë re mungesë të transparencës ose sinqeritetit. A keni ju ndonjë reagim për faktin që sot Shqipëria ka nivelet më alarmante të largimit të të rinjve, duke qenë se ju fokusoheni në strategji që duhet t'iu bëjë atyre një jetesë më të lehtë, për t'i përshtatur me tregun e punës, për t'u treguar atyre oportunitetet që ofron Shqipëria? Duke ditur se ju vetë jeni kthyer pas studimeve tuaja jashtë, sipas INSTAT-it thuhet se kemi 41% të femrave të moshës 25-39 vjeç që kanë arsimin fillor. Si do të profilizohen këto të reja, kur nuk kanë as arsimin e detyruar? Cila është qasja juaj për të rinjtë për fushat që qeveria juaj ka caktuar si prioritare, si peshkimi, bujqësia dhe agroturizmi? Çfarë qasje mendoni se do të ketë ministria juaj lidhur me këtë?

Dua të sqaroj vetëm diçka. Shpesh në komisionet tona ose edhe në aktivitete parlamentare tregohet se arsyeja pse të rinjtë largohen nga Shqipëria është se ka mungesë në fronte pune, punësim, ka paga të ulëta, por unë mendoj se është një pretekst për të thënë se sot asgjë nuk shkon në Shqipëri. Ka mungesë të transportit publik, mungesa në kushtet e punës. Shërbimet shëndetësore, që duhet të ishin falas, nuk janë falas, infrastruktura është e mjerueshme, ka pasiguri në ambientet publike. Është detyra juaj t'i adresoni shqetësimet dhe t'i tregoni si ministri një orientim të ri drejt politikave të reja. Sipas raportit, në Shqipëri 62% e të rinjve shqiptarë nuk besojnë fare te politika dhe ky është një fakt që ju duhet të punoni dhe tregoni se ka njerëz që kontribuojnë në politikat për të rinj. 0,57 vlerësojnë me zero punën e pushtetit vendor, por kjo është një arsye pse këto bashki të vogla nuk përfitojnë nga grantet e huaja, përveç problematikave që ata hasin nga pamundësia në burime njerëzore.

Kam edhe disa pyetje të tjera, por që do t'i trajtoj në një takim tjetër, kur të vini në komision.

Flutura Aça- Faleminderit!

Mund të rrimë gjatë, sa të doni.

Zonja ministre, fjala për ju.

Bora Muzhaqi – Së pari, më lejoni t'ju përgëzoj, është gjithmonë kënaqësi të shohësh deputetë të rinj të përfshirë, unë personalisht e kam kënaqësi këtë pjesë dhe gëzohem. Një nga arsytet pse unë iu futa kësaj rruge ishte pikërisht për të parë në politikbërje njerëz që ngjanin si unë në moshë dhe bindjeve dhe pritshmërive. Kështu që edhe për ju, zonja Ulliri, më bëhet qejfi dhe shpresoj të përcillni problematikat rinore në partinë që ju përfaqësoni, por edhe me zërin që ju keni në parlament është e rëndësishme që të rinjtë të mos shohim vetëm drejtimet politike, por edhe sfidat që kanë të rinjtë e zonës që përfaqësojnë.

Përmendët një element këshillimi e karrierës. Në fakt, këshillimi i karrierës bëhet në vitin e tretë të gjimnazit. Nga 1200 të rinj që unë kam pyetur pjesa më e madhe e tyre thonë që zhvillohet, por që nuk zhvillohet në momentin e duhur, e kërkojnë pak më herët. Prandaj qëllimi ynë është ta fillojmë që në klasë të nëntë. Nuk po ndalem sërish te kjo, sepse u përgjigja edhe pak më parë.

Sa i përket arsimit profesional është kompetencë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dikur e quajtur Ministria e Punës, prandaj ka mbetur ende te kjo ministri. Kjo nuk do të thotë se ne nuk kemi pasur bashkëpunime të vazhdueshme, edhe në panairin e fundit që u realizuar për pjesën e punësimit dhe për zhvillimin e shkollave profesionale. Në panairin e shkollave profesionale ku unë isha prezent shfrytëzova mundësinë për të diskutuar me të rinjtë e shkollave profesionale, por edhe me kolegët e Ministrisë së Financave dhe të Agjencisë Kombëtare të Punësimit. Kemi disa projekte të përbashkëta në të cilat po përfshihemi. Unë përmenda pak më parë programin e garancisë rinore. Ai është një angazhim i përbashkët që fokusohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të rinjtë që nuk janë në punësim dhe nuk janë në trajnim. Sa iu përket shkollave profesionale më duhet të them se është bërë një punë shumë e mirë, sepse pjesa më e madhe e të rinjve që kam takuar nga shkollat profesionale janë shumë të kënaqur me kushtet që kanë në këto shkolla. A ka nevojë ende për punë? Po ka, unë jam e mendimit se ka nevojë gjithmonë për punë, kështu që unë i bashkohem Ministrisë së Financave për t'i ndihmuar sa herë është nevoja për shkollat profesionale. Kam takuar disa të rinj super të talentuar, madje më të talentuar nga shkollat

profesionale se gjimnazet, ky është një element për t'u vlerësuar, për aftësinë e këtyre shkollave.

Sa i përket mungesës së informacionit, unë, në fakt, iu referova mungesës së informacionit nga ana e të rinjve, ndërsa sa iu përket bashkive nuk mendoj se ka pasur mungesë informacioni, sepse Agjencia Kombëtare e Rinisë vitin e kaluar, ndonëse ishte viti i parë që zhvillohej thirrja për projekt propozime rinore, bëri pa fund sesione konsultimi. Staf i agjencisë ishte në disponueshmëri të çdo entiteti si bashki të vogla dhe bashki të mëdha, madje jemi përqendruar kryesisht te bashkitë e vogla. Jemi përpjekur maksimalisht që t'i qëndrojmë afër. A mund ta bëjmë më mirë? Këtë vit po përpiqemi maksimalisht, por një nga mënyrat si do ta bëjmë më mirë është të hapim thirrjen për projektpropozime, sepse vjen nuk arritëm ta hapi para muajit gusht, dhe ky mund të ketë qenë një element që ka ndikuar pasi muaji gusht është muaji kur të gjithë marrin lejen, por sivjet do ta bëjmë përpara verës. Besoj se edhe kjo do të na ndihmojë në të pasurit më shuma aplikime nga bashkitë. Megjithatë edhe konsultimet do t'i shtojmë sivjet. Staf i nga AKR-ja është gjithmonë në dispozicion, të çdo kërkesë nga bashkia si për informacione, si për të kuptuar procesin e aplikimit, si për të asistuar, në të gjitha bashkitë, madje bashkive të mëdha i kushtojmë më pak vëmendje duke ditur sa shumë kanë nevojë bashkitë më të vogla.

Gjithashtu, përmendët një çështje që unë i kam dhënë përgjigje disa herë si në prezantimin tim si në përgjigje , patjetër që largimi i të rinjve është një problem, por duke qenë se unë jam vetë të rinj, pavarësisht se sipas ligjit i ri je nga mosha 25-29, dhe mua nuk më përfshin ky ligj, por duke qenë pjesë e një grupi që është larguar nga Shqipëria për të studiuar jashtë, por ka vendosur që pas përfundimit të studimeve të kthehet në Shqipëri unë shpresoj shumë që pikërisht ky është modeli që ne duhet të nxisim tek të rinjtë shqiptarë. Nuk ka asnjë lloj problemi që të rinjtë tanë të largohen për të pasur një eksperiencë më të mirë ose për të krijuar si një arsimim ndoshta të ndryshëm që nuk e gjen dot në Shqipëri të një fushe që ne nuk e ofrojmë dot, por edhe për të marrë një eksperiencë pune që ndoshta tregu ynë nuk e ka ende të mundur. Por çfarë duhet të bëjmë ne të gjithë bashkë me mua në krye? Cilat janë qëllimet e strategjisë kombëtare të rinisë? Është sigurimi i një ambienti që ia bën të mundur të rinjve që edhe pas eksperiencave të tyre jashtë Shqipërisë të kenë mundësinë që të kthehen dhe ta gjejnë veten në këtë vend. Unë mendoj se do të duhet pak më shumë kohë për t'i kaluar të gjitha masat një e nga një, por çdo masë e strategjisë kombëtare të rinisë që nga fuqizimi i zërit të të rinjve e deri të krijimi i një platforme që ofron mundësi për vullnetarizëm

për punësimin, por edhe praktika e punës ose thirrjet për projektpropozime rinore, të gjitha këto kanë vetëm një qëllim pikërisht krijimin e më shumë mundësive për të rinjtë.

Gjithashtu, nëse ka diçka tjetër që duhet të përmendet është se perceptimi ndonjëherë është më i frikshëm se realiteti. Nëse unë mendoj se ne bëjmë diçka ndoshta jo në mënyrën më të mirë të mundshme që kemi mundësinë ta bëjmë është pikërisht mënyra si flasim dhe kur flasim për Shqipërinë sikur Shqipëria nuk ka mundësi dhe sikur Shqipëria është fundi dhe çdo gjë këtu nuk bëhet dhe nuk ka për t'u bërë, nuk është mënyra e duhur për të dhënë një shembull të rinjve. Unë mendoj që pikërisht ju, zonja Ulliri, dhe pikërisht unë jemi një arsye shumë e mirë që të rinjtë shqiptarë të shohin në parlament si në të majtë edhe në të djathtë, një person që i përfaqëson ata për të kuptuar që është dikush që ngre zërin për ta, është dikush që fuqizon zërin rinor, e mbi të gjitha dikush që adreson problematikat e tyre. Sivjet është hera e parë që ka një ministër që i përfaqëson, një ministri që kujdeset vetëm për çështjet e tyre.

Është viti europian i rinisë dhe e gjithë Europa ka vendosur se rinia është pika kyçe. Ne kemi pasur fatin që kemi fituar titullin Tirana kryeqytet europian i rinisë ku do të zhvillohen shumë aktivitete.

Nëse mund të bëj edhe një koment të fundit në takimet që kam bërë me të rinjtë nuk më pëlqen fare kur shprehemi Shqipëria nuk bëhet. Po e drejtë nuk bëhet duhet ta bëjmë në detyra është e jona që ta bëjmë bashkë. Patjetër ka shumë hapa që duhen ndërmarrë, ka shumë punë që duhen bërë, por pa përshtirë të rinjtë, fëmijët dhe pa u angazhuar në mënyrë të përbashkët dhe të vazhdueshme nuk bëhet Shqipëria. Unë mendoj se të rinjtë kanë një detyrë shumë të rëndësishme për këtë pjesë.

Sa i përket të dhënave unë mendoj së pari, se të dhënat janë lufta dhe lobimi i përditshëm për të pasur të dhëna të sakta që reflektojnë situatën, siç duhet dhe së dyti, sa i përket strategjive kemi propozuar disa nisma të reja që do t'ia bëjnë të rinjve Shqipërinë më interesante, për të qëndruar dhe për ta parë si një zgjedhje reale, ndonëse edhe pse mund të jetë pas një eksperience jashtë Shqipërisë dhe pas një shkëmbimi rinor që ata zhvillojnë.

Faleminderit!

Flutura Aça – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Tahiraj.

Dasantila Tahiraj – Faleminderit!

Në fakt, seancës suaj dëgjimore të sotme i erdhi fundi pas një dëgjese të gjatë. Unë dua të bëj një pyetje shumë të shkurtër, por që mendoj se ka rëndësi për rininë.

Nisur nga fakti që Ministria e Rinisë dhe e Fëmijëve inicion dhe promovon programe dhe politika për këtë grupmoshë, pyetja ime është pse nuk ka këtu ndonjë program apo politikë për luftën ndaj alkoolit dhe drogës?

Pyetja ime është konkrete, në klube dhe festa të organizuara nga këngëtarë shohim që marrin pjesë pa limit dhe pa i kërkuar një kartë identiteti për të parë çfarë moshe ka individit që merr pjesë në këto festa dhe të gjithë e dimë që aty konsumohet alkool dhe duhan minimalisht. A ka ndonjë program, a jeni duke përgatitur ndonjë program meqenëse unë nuk e pashë në programin që ju na keni paraqitur në lidhje me këtë?

Faleminderit.

Flutura Aça – Faleminderit zonja Tahiraj!

Zonja Ministre, fjala për ju.

Bora Muzhaqi – Faleminderit!

Ndjesë se po përpiquesha të gjeja specifikisht pikën e strategjisë që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me këto. Kjo është një nga temat tona dhe në fakt qëllimi i tretë i strategjisë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me mirëqenien dhe shëndetin e të rinjve dhe një nga masat konkrete lidhet me pjesën e ndërjegjësisimit për problematikat e ndryshme që ka lidhur me drogat dhe përdorimin e alkoolit, por mendoj që kjo është një fushë që, siç e kemi diskutuar, ndoshta edhe bashkë jashtë komisionit shpeshherë, është një fushë që duhet të angazhohemi pak më tepër. Me Ministrinë e Shëndetësisë ne, në fakt muajin e ardhshëm do të kemi dhe një organizim paneli me Organizatën Ndërkombëtare të Shëndetësisë me WHO. Fokusi i këtij paneli do të jenë pikërisht të rinjtë dhe shëndeti dhe një nga temat e këtij paneli do të jetë pikërisht kjo temë që ju ngrini sot. Në fakt aty do ta shfrytëzojmë edhe si një opsion për të diskutuar me të rinjtë dhe për t'i pyetur dhe ata më konkretisht se kush janë sfidat që hasin dhe se si mund t'i zgjidhim ndoshta edhe duke pyetur këtë grupmoshë që shpesh herë nuk përgjigjet në mënyrën e duhur kur ne ndryshojmë ligjet apo ndonjëherë ligjet edhe pse janë efektive, sepse kur flasim për pjesën e kartës së identitetit patjetër që ligji e thotë qartë, por, ndërkohë çfarë ndodh është që ata zotërinjtë që kanë baret dhe lokalet nuk e zbatojnë ligjin dhe nuk e kontrollojnë këtë kartën e identitetit.

Faleminderit që ma vendosët në vëmendje, ndonëse është pjesë e strategjisë kombëtare të rinisë, ne do të jemi edhe në konsultim të vazhdueshëm edhe me policinë për t'u siguruar që të ketë edhe pak më shumë kontrolle ndoshta në këtë aspekt edhe për të bërë të mundur që të rinjtë mos të konsumojnë alkool sidomos kur janë nën moshën e lejuar.

Ju faleminderit!

Flutura Aça – Faleminderit, zonja ministre!

Fjalën e fundit e ka zoti Koçi. Nuk e ka kërkuar njeri tjetër.

Petro Koçi – Faleminderit!

Dëgjuesat në këtë komision me të vërtetë janë një sfidë që është vërtetuar në disa procese të tilla. Të them të drejtën është e saktë ajo që përfaqësues të opozitës kanë kërkuar që ju të ishit këtu që nga fundi i vjeshtës së vitit të kaluar, për shkak të ngjarjes së rëndë që ndodhi në Fier.

Unë kam qenë njëri nga ata që kam insistuar që ajo të mos ndodhte në atë moment, e para, sepse ishte një ngjarje që nuk lidhet drejtpërdrejtë me dikasterin tuaj, aq sa mund të quhet dikaster, sepse është një çështje që lidhet më shumë me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me mënyrën se si funksionon komuniteti në përgjithësi në qytetet dhe në fshatra tona, ku ka më shumë për të bërë, sepse shumë problematika, në fakt, zgjidhen aty. Gjithashtu, janë shumë çështje shoqërore edhe ligjore që mund të zgjidhen pikërisht nga një mënyrë tjetër e funksionimit të komunitetit, gjë që ne akoma s'e kemi sjellë në standardet e duhura si shoqëri, jo thjesht si politikë.

Megjithatë, mendoj që kjo ishte një dëgjuesë e vlefshme dhe që besoj se të gjithëve na dha mundësinë për të kuptuar më shumë se cila është detyra juaj e vërtetë në këtë funksion, që në vetvete dhe ndoshta dhe për shkak të moshës tuaj mund të jetë një sfidë më vete.

Tani, mua më duhet që të reagoj për 3 çështje. E para, lidhur me atë mbledhjen që përmendi zoti Boçi, për mbledhjen dhe dëgjuesën me disa ekspertë që lidhen me çështjen e Butrintit. Unë e kam thënë dhe më parë, ajo mund të ishte një mbledhje që mund të kishte zgjatur që atëherë aq sa duhet. Nuk dua tani të vendos gishtin mbi asnjë nga kolegët këtu apo kolege, të cilët bënë që mbledhja të mbyllej aq shpejt, sepse mund të ishte zgjatur. Unë mendoj që gjithkush është i lirë që të vijë në çdo lloj takimi, e di që është e drejta ligjore që kur e kërkon një grup deputetësh, 1/3 e tyre, mbledhja thërritet automatikisht, por mua, do të më lejoni të mos jem pjesë e një mbledhjeje të tillë, sepse gjykoj që, nëse ne do ta kishim ndërmarrë si iniciativë për të dëgjuar ekspertë përpara se ta shqyrtonim projektligjin, do të ishte mirë që këtë ta bënim më me mëndje dhe duke thirrur në mënyrë të balancuar ato njerëz apo ekspertë që një pjesë mendon ndryshe e një pjesë tjetër të kundërtën.

Kështu që unë vetë si nënkryetar dhe si përgjegjës i drejtimit të asaj mbledhjeje, nuk marr pjesë në një mbledhje të tillë. Të tjerët pastaj janë të lirë të veprojnë siç dëshirojnë.

Lidhur me problemin e filmit “ Debatik” dhe interpretimi që i është bërë në një shkollë apo dhe me ngjarjen e Cërrikut, tani unë nuk e di se me çfarë mëndje është vendosur

atëherë që ajo organizata është quajtur “Debatik”, se tani t’i konsiderosh komunistë ata kalamajtë është pa kuptim, edhe sikur t’i quash antikomunistë është prapë njëlloj pakuptim, por vetë filmi, të paktën sipas perceptimit tim, nuk është film me natyrë ideologjike, është më shumë një film që ka lidhje me antifazhizmin në vetvete. Nuk e di se çfarë pjese ata kanë ripërsëritur atje në shkollë, kjo është një gjë që duhet parë, por nëse ka lidhje me ideologjinë është diçka që duhet kritikuar dhe nuk duhet lejuar. Për sa i përket simboleve të përdorura në 5 Maj, ditën e dëshmorëve besoj do të ketë qenë ajo ose ndoshta ditën e formimit të ndonjë batalioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shamitë e kuqe kanë qenë, po themi, shami partizane.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kanë përdorur fëmijët, është shalli partizan jo shalli i pionierit, me siguri, se nuk ka lidhje, nuk është çështje pionierësh ajo, por çështje lufte, e kam fjalën tek simbolet, është një lloj të themi se ne po pamë një shqiponjë në kapelën e dikujt që ky është ballist, por nuk është kështu. Secili ka të drejtë të përdorë një simbol, por nëse simbolika pastaj është ideologjike, ajo është gjë tjetër pastaj, varet si e përdor personi ose personat. Gjithsesi vlen për t’u diskutuar konkretisht, pra të pyesim atje se e kujt ka qenë ideja dhe përse e kanë bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eralda Bano - Këto janë ngjarje të përsëritura, ju kishit edhe deputetin e Partisë Socialiste që pak më përpara...

Petro Koçi - Po nuk ka ndonjë gjë, shall partizani kam vendosur dhe unë, nuk ka ndonjë gjë fare, dhe shqiponjën e dua shumë dhe e puth.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eralda Bano - ...deputeti i Partisë Socialiste, duke idealizuar Enver Hoxhën; janë ngjarje të përsëritura këto!

Petro Koçi - Për Enver Hoxhën unë e kam thënë publikisht që kur është 5 maji është e pa mënd dhe është absurde që të mbahen portretet e Enver Hoxhës te varrezat e dëshmorëve, kur Enver Hoxha nuk është dëshmor. Këtë e kam thënë 20 herë unë, kam marrëdhënie të shkëlqyera me veteranët dhe këtë ia kam thënë dhe atyre, është komplet një gjë absurde, nuk ka lidhje, pavarësisht rolit se çfarë ka luajtur partia komuniste gjatë luftës, por kjo është çështje tjetër, nuk lidhet dhe nuk duhet ta lidhim komunizmin me luftën, duhet ta lidhim me pasluftën më shumë.

Tani pyetja ime është më e gjatë se përgjigjja që kam për ministren.

E thashë të jesh ministër shteti është një sfidë e vërtetë dhe jo të gjithë kanë mundur ta përballojnë, për shembull unë mbaj mend kolegë, si Arben Imami që, kur unë kam qenë në qeveri ka qenë ministër i Reformave dhe ka bërë një punë goxha të mirë, megjithëse ishte ministër shteti, nuk kishte ministri. Kjo është një sfidë e madhe për ju, unë dëgjova shumë, lexova dhe raportin dhe pashë gjëra shumë interesante, tani pyetja ime është shumë e drejtpërdrejtë. Do të na thuash 3 gjëra që sjellin ndryshimin, se edhe më përpara janë bërë politika për rininë apo për fëmijët, sigurisht në përgjegjësi të dikasterit ose ministrave të tjerë, tani unë dua vetëm 3 gjëra, ju mund të keni 10, e para është strategjia, dua dy të tjerat me dy fjalë, asgjë më tepër.

Faleminderit!

Flutra Aça – Faleminderit, zoti Koçi.

Fjala për Ministren.

Bora Muzhaqi – Po përqendrohem te fëmijët, sepse janë e ardhmja, ndërsa rinia është e tashmja. Dy programe, për mendimin tim programi i kodimit dhe teknologjisë në klasë të parë është diçka që do të revolucionojë jo vetëm fëmijët e klasës së parë, por komplet mënyrën si mësohet në shkollat tona. Duke mësuar pjesën logjike të mendimit kritik dhe çdo gjë tjetër dhe pas shumë vitesh do të ketë një rezultat të prekshëm për fëmijët dhe të rinjtë tanë.

Së treti është programi jashtëshkollor. T’iu ofrosh fëmijëve mundësinë për t’u përfshirë në arte zeje sporte dhe teknologji ka dy elemente pozitive, së pari, sepse zbulon dhe zhvillon talentet, së dyti se i lejon mamave të kenë pak më shumë për të punuar dhe pak më shumë kohë edhe për evente tyre duke i mbajtur fëmijët të përkujdesu në një ambient ku janë të sigurt dhe nuk ka problematika.

Petro Koçi – Kam vetëm një fjali t’iu lëmë kohë mamave, por edhe baballarëve.

Flutura Aça - Zonja ministre, unë kam një pyetje personale shumë direkte. A keni ju fëmijë të vegjël? Jo. Uroj të bëheni shpejt nënë! Ndonjë i afërmi juaj si e bën më fëmijën në fundjave, ku e çon, ku e argëton? Këtë e kam nga përvoja ime, sepse unë e kam pasur shumë problem në Tiranë ta argëtoja fëmijën në fundjavë, nuk dija ku ta çoja dhe shkoja nëpër klube pija kafe, ndërsa ai luante me lodrat e klubit. Por, në fakt, nuk është kjo mënyra e argëtimit të fëmijës. Këtu nuk ka mundësi ta argëtosh fëmijën me dinjitet. Shkoja në kinema, kur jepej filmi i radhës për fëmijë, por nuk vinte askush. Detyrohesh të blija tri bileta, një të jepja hostesit, një të vete dhe shihja filmin. Pra, këtu në syrin tim, është shumë

problematike për prindërit në fundjave për fëmijën. Mund t'i çojnë në aventurizëm, por nuk është kjo zgjidhja.

Gjithashtu, doja të thosha se ju shoh shumë të angazhuar në këtë punë dhe e bëni me pasion, e ndiej që e keni me pasion, por këtij pasioni i shtoni edhe 10 iniciativa për muze për fëmijët. Në të gjithë botën ju e dini se ka muze për fëmijët, për trupin, teknikën, teknologjinë, informatikën, videot e të tjera. Unë e di që janë shumë të parakohshme, por ëndrrat nuk kemi arsye pse të mos i shkruajmë në letër. Do t'i shkruajmë sot dhe do t'i gjejmë lekët nesër, por këto duhen shkruar sot. Sa më shpejt të shkruhen, aq më pak fëmijë do ta braktisin Shqipërinë, aq më pak të rinj do ta braktisin dhe aq më pak prindërve do t'iu nxihet jeta në fundjavë për t'i argëtuar fëmijët e tyre.

Ju a them këtë ta bëni sa më shpejt. Shkruajeni në letër, se letra mbetet dhe nesër të tjerët e kanë gati për ta vënë në zbatim.

Bora Muzhaqi – Faleminderit!

Pyetja është vërtetë me vend madje një nga arsyet pse unë jam ulur këtu ku jam sot dhe kam këtë detyrë dhe këtë angazhim kaq të madh. Ndoshta nga që nuk kam fëmijë të vegjël ende dhe ndoshta do të kem në të ardhmen, por dua që fëmijët e mi dhe fëmijët e të gjithëve t'i kenë ato mundësi.

Një nga iniciativat që unë përmenda në material është iniciativa e mikrofolisë. Mikrofilia është një nga vendet ku mund të dërgohen fëmijët. Kemi pasur një qasje shumë të mirë nga fëmijët jo vetëm gjatë ditëve të javës, por edhe në fundjavë. A mjafton? Jam dakord me ju nuk mjafton, por sot meqë më keni thirrur për veprimtaritë, nuk e kam sjellë listën e ëndrrave, kam një listë shumë të gjatë projektësh të cilat janë duke u hartuar edhe duke u përgatitur edhe në kuadër të asaj që përmendët ju, por shpresoj në të ardhmen të kem mundësi të vij me projekte konkrete dhe jo ëndrra.

Flutura Açka- Faleminderit!

Shihemi në takimin e radhës!

MBYLLET MBLEDHJA